



## **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI**  
**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”**

**“BASHKIA PATOS”**

**Tiranë, 2023**

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>4</b>
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	5
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve .....	5
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	11
<b>II. HYRJA</b> .....	<b>14</b>
1. Objektivat e auditimit.....	14
2. Qëllimi i auditimit.....	15
3. Identifikimi i çështjes.....	15
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	15
5. Përgjegjësitë e audituesve .....	15
6. Kriteret e vlerësimit .....	16
7. Standardet e auditimit.....	16
8. Metodologjia e auditimit .....	17
9. Dokumentimi i auditimit.....	18
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	<b>18</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	18
1. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	19
2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik .....	19
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. ....	28
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022.....	49
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve .....	68
2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ....	119
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit. ....	128
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit. ...	140
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme .....	148
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>161</b>
<b>V. ANEKSET</b> .....	Error! Bookmark not defined.
<b>VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT</b> .....	Error! Bookmark not defined.

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Patos, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi Financiar u krye për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 dhe Auditimi i Përputhshmërisë për periudhën 01.07.2019-31.12.2022. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e auditimit të përputhshmërisë, Rregulloren e procedurave të auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Patos si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 808,235 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 502,679 mijë lekë, ose në masën 62.1%.

-Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk është pasqyruar vlera 151,141,148 lekë e cila ka të bëjë me detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

-Për aktivet të cilat i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” është pasqyruar vlera 4,220,846 lekë, Bashkia Patos prej 1039 pronave që janë transferuar sipas VKM-ve respektive, vetëm për 29 prona posedon titull pronësie si dhe vetëm 91 prej tyre janë të regjistruara në kontabilitet, gjithashtu për këtë llogari është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 1,074,287 lekë ndërkohë që duke u bazuar në SKK nr. 5, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

-Llogaria 211 “Pyje, plantacione” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 682.75 ha pyje.

- Nga auditimi i dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve, konstatohet se në fund vitit 2021 borxhi tatimor është në vlerën **91,459,528 lekë**. Përgjatë vitit 2022 është krijuar borxhi tatimor në vlerën **33,236,601 lekë**. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Patos janë në **vlerën 124,696,129 lekë**.

- Nuk janë ndjekur procedurat për pagesën e detyrimeve nga pesë subjekte për pajisjen me Autorizim/Licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos **në vlerën 5,350,000 lekë**.

- Nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **1,524 persona** me vlerë **33,340,042 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.

- Nuk kanë likuiduar detyrimet për periudhën objekt auditimi 65 qiramarrës në vlerën **1,963,641 lekë** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos.

Gjatë auditimit të procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit u konstatuan:

- 5 raste tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimi të lejes të ndërtimit dhe zbatimit të punimeve;

- 1 rast me mosrespektimin e lartësisë së lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit;

- 1 rast mos përcaktim i saktë i numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit;

- 1 rast me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit;
- 4 raste në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë lidhur me mungesën e pajisjes me “Certifikatë përdorimi” të objektit pasi ishte në përdorim.
- Nga auditimi i zbatimit të punimeve rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,081,633 lekë** për 4 kontrata.
- Nga auditimi i 10 procedurave me vlerë totale të fondit limit **1,323,416 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 10 procedura **me vlerë kontrate 1,275,339 mijë lekë** ose 100 % e vlerës. Në këto procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Patos, KLSH ka dhënë “*Opinion të kualifikuar*” për pasqyrat financiare dhe “*Opinion të kundërt*” për përputhshmërinë. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse.

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 119/1 prot., datë 31.01.2023, i ndryshuar me shkresën nr. 119/2 prot., datë 07.03.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.02.2023, deri më 24.03.2023, në Institucionin Bashkia Patos u krye auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”. Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve, administrimi i aseteve.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit).

Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 25 akt konstatime. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në Projektraport dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhja e gjetjes	Rëndësia	Rekomandim
1	<p>Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.</p> <p>-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërkrahë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.</p> <p>-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.</p> <p><b>b.</b> Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të Njësisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Patos u konstatuan paregullsitë si më poshtë:</p> <p>-Struktura e NjAB nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të</p>	E lartë	<p>-Nga Kryetari i Bashkisë Patos të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizimin e tyre.</p> <p>-Bashkia Patos të marrë masa për plotësimin me kapacitet të plotë me burimet njerëzore të nevojshme të strukturës së NJAB me qëllim mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e saj.</p> <p>-Nga NJAB të merren masa që, pjesë e planit vjetor të vitit 2023 të përfshihen edhe auditimi të Drejtorisë së Financës. Nga Përgjegjësi i NJAB të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.</p>

	<p>plotë të kësaj njësie.</p> <p>-NJAB nuk ka kryer auditimin e Drejtorisë së Financës e cila ka qenë pjesë e planit vjetor dhe është fushë me risk të lartë.</p> <p>-Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.</p>		
2	<p>Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e vetë Bashkisë Patos së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, për vitin 2022 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 808,235 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 502,679 mijë lekë, ose në masën 62.1%. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën 314,595 mijë lekë, realizuar 81,879 mijë lekë, ose në masën 26%. Gjithashtu edhe shpenzimet operative të cilat janë planifikuar në vlerën 104,140 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 55,539 mijë lekë ose në masën 53.5%.</p> <p>Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Patos në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.</p>	E lartë	-Bashkia Patos, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore me qëllim hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.
3	<p>Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datë 31.12.2021, në vlerën 14,298,391 lekë ndërsa në mblyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 14,234,425 lekë me një ulje në vlerë 63,966 lekë. Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në datën 31.12.2022, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 14,234,425 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 151,141,148 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 136,906,723 lekë.</p>	E lartë	-Bashkia Patos, Drejtoria e Financës të sistemojë llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të kategorisë privat dhe familjar.
4	<p><b>1.</b> Në total aktivet të cilat i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, për koston historike në vlerën 4,220,846 lekë Bashkia Patos prej 1039 prona të cilat janë transferuar sipas VKM respektive vetëm për 29 prona posedon titull pronësie si dhe vetëm 91 prej tyre janë të regjistruara në kontabilitet. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c”.</p> <p><b>2.</b> Llogaria 211 “Pyje, plantacione” paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2022, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Patos me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferim në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave, sipas inventarit, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive” i ndryshuar, sipas listës në faqen 555 të VKM, janë transferuar 682.75 ha pyje. Të regjistruara në ASHK janë 4 pasuri me nr. 2/8, 2/1, 2/5, 2/3 me sipërfaqe 4 ha në</p>	E lartë	-Bashkia Patos të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish-komunave, sot NJA të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK. -Drejtoria e Financiare në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,074,287 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

	<p>ekonominë pyjore “Ana e Lumit Seman 2”, ndësa pjesa tjetër është në proces certifikimi, mbasi ka përfunduar faza e parë dhe e dytë e regjistrimit e inicuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe kompanisë së kontraktuar “C.-P. &amp; D.”.</p> <p>3. Nga auditimi i llogarisë 210 “Troje, toka, terrene” konstatohet se është përlogaritur normë amortizimi në vlerën 1,074,287 lekë. Duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit SKK nr. 5, “Afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, i përmirësuar, pika 30, nuk mund të aplikohet normë amortizimi për këtë llogari.</p>		
5	<p>Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 8,525,957 lekë. Në këtë vlerë është përfshirë edhe automjeti tip B. me targë AA.... me vlerë kosto historike 1,450,000 lekë i cili nuk është në gjendje pune dhe është nxjerrë jashtë përdorimit sipas Vendimit nr. 27, datë 13.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 1,450,000 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti” duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.</p>	E lartë	<p>-Bashkia Patos, Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,450,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 1 automjeti të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.</p>
6	<p>Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 5 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimi të lejes të ndërtimit dhe zbatimit të punimeve, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. “Ndërtim kantineve 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 21, datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., në adresën Dukas, Patos; 2. “Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë Vendimi nr.1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, NJA Zharrëz, Patos; 3. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., NJA Zharrëz, Patos; 4. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K., Sheqishtë, NA Zharrëz, Patos; 5. “Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M. S., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos. Veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 5, datë 07.03.2016; Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015; Vendimin nr. 5, datë 29.12.2014; Vendimin nr. 283, datë 01.04.2015.</p>	E lartë	<p>-Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë dhe statusin e pronës që të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.</p>
7	<p>Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e lartësisë së lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktuara sipas Vendimit, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: “Stallë për rritje derrash 1 kat b/a + metalike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 2, datë 27.02.2020, me zhvillues K. S., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 283, datë 01.04.2015.</p>	E lartë	<p>-Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar lartësisë të lejuara të strukturës së ndërtimit, në përputhje me rregulloren dhe kriteret e përcaktuara.</p>
8	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri Sheqishtë”, Bashkia Patos, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 17,564,628 lekë, realizuar nga OE “A. K.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 754,952 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe OE “A. K.” Shpk.</p>	E lartë	<p>Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 754,952 lekë pa tvsh nga OE “A. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022, me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>
9	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, Bashkia Patos, me vlerë të kontratës (pa tvsh)85,964,816 lekë, realizuar nga BOE “G.” Shpk &amp; “A.” Shpk &amp; “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 748,586 lekë pa tvsh.</p>	E lartë	<p>-Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 748,586 lekë pa tvsh nga BOE “G.” Shpk &amp; “A.” Shpk &amp; “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019, me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti””.</p>

	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1067/19 prot datë 24.09.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe BOE "G." ShPK & "A." ShPK & "Sh." SHPK.		Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
10	<p>Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Patos konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën <b>91,459,528 lekë</b>. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën <b>33,236,601 lekë</b>. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Patos janë në <b>vlerën 124,696,129 lekë</b>, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos e përbëra nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Detyrimet për taksën e tokës bujqësore në vlerën <b>53,023,566 lekë</b> për <b>2,618 familje</b>;</li> <li>-Detyrimet për taksën e ndërtesës në vlerën <b>22,921,574 lekë</b> për <b>5,357 familje</b>;</li> <li>-Detyrimet për taksën e pastrimit në vlerën <b>34,064,516 lekë</b> për <b>5,357 familje</b>;</li> <li>-Detyrimet për tarifën e shërbimit komunitar në vlerën <b>3,195,792 lekë</b> për <b>5,357 familje</b>;</li> <li>-Detyrimet për tarifën e vaditjes dhe kullimit në vlerën <b>2,557,411 lekë</b> për <b>657 familje</b>;</li> <li>-Detyrimet nga biznesi i vogël në vlerën <b>7,383,601 lekë</b>;</li> <li>-Detyrimet nga biznesi i madh në vlerën <b>1,549,669 lekë</b>;</li> </ul> <p>Lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Patos konstatohet se, të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore nuk janë marrë masa të tjera ligjore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me force e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, neni 114, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35, dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10. Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore".</p>	E lartë	<p>Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2022, në <b>vlerën totale 124,696,129 lekë</b>, e cila përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-<b>53,023,566</b> lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 2,618 familje;</li> <li>-<b>22,921,574</b> lekë detyrime për taksën e ndërtesës për 5,357 familje;</li> <li>-<b>34,064,516</b> lekë detyrime për taksën e pastrimit për 5,357 familje;</li> <li>-<b>3,195,792</b> lekë detyrime për tarifën e shërbimit komunitar për 5,357 familje;</li> <li>-<b>2,557,411</b> lekë detyrime për tarifën vaditje dhe kullimi për 657 familje;</li> <li>-<b>7,383,601</b> lekë detyrime nga biznesi i vogël;</li> <li>-<b>1,549,669</b> lekë detyrime nga biznesi i madh;</li> </ul> <p>a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.</p> <p>b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</p> <p>c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</p> <p>d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p> <p>e. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Patos, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</p> <p>f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</p>
11	<p>Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN konkretisht Regjistrin e Lejeve Minerare, Drejtorinë Rajonale të Fier, Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se për vitin 2022, në territorin e Bashkisë Patos ushtrojnë aktivitet subjektet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Subjekti "A." Shpk, i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1736, datë 23.12.2014, për shfrytëzimin e vendburimit Zharrëz për llojin e mineralit kongomeratë me sipërfaqe 0.428 km<sup>2</sup>.</li> <li>2. Subjekti "C." Shpk, i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1356, datë 04.06.2009, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Ruzhdie, Fier për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km<sup>2</sup>. Deri më datën 31.12.2022, Subjekti "C." Shpk ka detyrime të pa paguar të cilat lindin nga kontrata e qirasë me nr. 3113/1 prot., datë 28.12.2018, në vlerën <b>2,327,718 lekë</b> e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.</li> </ol> <p>-Gjithashtu në Bashkinë Patos dy subjektet që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi konkretisht për rërë bituminoze dhe konglomeratë nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së.</p>	E lartë	<p>-Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën <b>2,327,718 lekë</b> të papaguara ndaj Subjektit "C." Shpk sipas kontratës së qirasë me nr. 3133/1 prot., datë 28.12.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Ruzhdie, Fier për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km<sup>2</sup>.</p> <p>-Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor. Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa të menjëhershme ku t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloros këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.</p>
12	<p>Nga auditimi i 10 procedurave me vlerë totale të fondit limit <b>1,323,416 mijë lekë</b>, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 10 procedura me vlerë kontrate <b>1,275,339 mijë lekë</b> ose 100 % e vlerës. Në këto procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT. Vendosja jo e</p>	E lartë	<p>-AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në</p>



<p>drejtë e kritereve për kualifikim ka sjellë mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike, <b>respektivisht:</b></p> <p><b>1.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”. Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit <b>74,258 mijë lekë</b>, me fitues BOE “G.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk &amp; “A.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>72,259 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.</p> <p>Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.</p> <p>Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “G.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk &amp; “A.” Shpk.</p> <p>Aplikimi i kritereve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “G.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk &amp; “A.” Shpk, me ofertë 72,259 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>72,259 mijë lekë pa Tvsh</b> (86,710,948 lekë me Tvsh).</p> <p><b>2.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjistratit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës) ”Bashkia Patos, Viti 2019, me fond limit <b>450,024 mijë lekë</b>, me fitues OE “2....” Shpk, me vlerë të ofertës <b>444,056 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.</p> <p><b>3.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria” .Bashkia Patos,Viti 2021, me fond limit <b>8,042 mijë lekë</b>, me fitues BOE “H.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>7,397 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.</p> <p>Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.</p> <p>Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “H.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk.</p> <p>Aplikimi i kritereve në DT, të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “H.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk, me ofertë 7,397 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>7,937 mijë lekë pa Tvsh</b> (8,877,048 lekë me Tvsh).</p> <p><b>4.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjistratit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II” Bashkia Patos,Viti 2020, me fond limit <b>608,941mijë lekë</b>, me fitues OE “2.....” Shpk, me vlerë të ofertës <b>596,422mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.</p> <p><b>5.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës rrugës së Varrezave, Dukas”. Bashkia Patos,Viti 2021, me fond limit <b>12,160 mijë lekë</b>, me fitues BOE “H.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>8,956 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.</p> <p>Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.</p> <p>Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “H.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk.</p> <p>Aplikimi i kritereve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “H.” Shpk &amp;</p>	<p>skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Patos dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.</p>
---	--

<p>“Sh.” Shpk, me ofertë 8,956 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>8,956 mijë lekë pa Tvsh</b> (10,747,930 lekë me Tvsh).</p> <p><b>6.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Sistemim i hapësirave, lagjja 29 Marsi, Blloku të zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit <b>49,795 mijë lekë</b>, me fitues BOE “M. I. G.” Shpk &amp; “L. K.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>40,828 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.</p> <p>Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “M. I. G.” Shpk &amp; “H.” Shpk &amp; “Sh.” Shpk.</p> <p>Aplikimi i kritereve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “M. I. G.” Shpk &amp; “L. K.” Shpk, me ofertë 39,473 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>40,828, mijë lekë pa Tvsh</b> (48,994,499lekë me Tvsh).</p> <p><b>7.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë Patos”, Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit <b>10,537 mijë lekë</b>, me fitues BOE “L.... G.” Shpk dhe “2... K.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>7,685 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.</p> <p>Aplikimi i kritereve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “L.... G.” Shpk dhe “2.... K.” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>7,685 mijë lekë pa Tvsh</b> (9,222,252 lekë me Tvsh).</p> <p><b>8.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës Dukas Çoban”, Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit <b>12,568 mijë lekë</b>, me fitues BOE “A. C.” Shpk &amp; “6....-P.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>11,973 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.</p> <p>Aplikimi i kritereve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “A. C.” Shpk &amp; “6..P.” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>11,973 mijë lekë pa Tvsh</b> (14,368,211lekë me Tvsh).</p> <p><b>9.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”, Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit <b>15,932 mijë lekë</b>, me fitues OE “L.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>13,773 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.</p> <p>Aplikimi i kritereve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “L.” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>13,773 mijë lekë pa Tvsh</b> (16,528,523 lekë me Tvsh).</p> <p><b>10.</b> Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i palestrës”, Bashkia Patos, Viti 2022, me fond limit <b>81,153 mijë lekë</b>, me fitues OE “Sh.” Shpk, me vlerë të ofertës <b>71,986 mijë lekë</b>, rezulton, në aplikimin e kritereve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.</p>		
---	--	--

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### Opinioni i auditimit:

##### **Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Aparatit të Bashkisë Patos për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, shënimet shpjeguese, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj..

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në Standardet Nërkkombëtare të Auditimit (SNA-të) shprehim një **opinion të modifikuar (kualifikuar)**<sup>1</sup> për llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2022 të Aparatit të Bashkisë Patos, duke arritur në përfundimin se anomali të konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2022, të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të modifikuar. Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.

##### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 8,143 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2022, si dhe anomali të mëposhtme:

-Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar vlera 151,141,148 lekë e cila ka të bëjë me detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

-Për aktivet të cilat i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” është pasqyruar vlera 4,220,846 lekë, Bashkia Patos prej 1039 pronave që janë transferuar sipas VKM-ve respektive, vetëm për 29 prona posedon titull pronësie si dhe vetëm 91 prej tyre janë të regjistruara në kontabilitet, gjithashtu për këtë llogari është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 1,074,287 lekë ndërkohë që duke u bazuar në SKK nr. 5, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

-Llogaria 211 “Pyje, plantacione” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 682.75 ha pyje.

-Në llogarinë 215 “Mjete transporti” është pasqyruar vlera 1,450,000 lekë e cila i përket 1 automjeti të dëmtuar i cili duhej të kontabilizohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” paraqitet në vlerën 35,722,934 lekë, nga të cilat 2,208,274 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Patos nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

##### **II. Opinioni mbi përputhshmërinë**

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Patos, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të

<sup>1</sup>Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022.

audituesit të pavarur, janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kundërt** të përputhshmërisë.

#### **Baza për dhënien e opinionit të kundërt<sup>2</sup>**

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në kenë vlerën 167,677,530 lekë.

-Në 10 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)”, “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria” periudha 01.07.2019, deri më 31.12.2019; “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”, “Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas”, viti 2020, “Sistemim i hapësirave, lagjja “29 Marsi”, Blloku te zjarrëfiksja”, “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë Patos”, “Rikonstruksioni i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës Dukas Çoban”, viti 2021, “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”, “Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i palestrës” viti 2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

-Në 7 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 162,874,510 lekë, konkretisht si vijon:

1. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, me vlerë të fondit limit 74,258,784 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk me fond limit 72,259,124 pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

2. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”, me vlerë të fondit limit 8,042,742 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, me fond limit 7,397,540 pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

3. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas”, me vlerë të fondit limit 12,160,227 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk me fond limit 8,956,609 pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

4. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim i hapësirave, lagjja 29 Marsi, Blloku te zjarrëfiksja”, me vlerë të fondit limit 49,795,880 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk me fond limit 40,828,749 pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

5. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë Patos”, me vlerë të fondit limit 10,537,749 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, me fond limit 7,685,210 pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

6. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe ambulancës Dukas Çoban”, me vlerë të fondit limit 12,568,796 lekë pa Tvsh, zhvilluar në

---

<sup>2</sup>Sipas *Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 29.12.2022, Opinion i kundërt jepet nëse rastet kur mospërputhjet janë materiale dhe të përhapura.*

vitin 2021, është shpallur fitues BOE “A. C.” Shpk & “6..-P.” Shpk, me fond limit 11,973,509 pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

7. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë” me vlerë të fondit limit 15,932,480 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2022, është shpallur fitues OE “I.” Shpk, me fond limit 13,773,769 pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

-Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren.

1. Në pesë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimi të lejes të ndërtimit dhe zbatimit të punimeve.

2. Në një praktikë tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e lartësisë së lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

3. Në një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e tregueve të zhvillimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

4. Në një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mosparaqitjen e saktë të rievimit topografik duke pasqyruar gjendjen ekzistuese të parcelës dhe objekteve të tjera që zhvillohen në të.

5. Në një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mosparaqitja në sistemin “e-Leje” të marrëveshjes me pronarin e tokës dhe ndërmjet palëve të treta, në bazë të legjislacionit në fuqi.

6. Në një praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

7. Në një praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse.

8. Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatuan katër praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë lidhur me mungesën e pajisjes me “Certifikatë përdorimi” të objektit pasi ishte në përdorim.

9. Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatuan dy praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan tetë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja e mënyrës së llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë në njoftimin për pagesën e taksës.

10. Në pesë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimit në terren sipas rregullore dhe legjislacionit në fuqi.

11. Në tre praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me përdorimin e objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi dhe ndryshimi i destinacionit të përdorimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit të miratuar.

12. Në një praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve për katër kontrata është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale 2,081,633 lekë si pasojë e diferencave në realizimin e punimeve, konkretisht si më vijon:

1. Vlera 96,532 lekë për objektin: “Sistemimi i hapësirave, Lagja “29 Marsi”, Blloku Zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, për të cilën është shpallur fitues BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk.

2. Vlera 754,952 lekë për objektin: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri Sheqishtë”, Bashkia Patos, për të cilën është shpallur fitues BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk.

3. Vlera 481,563 lekë për objektin: “Rikonstruksion i segmentit “Hekuran Melova”, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, Bashkia Patos, për të cilën është shpallur fitues OE “C. R.” Shpk.

4. Vlera 748,586 lekë për objektin: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, Bashkia Patos, për të cilën është shpallur fitues BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Patos:**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Patos.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura, si dhe nëse veprimtaria në fushat e tjera të institucionit është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

**II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 119/1 prot., datë 31.01.2023, i ndryshuar me shkresën nr. 119/2 prot., datë 07.03.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.02.2023, deri më 24.03.2023, në institucionin Bashkia Patos u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”.

Auditimi financiar mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022, deri më 31.12.2022, ndërsa auditimi i përputhshmërisë prej datës 01.07.2019, deri më 31.12.2022.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. G. K. (Përgjegjës grupi)
2. A. Z., Anëtar
3. M. H., Anëtar
4. O. F., Anëtare
5. A. V., Anëtar
6. K. H., Anëtar
7. E. Ç., Anëtar

**1. Objektivat e auditimit**

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Bashkinë Patos kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar

kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>3</sup>;

-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

## **2. Qëllimi i auditimit**

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Patos është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

## **3. Identifikimi i çështjes**

Raportit Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Patos dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- ✓ Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- ✓ Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- ✓ Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- ✓ Auditim mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022.
- ✓ Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
- ✓ Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- ✓ Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

## **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

## **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

---

<sup>3</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

## 6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Patos është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Patos. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015. “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019, “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016, “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr.165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016, “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzim i MFE nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”.
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- Etj.,.

## 7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Patos grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;



- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.,. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët:

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi:

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Patos me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione:

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

#### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>4</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

---

<sup>4</sup>ISSAI 1315

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>ja</sup> aplikon<sup>5</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; observimet që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

### **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

Bashkia e Patosit kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkinë Mallakastër dhe në lindje me Bashkinë Roskovec. Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia Patos ka një popullsi prej 22.959 banorësh, ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banues 42,738 banorë. Territori i Bashkisë është vetëm 82.5 km<sup>2</sup>. Në bazë të të dhënave të regjistrin civil densiteti i popullsisë është 518 banorë për km<sup>2</sup>, ndërsa në bazë të censurit densiteti i popullsisë është 278.3 banorë për km<sup>2</sup>. Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si “Patos-Marrinza” është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë.

Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur. Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relieve kodrinor i kësaj zone.

Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fasone. Për shkak të relievit malor, në këtë bashki ka

---

<sup>5</sup>Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

zona të largëta me qendrën e Bashkisë, popullsia e tyre është reduktuar ndjeshëm për shkak të zhvendosjes drejt qendrave urbane të vendit ose drejt vendeve fqinje.

## 1. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

**1. Titulli i gjetjes:** Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mbi proceset e veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm.

**Situata:** a. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

b. Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të Njesisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Patos u konstatuan paregullsitë si më poshtë:

-Struktura e NJAB nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të kësaj njësie.

-NJAB nuk ka kryer auditimin e Drejtorisë së Financës e cila ka qenë pjesë e planit vjetor dhe është fushë me risk të lartë.

-Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pikat 2-3, Manuali për MFK i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, dhe Manuali për Auditin e Brendshëm i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 100, datë 17.10.2016.

**Ndikimi:** Mos njohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga institucioni. Mos auditimi i Drejtorisë së Financës risk të lartë mbi menaxhimin e fondeve të institucionit.

**Shkaku:** Mos hartimi i gjurmës së auditimit si dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave. Mos vlerësimi nga drejtuesi i NJAB dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditimin sipas planifikimeve.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë Patos të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizimin e tyre.

**Rekomandim:** Bashkia Patos të marrë masa për plotësimin me kapacitet të plotë me burimet njerëzore të nevojshme të strukturës së NJAB me qëllim mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e saj.

**Rekomandim:** Nga NJAB të merren masa që, pjesë e planit vjetor të vitit 2023 të përfshihen edhe auditimi të Drejtorisë së Financës. Nga Përgjegjësi i NJAB të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetariae Bashkisë Patos dhe z. H. M. me detyrë Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Auditimi u zhvillua në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë, kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

i. Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;

ii. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;

iii. Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Referuar të dhënave të paraqitura në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Patos si dhe duke u bazuar në përgjigjet e pyetësorit, më poshtë paraqesim punën e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregojnë se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në mënyrë të detajuar argumentohen si më poshtë:

### **1. Mjedisi i kontrollit**

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

#### **a. Integriteti dhe vlerat etike:**

-Nëpunësit e Bashkisë Patos duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

-Me Vendimin e Kryetares të Bashkisë znj. R. B. sipas shkresës nr. 52 prot., datë 07.01.2020, është miratuar Kodi i Sjelljes për Bashkinë Patos në të cilën janë të përfshirë rregulla të etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

Për vitin 2022 është miratuar kalendarin për trajnimin e punonjësve i miratuar nga Kryetaria e Bashkisë znj. R. B. me shkresën nr. 640 prot., datë 28.02.2022. Më datën 18.11.2022, është zhvilluar trajnimi i punonjësve të institucionit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin ku janë mbajtur dhe procesverbalet përkatëse për pjesëmarrjen në trajnim.

-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë bashkisë, ato regjistrohen pranë Zyrës së Protokollit të institucionit me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtorinë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

-Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

#### **b. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje:**

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkrjetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

-Çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale e protokoll.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së institucionit.

### **c. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë:**

-Me Vendimin nr. 21, datë 31.01.2022, të Kryetares të Bashkisë është miratuar rregullorja e brendshme e institucionit.

-Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Referuara të dhënave të paraqitura nga pyetëtori, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat disponohen procesverbale të takimeve të tyre, me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjesat me publikun.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Struktura organizative me numër 131 punonjës është në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë e cila është miratuar me Vendimin nr. 137, datë 28.12.2021, të Kryetares të Bashkisë znj. R. B..  
Realizimi i saj për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Viti	Muajt	Plani/Numër punonjës Nëpunës Civil	Realizimi/Numër punonjës Nëpunës Civilë	Diferenca	Plani/Numër punonjës Kod Pune	Realizimi/Numër punonjës Kod Pune	Diferenca
2022	Janar	66	53	13	65	64	1
2022	Shkurt	66	53	13	65	64	1
2022	Mars	66	53	13	65	64	1
2022	Prill	66	53	13	65	64	1
2022	Maj	66	53	13	65	64	1
2022	Qershor	66	53	13	65	64	1
2022	Korrik	66	53	13	65	64	1
2022	Gusht	66	53	13	65	64	1
2022	Shtator	66	53	13	65	64	1
2022	Tetor	66	60	6	65	64	1
2022	Nëntor	66	60	6	65	64	1
2022	Dhjetor	66	60	6	65	64	1

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

Për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 82.9% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 98.4%. Në total realizimi i strukturës është në masën 90.6%.

Mos plotësimi i strukturës organizative të Bashkisë Patos me numrin e plotë të punonjësve ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të institucionit.

#### **d. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave:**

Nëpunësit e Bashkisë Patos i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut III pika 3.1 Mjedisit i Kontrollit të Brendshëm, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, ku përcaktuar që:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune kriteret për rekrutimin e tyre përcaktohen bashkëlidhur shpalljes së vendit vakant të punës sipas specifikave të secilit pozicion.

Mbi politikat dhe praktikën e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe sektorëve si dhe ka një ndarje detyrash dhe përgjegjësish deri në nivel përgjegjës sektori dhe specialisti.

#### **e. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale:**

Çdo titullar i njësive publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësive. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësive publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësive si dhe përkujdeset për performancën e njësive publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësive.

Me shkresën nr. 70 prot., datë 07.01.2022, dhe Urdhrin e Kryetares të Bashkisë znj. R. B. është kryer një ndryshim në GMS i cili përfshin 23 punonjës (Administratorët e NJA Ruzhdie dhe Zharës) në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2.

-Nga GMS janë hartuar procesverbalet përkatëse për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për MFK i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësive publike”, pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësive, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

#### **2. Menaxhimi i riskut**

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësive, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësive publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësive së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut.

Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund ti delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës konkretisht nëpunësit zbatues.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Me shkresën nr. 2997/1 prot., datë 05.12.2022, është hartuar dhe miratuar nga GMS Strategjia e Menaxhimit të Riskut si dhe me shkresën nr. 2997 prot., datë 05.12.2022, është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për MFK i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

### **3. Aktivitet e kontrollit**

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësive dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Duke u bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi autorizues i njësive publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës.

Nëpunësi autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të

vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës”.

Për vitin 2022 Bashkia Patos nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet. Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për MFK i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Aktivitetet e kontrollit”.

Titullarët e njësisë kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit;

Në Kodin e Sjelljes të miratuar me shkresën nr. 52 prot., datë 07.01.2020, në nenet 15-19 janë të përcaktuara procedurat për sinjalizimin e parregullsive dhe parandalimi i korrupsionit.

-Bashkia Patos nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dalta gjatë kryerjes së detyrave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

#### **4. Monitorimi**

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i MFK kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, auditit të brendshëm.

Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.

Vlerësimi i sistemit të MFK bëhet duke plotësuar pyetëtorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.



Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm. Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues .

Me shkresën nr. 3291/1 prot., datë 28.02.2022, dhe shkresën nr. 3133/2 prot., datë 28.02.2023, nga Bashkia Patos është hartuar dhe dërguar pranë MF, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Raporti Vjetor për Funksonimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe PyetëSORIN e Vetëvlerësimit për Komponentët e MFK të Brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15 dhe Manualin për MFK , miratuar me Urdhrin e MF nr. 108, datë 17.11.2016 Kapitulli III, pika 3.5 “Monitorimi dhe raportimi”, si dhe formatin e rishikuar të pyetësorit nga MFE për vitin 2022, “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Gjithashtu është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për MFK i miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II pika 3.5 “Monitorimi dhe raportimi”, Aneksi nr.8.

## **5. Informimi dhe komunikimi**

Titullarët e njërive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në MFK.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga MF.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njërive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Patos dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

## 2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe sipas Vendimit nr. 137, datë 28.12.2021, të Kryetares të Bashkisë znj. R. B. është miratuar struktura organizative e Bashkisë Patos ku pjesë e saj është dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB) e përbërë nga tre pozicione konkretisht, 1 përgjegjës njësie dhe 2 specialist auditit. Përgjatë periudhës objekt auditimi pjesë e NJAB kanë qenë punonjësit si më poshtë:

- Z. H. M. me detyrë përgjegjës i njësisë së auditit të brendshëm.
- Znj. E. H. me detyrë specialiste auditit.

Deri më datë 31.12.2022, struktura e NJAB funksionon me 2 punonjës konkretisht: z. H. M. me detyrë përgjegjës i NJAB i cili është certifikuar që prej viti 2005, ndërsa znj. E. H. me detyrë specialiste e NJAB është në proces certifikimi.

Të dhënat e detajuara paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr.	Viti	Emër Mbiemër	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	2022	H. M.	Përgjegjës i Njësisë	Financë	41	16	2005	-
2	2022	E. H.	Specialiste Auditit	Financë	6.5	1.5	Në proces certifikimi	16 orë në vit

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se struktura e NJAB Bashkia Patos nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve pra nga 3 pozicione pune të miratuara sipas Vendimit nr. 137, datë 28.12.2021, të Kryetares të Bashkisë konkretisht një prej dy pozicioneve specialist auditit është vakant gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të kësaj njësie.

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Patos për vitin 2022 është miratuar me shkresën nr. 1524 prot., datë 16.06.2022, në përputhje me nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” e cila nuk është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në DPHAB pranë MFE për vitet 2023-2025 me shkresën nr. 2340/2 prot., datë 14.10.2022, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Referuar planit strategjik për vitin 2023 synohen të realizohen 15 auditime për vitin 2024 synohet të realizohen 15 auditime si dhe për vitin 2025 synohen të realizohen 15 auditime.

3. Raporti vjetor i veprimtarisë audituese për vitin 2022, është dërguar me shkresën nr. 225/2 prot., datë 10.02.2023, në DHAB në MFE, bashkëlidhur ndodhen edhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.6.

4. Struktura e Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2022 është hartuar e plotësuar sipas standardeve të vendosura në Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuar në përputhje me kërkesat e Manualit të AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

### Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Duke u bazuar në Planin Vjetor për vitin 2022, për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB i cili është miratuar me shkresën nr. 2327/2 prot., datë 19.10.2021, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

Nr.	Auditimet e planifikuara	Nr.	Auditimet e realizuara
1	Njësia Administrative Zharrëz	1	Njësia Administrative Zharrëz
2	Njësia Administrative Ruzhdie	2	Njësia Administrative Ruzhdie
3	Drejtoria e te ardhurave vendore	3	Drejtoria e te ardhurave vendore
4	Njësia e prokurimit publik	4	Njësia e prokurimit publik
5	Drejtoria e financës	5	Drejtoria e planifikimit urban
6	Drejtoria e planifikimit urban	6	MZSH
7	MZSH	7	Ujësjetllës Kanalizime Sha
8	Ujësjetllës Kanalizime Sha	8	Drejtoria e zhvillimit bujqësor
9	Drejtoria e zhvillimit bujqësor	9	Drejtoria e shërbimit social
10	Drejtoria e shërbimit social	10	Agjensia e shërbimeve publike
11	Ndërmarrja e pastrimgjelbërimit	11	Klubi sportive "A."
12	Ndërmarrja e mirëmbajtjes urbane		
13	Klubi sportiv "A."		

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Seksioni VI, Kreu III, pika 1, programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimit dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vendosura në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi. Për vitin 2022 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t'u kryer 13 auditime dhe janë realizuar 11 auditime në masën 85%.

Gjithashtu vlen të theksohet se për vitin 2022 në lidhje me auditimet e pa realizuara, NJAB sqaron se mos realizimi ka ardhur për shkak sepse Ndërmarrja e Pastrimit dhe Ndërmarrja e Gjellbërimit të paraqitura në Programin Vjetor me nr. 2327/2 prot., datë 19.10.2021, u mbyllën me VKB nr. 66 dhe VKB nr. 67, datë 14.10.2021, për të krijuar Agjensinë e Shërbimeve Publike me VKB nr. 68, datë 14.10.2021, për të cilën është kryer angazhimi për auditim në vitin 2022.

Në planin vjetor është parashikuar angazhimi për realizimin e auditimit të Drejtorisë së Financës por ky angazhim nuk është realizuar. Pra plani i auditimeve ka qenë 13 angazhime auditimi dhe realizimi është 12 angazhime auditimit (përfshirë edhe auditimin e dy subjekteve të cilat janë bashkuar në një të vetëm) ose në masën 92.3%.

-Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2022 dhe faza e zbatueshmërisë së tyre paraqitet në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

VITI 2022							
Nr.	Subjekti i Audituar	Numri i rekomandimeve	Pranuara	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
1	Njësia Administrative Zharrëz	4	4	4	0	0	0
2	Njësia Administrative Ruzhdie	4	4	4	0	0	0
3	Drejtoria e te ardhurave vendore	4	4	4	0	0	0
4	Njësia e prokurimit publik	1	1	1	0	0	0
5	Drejtoria e planifikimit urban	1	1	1	0	0	0
6	MZSH	1	1	1	0	0	0
7	Ujësjetllës Kanalizime Sha	2	2	2	0	0	0
8	Drejtoria e zhvillimit bujqësor	2	2	2	0	0	0
9	Drejtoria e shërbimit social	0	0	0	0	0	0
10	Agjensia e shërbimeve publike	2	2	2	0	0	0
11	Klubi sportiv "A."	2	2	2	0	0	0
<b>Total</b>		<b>23</b>	<b>23</b>	<b>23</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

-Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualit të AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016.

-Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese", në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e

auditimit, drejtimit që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

-Nga Përgjegjësi i NjAB nuk është vepruar konform me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

## **2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

### **1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.**

Nga auditimi i procedurave për hartimin e PBA-së 2022-2024 konstatohet se, për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr. 2827, datë 30.03.2021, “Për krijimin e GMS për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2022-2024”.

PBA për periudhën 2022-2024 është miratuar në VKB nr. 71, datë 14.12.2021, “Për miratimin e Buxhetit Afatmesëm 2022-2024”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 3061/2 prot., datë 17.12.2021.

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Faza e parë e PBA-së 2022-2024 është miratuar në KB në muajin Qershor, me VKB nr. 29, datë 29.06.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 719/1 prot., datë 12.07.2021.

Rapori i vlerësimit dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave është miratuar me VKB nr. 11, datë 24.02.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 239/1 prot., datë 03.03.2021.

Nga Bashkia Patos janë përgatitur dhe dërguar për miratimin në KB, tavanet përgatitore të PBA-së 2022-2024 më datë 24.03.2021, sipas shkresës së MFE për transfertat me shkresën nr. 5239 prot., datë 18.03.2021, si dhe janë miratuar tavanet për çdo program në Këshillin Bashkiak brenda afatit në muajin mars të vitit 2021, me VKB nr. 15, datë 30.03.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 90/4 prot., datë 09.04.2021.

Me Urdhrin nr. 6, datë 08.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë znj. R. B. është ngritur GMS dhe ekipet e menaxhimit të programeve (EMP).

Është miratuar Udhëzimi i Brendshëm për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm nr. 1, datë 31.03.2021.

Drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve kanë marrë tavanët përgatitor për hartimin e kërkesave buxhetore me shkresën nr. 90/4 prot., datë 09.04.2021, si dhe kanë paraqitur kërkesat buxhetore sipas programit tekordinatori i GMS me shkresën nr. 90/6 prot., datë 29.05.2021.

Projekt dokumenti i parë i PBA 2022-2024, është miratuar brenda afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 10, datë 28.02.2020, të MFE.

Nga Bashkia Patos janë dokumentuar dhe ndjekur të gjitha hapat e tjera në vijim si dhe është publikuar dokumentin e parë të PBA-së brenda datës 5 korrik 2021.

Në dokumentin e PBA-së janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si dhe është bërë analiza e zërave të buxhetit në tre vite dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin kjo PBA.

Për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, sipas kalendarit të miratuar me VKB nr. 70, datë 14.12.2021, si dhe kalendarit të

konsultimit publik të cilat janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të bashkisë, dokumentet e evidentimit të kryerjes së këtyre konsultimeve.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga NJA, drejtuesit e programeve për gjithë funksionet që mbulojnë, e cila vërtetohet me kërkesat për nevojat reale, dhe mbi bazën e tyre të hartohet buxheti.

Në VKB nr. 71, datë 14.12.2021, për miratimin e buxhetit bazë/fillestar vjetor, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 273,582,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 134,575,000 lekë, transfertat specifike ka vlerën 97,605,000 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 505,762,000 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 505,762,000 lekë.

Përgjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të KB të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në Dhjetor 2022). Këto ndryshime paraqiten si më poshtë:

-VKB nr. 11, datë 28.02.2022, për mbulimin e fondit të bashkëfinancimit dhe miratimin e listës së familjeve për aplikimin e projektit: “Përmirësimi i banesave egzistuese për familje në nevojë”.

-VKB nr. 26, datë 27.04.2022, “Për ndryshimin e destinacionit të ish-kopështit në lagjen “Mustafa Matohiti”, në fond banesë për 2 familje në nevojë”.

-VKB nr. 27, datë 27.04.2022, “Mbi dhënien e ndihmës financiare për shkak të një sëmundje të rëndë znj. L. M.”.

-VKB nr. 30, datë 26.05.2022, për miratimin e projektit: “Shërbim në familje për personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij”.

-VKB nr. 32, datë 26.05.2022, “Për një ndryshim në VKB nr. 71, datë 14.12.2021, “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të buxhetit afatmesëm 2022-2024 dhe buxhetin e bashkisë për vitin 2022”.

-VKB nr. 33, datë 26.05.2022, “Për një ndryshim në VKB nr. 69, datë 14.12.2021, mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”.

-VKB nr. 42, datë 20.06.2022, “Për miratimin e projektit: “Rikonstruksioni i rrugës Zharrëz- Shën Maria” dhe bashkëfinancim nga “B. P. A.” L..

-VKB nr. 45, datë 20.06.2022, “Për dhënien e ndihmës financiare z. E. G. për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë në fshatin Belinë NJA Zharrëz”.

-VKB nr. 50, datë 20.07.2022, “Për miratimin e projektit: “Rikonstruksioni i shkollës Muhamet Shehu dhe ndërtim i palestrës” me bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

-VKB nr. 59, datë 03.08.2022, “Për miratimin e projektit: “Përmirësimi i infrastrukturës së Qendrës Kulturore të Fëmijëve, autorizimit të Kryetares së Bashkisë për nënshkruar kontratën e grantit dhe bashkëfinancimit me E. M.”.

-VKB nr. 62, datë 03.08.2022, “Për miratimin e shtimit të vlerës së projektit: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfalto beton të rrugës Banaj”.

-VKB nr. 69, datë 15.09.2022, “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile në Bashkinë Patos”.

-VKB nr. 73, datë 04.10.2022, “Për ndryshimin e VKB nr. 69, datë 14.12.2021, mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”.

-VKB nr. 87, datë 25.11.2022, “Për dhënien e ndihmës financiare z. Xh. G. për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”.

Të dhënat për PBA dhe projektbuxhetet për vitin 2022 si më poshtë:

000/Lekë

Viti 2022					
Llogaria	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	PBA Faza e I-rë	PBA Faza e II-të	Buxheti Final
600	Paga	210,503	199,263	199,263	206,426
601	Sigurime Shoqërore	35,085	33,453	33,453	34,512
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	102,771	104,993	104,993	128,254
604	Transferta Korente të Huaja	7,973	24,125	24,125	8,298

606	Trans për Buxhet Familjarë dhe Individ	27,473	5,252	5,252	4,572
<b>I</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>383,805</b>	<b>367,086</b>	<b>367,086</b>	<b>382,062</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	7,573	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	295,446	123,538	123,538	123,700
	<b>Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>303,019</b>	<b>123,538</b>	<b>123,538</b>	<b>123,700</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-
	<b>Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>303,019</b>	<b>123,538</b>	<b>123,538</b>	<b>123,700</b>
<b>III</b>	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>I+II +III Totali I Shpenzimeve</b>	<b>686,824</b>	<b>490,624</b>	<b>490,624</b>	<b>505,762</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2019-2022 paraqitet si më poshtë:

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1	Të ardhurat faktike	562,643	552,683	679,471	689,676
2	Shpenzimet faktike	470,054	385,973	440,920	443,482

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Me VKB nr. 10, datë 25.02.2022, është kryer shtesë në buxhet duke u alokuar fondet e trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 243,543,235 lekë nga të cilat 5,000,000 lekë shtesë transfertë e pakushtëzuar e vitit 2022.

Lista e investimeve të reja të parashikuara në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe granti është paraqitur në mënyrë analitike në Projektraportin e Auditimit.

#### Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Plani përfundimtar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600 + 601) (nga të ardhur e grant i pakushtëzuar e specifike)	240,938	232,716	8,222
2	Shpenzime (602, 604, 609) (nga ardhura e grant i pakushtëzuar e specifike)	141,123	134,370	6,753
3	Investime Bashkia (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar)	123,701	123,538	163
4	Investime nga FZSHH	-	-	-
	<b>Total i planit fillestar</b>	<b>505,762</b>	<b>490,624</b>	<b>15,138</b>
	Shtesat nga Pushteti Qendror	412,901	-	-
5	Investime grant i kushtëzuar	197,474	-	-
6	Shpenzime për pagat (600 + 601)	4,280	-	-
7	Shpenzime (602, 604, 609)	211,147	-	-
	Grant i kushtëzuar (230-231)	197,474	-	-
	<b>Gjithsej</b>	<b>918,663</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Për vitin 2022 me miratimin e Buxhetit të Shtetit, Bashkisë Patos u miratua shtesë në transfertën e pakushtëzuar dhe në atë specifike në vlerën 15,138 mijë lekë e cila është reflektuar edhe në buxhetin përfundimtar të Bashkisë për vitin 2022. Ndryshimet kanë ardhur si rezultat i ndryshimit të transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale nga Buxheti i Shtetit me shkresën nr. 18976 prot., datë 29.10.2021, dhe rritjen e nivelit të parashikuar të të ardhurave me VKB nr. 58, datë 26.12.2021, “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2022”.

Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2022, paraqitet si më poshtë:

000/Lekë

Kodi i detyrimit të prapambetura	Emërtimi i detyrimit të prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv më 31.12 2020	Planifikimi për likuidim në planin e buxhetit 2022 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2022 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit
4864100	Për vendimet gjyqësore	0	0	0
4864200	Për sherbime	0	0	0
4864300	Për mirëmbajtje	0	0	0
4864400	Për investime	0	0	0
4864400	Për investime nga Ministrinë e Linjes	0	0	0
4865600	Për mallra	0	0	0

4864900	Të tjera	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Lista analitike e detyrimeve të prapambetura për investimet më 31.12.2022 dhe planifikimi për likuidim në planin e këtij buxheti.

000/Lekë

Nr.	Emërtimi i objektit kontratës së pa likuaduar	Data e lidhjes së kontratës	Vlera e pa likuaduar e kontratës	Vlera e kontratës planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2022	Pagesa në fakt gjatë vitit 2022 e detyrimit të kontratës	Vlera e pa likuaduar më 31.12.2022	Burimi i financimit
1	Mbikqyrës "Sistemi i Bilokut të Zjarrfiskja ne Lagjen 29 Marsi vazhdim"	Nr. 851/14prot., datë 03.08.2021	868	868	0	0	Transferta e pakushtezuar
2	Rikonstruksioni i segmentit Hekuran Melova, degëzim i rrugës Late Bregu" tepallatet dy katësh"	Nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022	30,589	30,589	0	0	Të ardhurat e Bashkisë
<b>Totali</b>			<b>31,457</b>	<b>31,457</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

## 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga pushteti qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtezuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë periudhës së audituar, janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit, këto lëvizje janë kryer me urdhër të titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Përgjatë vitit 2022 janë marrë disa vendime të tjera nga Këshilli Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë të miratuar në muajin dhjetor të vitit 2021, si më poshtë:

Me VKB nr. 10, datë 25.02.2022, është kryer shtesë për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 243,550,935 lekë. Gjitha shtesa buxheti pasur edhe nga fondet e pushtetit qendror sipas shkresës nr. 16040 prot., datë 29.08.2022, shkresën nr. 2317/1 prot., datë 28.12.2022, shkresën nr. 1954/1 prot., datë 17.11.2022, shkresën nr. 130 prot., datë 05.01.2023, nga MFE. Të dhënat mbi ndryshimet e buxhetit për vitin 2022 shtesa dhe pakësime paraqiten si më poshtë:

000/Lekë

Periudha buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë vitit		Ndryshimet e ndodhura të buxhetit					
	Nr./datë	Vlera	Nr./datë	Vlera	Shtesa	Shuma	Pakësime	Shuma		
2022	Nr. 71, datë 14.12.2021	505,762	VKB nr. 10, datë 25.02.2022	243,543	602	30,045	0	0		
					604-609	2,000	0	0		
							231	211,499	0	0
					Pushteti Qendror	2,189	600+601	2,189	0	0
					Pushteti Qendror	8,450	231	8,450	0	0
<b>Totali</b>						<b>254,183</b>				

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të EMP për buxhetin afatmesëm 2022-2024, ku kërkesat janë hartuar duke iu referuar kryesisht realizimit të artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Patos konstatohet se për vitin 2022, gjendja fillestare e planit të çelur së bashku me fondet e trashëguara është 505,762 mijë lekë. Me VKB e

sipërpërmendura ka pasur shtesë buxheti në vlerën 254,183 mijë lekë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të hartimit dhe zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Fier dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2022, u konstatua se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit 2022, buxheti i Bashkisë Patos ka pësuar ndryshime nëpërmjet VKB, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Fier.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit Fier dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave dhe tarifave të Bashkisë dhe të granteve. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Patos janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Fier, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve. Gjatë auditimit, rezulton se Kryetari i Bashkisë ka raportuar normalisht në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

### 3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha 01.01.2022 deri datën 31.12.2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

000/Lekë				
Emërtimi i shpenzimeve	Artikulli	Plan	Fakt	Realizimi në %
Paga	600	143,336	130,445	91%
Sigurime shoqërore	601	24,739	22,194	89.7%
Shpenzime operative	602	104,140	55,539	53.5%
Transferimekorrenteteknivele të tjera të Qeverisë	604	6,498	750	11.5%
Transferta në buxhetet familjare	606	6,692	5,188	77.5%
Fondi rezervë	609	0	0	-
Investime	230-231	314,595	81,879	26%
<b>Totali i planit Bashkia</b>		<b>600,000</b>	<b>295,995</b>	<b>49.3%</b>
Transferta buxhetore kushtëzuarfunksionet e deleguarapaga	600	3,700	3,437	92.8%
Transferta buxhetore kushtëzuarfunksionet e deleguarasigurime	601	580	574	98.9%
Transferta buxhetore paaftësi e ndihmë ekonomike	606	203,955	202,673	99.3%
<b>Shuma totale</b>		<b>808,235</b>	<b>502,679</b>	<b>62.1</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*



Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nuk ka diferenca ndërmjet buxhetit të miratuar sipas VKB të sipërpërmendura dhe të dhënave të paraqitura në relacion dhe projektvendimin e hartuar nga Drejtoria e Financës.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë:

Me VKB nr. 71, datë 14.12.2021, është planifikuar vlera 8,298,000 lekë nga e cila 2,000,000 lekë i përket fondit rezervë. Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, është përlllogaritur vlera deri në 3% të buxhetit vjetor. Vlera e përdorur nga fondi rezervë është 600,000 lekë si më poshtë:

-Me VKB nr. 27, datë 27.04.2022, “Ndhimë financiare” në vlerën 100,000 lekë.

-Me VKB nr. 45, datë 20.06.2022, “Ndhimë financiare” në vlerën 50,000 lekë.

-Me VKB nr. 87, datë 25.11.2022, “Restaurim i një banesa për familje në nevojë” në vlerën 450,000 lekë.

Bashkia Patos për vitin 2022 nuk ka përfutuar subvencione nga Pushteti Qendror.

Bashkia Patos për vitin 2022 nuk ka aplikuar për kredi.

**2. Titulli i gjetjes:** Diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, për zërat të cilët mbulohen nga të ardhurat e veta.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e veta të Bashkisë Patos së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, për vitin 2022 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 808,235 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 502,679 mijë lekë, ose në masën 62.1%. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën 314,595 mijë lekë, realizuar 81,879 mijë lekë, ose nëmasën 26%. Gjithashtu edhe shpenzimet operative të cilat janë planifikuar në vlerën 104,140 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 55,539 mijë lekë ose në masën 53.5%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Patos në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse.

**Ndikimi/Efekti:** Planifikimi joreal i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

**Shkaku:** Planifikim i të ardhurave dhe më pas i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik. Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mosnxjerrja e konkluzioneve të sakta për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore me qëllim hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetare e Bashkisë Patos dhe znj. M. Sh. me detyrë Drejtore e Financës.

#### 4. Vlersësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, vlera e raportuar nga Bashkia Patos në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022, është 0 lekë, përveç detyrimeve nga financimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për objektin "Rikonstruksion Magjistrali Ujësjiellësit Loti I dhe II dhe Supervizioni i Punimeve, është 814,442 mijë lekë (sipas kontratave të lidhura).

000/Lekë

Nr.	Objekti i prokurimit	Kontrata nr.. datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuiduar	Vlera e pa likuiduar	Arsyet e mos likuidimit
1	Rikonstruksion Magjistrali i Ujësjiellësit Loti I dhe supervizues	Nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020. Nr. 2506/1 prot., datë 31.03.2020	537,836	413,150	124,686	Mungese Financimi nga Ministria e Energjitikes
2	Rikonstruksion Magjistrali i Ujësjiellësit Loti II dhe supervizues	Nr. 1851/11 prot., datë 10.12.2020. Nr. 1917/12 prot., datë 26.02.2021	710,531	20,775	689,756	Mungese Financimi nga Ministria e Energjitikes
<b>Totali</b>			<b>1,248,367</b>	<b>433,925</b>	<b>814,442</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

-Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet (nga të ardhurat e veta).

000/Lekë

Nr.	Emërtimi i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	Rikonstruksioni i segmentit Hekuran Melova, degëzim i rrugës Late Bregu" tepallatet dy katësh"	C. R.	2324/57.prot., datë 19.09.2022	Nr. 232, datë 27.12.2022	232/2022	0	0	0	9724
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>9,724</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

-Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet (Nga granti)

000/Lekë

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	Mbikqyrës "Sistemim i Bllokut te Zjarrfiskja ne Lagjen 29 Marsi vazhdim "	S.	Nr.851/14.prot., datë 03.08.2021	Nr. 1/2023, dtatë 10.01.2023	Nr. 01/2023	0	0	0	723
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>723</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

-Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për mallrat dhe shërbimet (Nga të ardhurat e veta)

000/Lekë

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) në 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	Uji Dhjetor 2022	Sha Ujësjes Patos	-	471/ 23.12.2022	471/2022	0	0	0	105,534
2	Karburanti Bashkia	O. shpk	13.07.2022	58/06.01.2023	58/2023	0	0	0	7,960
3	Lavazho Dhjetor 2022	G.	02.02.2022	366/29.12.2022	366/2022	0	0	0	24,240
4	Posta dhjetor	Posta	-	25/ 06.01.2023	25/2023	0	0	0	27,185
5	Posta dhjetor	Posta	-	30/06.01.2023	30/2023	0	0	0	700
6	Energjia Dhjetor	FSHU	-	19.01.2023	Përmbledhëse	0	0	0	186,276
7	Internet dhjetor 2022	M.	06.04.2022	337/29.12.2022	337/2022	0	0	0	19,853
8	Energjia Dhjetor	FSHU	-	19.01.2023	Përmbledhëse	0	0	0	225,947
9	Energjia Dhjetor	FSHU	-	19.01.2023	Përmbledhëse	0	0	0	15,976
10	Karburanti MZSH	O. shpk	13.07.2022	59/06.01.2023	59/2023	0	0	0	5,970
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>619,641</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

Referuar auditimit të dokumentacionit të bankës konstatohet se këto detyrime janë likuiduar brenda periudhës janar-shkurt të vitit 2023 sipas urdhër shpenzimeve përkatëse.

Lista analitike e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

- Mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme:

**000/Lekë**

Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2022	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2022	Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2022	Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2022	Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2022	Detyrimi në lekë më 31.12.2022
Nr.318 datë 09.03.2018 lënë në fuqi me vendimin 420 datë 24.02.2020	a) 405,927 lekë detyrimi b) 200,722 lekë Shpenzime gjyqësore c) 58250.8 lekë tarifë përmbartimore.	2	a) 405,927 lekë detyrimi b) 200,722 lekë Shpenzime gjyqësore c) 58250.8 lekë tarifë përmbartimore.përmbartimore	a)284,691 lekë detyrimi. b)200,722 lekë(PAG.21) shpenzime gjyqësore c)58,250 lekë shpenzimepër mbarimore	Vlera prej 121,236.34 lekë detyrim i ngelur
Nr.943 datë 19.05.2020	896,000		896,000	896,000	0

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

Shpenzimet gjyqësore janë planifikuar në vlerën 1,500,000 lekë dhe realizuar në vlerën 1,238,941 lekë. Ndërsa vlera 121,236 lekë është likuiduar në muajin mars të vitit 2023. Gjithashtu Bashkia Patos nuk ka pasur raste për dëshpërlim page për vitin 2022. Bashkia Patos për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 1,221,236 lekë, e cila i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore.

Totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2022 ka vlerën 295,995,000 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta më 31.12.2022 (pa përfshirë detyrimet e FZHR), ka vlerën 0 lekë. Raporti i këtyre treguesve, praraporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 0 %.

## 5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Pasqyra e kontratave për investime dhe likuidimet sipas periudhave.

000/Lekë

Nr.	Objekti i prokurimit	Kontrata nr.. datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuajduar	Vlera e pa likuajduar	Arsyet e mos likuajdit
1	Rikonstruksion Magjistrali i Ujësllësit Loti I dhe supervizues	Nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020. Nr. 2506/1 prot., datë 31.03.2020	537,836	413,150	124,686	Mungese Financimi nga Ministria e Energjitikes
2	Rikonstruksion Magjistrali i Ujësllësit Loti II dhe supervizues	Nr. 1851/11 prot., datë 10.12.2020. Nr. 1917/12 prot., datë 26.02.2021	710,531	20,775	689,756	Mungese Financimi nga Ministria e Energjitikes
<b>Totali</b>			<b>1,248,367</b>	<b>433,925</b>	<b>814,442</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

**Raportet e Monitorimit**

Për vitin 2022 nga Bashkia Patos është përgatitur raporti i monitorimit me shkresën nr. 582/1 prot., datë 24.02.2023, i cili është dërguar MFE, ku është publikuar më datë 28.02.2023, në faqen Web të Bashkisë.

(Përsa trajtuar më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 7, datë 24.03.2023, dhe në Projekt Raportin e Auditimit)

**6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.****➤ Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:**

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Patos është miratuar me Vendimin nr. 137, datë 28.12.2021, të Kryetares të Bashkisë znj. R. B. ku pjesë e saj përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore (në vijim DAV). Kjo drejtori sipas strukturës së miratuar ka në përbërje të saj 5 punonjës konkretisht: 1 drejtor drejtorie, 2 specialist për taksat dhe tarifave për të ardhurat dhe 2 inspektor. Krahas strukturës në bashki, në njësitë administrative ka nga një punonjës të ngarkuar me vjeljen e taksave dhe tarifave të popullatës, ndërsa në NjA Zharëz ka dy punonjës tregu. Struktura e DAV për vitin 2022 paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni
1	A. M.	Drejtor i të Ardhurave Vendore
2	S. M.	Specialist i taksave dhe tarifave për të ardhurat
3	Vakant	Specialist i taksave dhe tarifave për të ardhurat
4	E. Q.	Inspektor
5	E. A.	Inspektor

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se struktura e DAV nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve pra nga 5 pozicione pune të miratuara sipas vendimit të sipërpërmendur, një prej dy pozicioneve “Specialist i taksave dhe tarifave për të ardhurat” është vakant gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të kësaj drejtorie.

**➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:**

**3. Titulli i gjetjes:** Nuk është kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ku t'i referohet kërkesave reale të institucionit.

**Situata:** Me VKB nr. 58, datë 26.11.2021, është miratuar struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave të cilat do të aplikohen në territorin e Bashkisë Patos për vitin 2022. Referuar planit vjetor të miratuar, aktrakordimeve me Degën e Thesarit Fier si dhe të dhënave të nxjerra nga sistemi TAIS (*Tax Administration Information System*), parashikimi dhe realizimi i të ardhurave të Bashkisë Patos për vitin 2022 paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	Realizimi në %	Diferenca
<b>A</b>	<b>Të ardhurat nga taksat</b>	<b>178,538,000</b>	<b>162,596,151</b>	<b>91%</b>	<b>- 15,941,849</b>
1	Taksa mbi ndërtesën	21,386,000	9,869,583	46%	- 11,516,417
2	Taksa mbi tokën bujqësore	21,006,000	8,473,709	40%	- 12,532,291
3	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	5,600,000	1,771,953	32%	- 3,828,047
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë	300,000	0	-	- 300,000
5	Taksa e rregjistrimit të automjeteve	15,489,000	17,596,293	113%	+ 2,107,293
6	Taksë table	630,000	882,740	140%	+ 252,740
7	Taksa e Rentës minerale	71,243,000	76,567,420	107%	+ 5,324,420
8	Taksa e truallit	38,082,000	37,396,801	98%	- 685,199

9	Tatim i thjeshtuar i biznesit të vogël	0	119,867	-	+ 119,867
10	Taksë tregu	1,290,000	566,300	44%	- 723,700
11	Taksë rregjistrimi biznesi	0	0	-	0
12	Tatim mbi të ardhurat personale TAP	3,512,000	7,804,926	233%	+ 4,292,926
<b>B</b>	<b>Të ardhurat jo tatimore</b>	<b>95,044,000</b>	<b>40,717,370</b>	<b>43%</b>	<b>- 54,326,630</b>
1	Tarifa e pastrimit	33,038,000	18,719,503	57%	- 14,318,497
2	Tarifa për hapsirat publike	250,000	30,000	12%	- 220,000
3	Tarifa e ndriçimit	1,555,000	1,239,458	80%	- 315,542
4	Tarifa e gjelbërimit	1,555,000	1,383,708	89%	- 171,292
5	Tarifa për reklamë	419,000	0	-	- 419,000
6	Tarifa për parkim	891,000	687,096	77%	- 203,904
7	Tarifa e shërbimit veterinar	2,046,000	0	-	- 2,046,000
8	Tarifa për shërbime të tjera administrative	1,100,000	1,171,642	106%	+ 71,642
9	Tarifa për dhënie leje licenca dhe autorizime	3,119,000	1,204,836	39%	- 1,914,164
10	Tarifë ndotje mjedisi	40,956,000	11,072,500	27%	- 29,883,500
11	Tarifë mirëmbajtje vaditje kullim	880,000	660,013	75%	- 219,987
12	Qira toke	1,300,000	268,120	21%	- 1,031,880
13	Qira ndërtese	1,000,000	1,793,407	179%	+ 793,407
14	Dhurata dhe sponsorizime	0	0	-	0
15	Të ardhura nga gjobat	500,000	336,200	67%	- 163,800
16	Të ardhura nga pagesat kopësht dhe çerdhe	2,800,000	1,711,679	61%	- 1,088,321
17	Sekuestrime dhe zhdëmtime	0	0	-	0
18	Të tjera jotatimore	0	0	-	0
19	Grant nga nivele të tjera	0	0	-	0
20	Tarifa për shërbim komunitar	3,635,000	439,208	12%	- 3,195,792
<b>Totali</b>		<b>273,582,000</b>	<b>203,313,521</b>	<b>74%</b>	<b>- 70,268,479</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën **273,582,000 lekë** dhe realizimi në vlerën **203,313,521 lekë** ose në masën **74%** pra ka **një mosrealizim të të ardhurave në vlerën 70,268,479 lekë**.

Me tejkallim paraqiten zërat si më poshtë:

1. “Taksa e regjistrimit të automjeteve” është planifikuar në vlerën 15,489,000 lekë ndërsa arkëtimet janë vlerën 17,596,293 lekë ose realizuar në masën 113%.
2. “Taksa e rentës minerale” është planifikuar në vlerën 71,243,000 lekë ndërsa arkëtimet janë vlerën 76,567,420 lekë ose realizuar në masën 107%.
3. “Tatim mbi të ardhurat personale TAP” është planifikuar në vlerën 3,512,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,804,926 lekë ose realizuar në masën 233%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

1. “Taksa mbi ndërtesën” është planifikuar në vlerën 21,386,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 9,869,583 lekë ose realizuar në masën 46%.
2. “Taksa mbi tokën bujqësore” është planifikuar në vlerën 21,006,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,473,709 lekë ose realizuar në masën 40%.
3. “Tarifa e pastrimit” është planifikuar në vlerën 33,038,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 18,719,503 lekë ose realizuar në masën 57%.
4. “Tarifë ndotjemjedisi” është planifikuar në vlerën 40,956,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 11,072,500 lekë ose realizuar në masën 27%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.

Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifave vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2022 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Patos që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkallimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**Ndikimi:** Mos planifikimi i saktë i të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifave vendore ndikon në hartimin e buxhetit të bashkisë, në angazhimet që parashikohen të ndërmerren gjatë vitit buxhetor. Për të ardhurat të cilat vijnë nga detyrimet prapambetura nga taksave dhe tarifave të cilat janë të pa planifikuara, shpërndahen sipas zërave por nuk ka një ndarje të ardhurave nga detyrimet e prapambetura dhe ato aktuale duke mos pasqyruar qartë se cili është burimi i tyre duke ndikuar në nivelin e realizimit të plan-faktit të të ardhurave vjetore të Bashkisë Patos.

**Shkaku:** Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshëm bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

#### ➤ **Agjentët tatimorë dhe rakorimet me ta:**

**4. Titulli i gjetjes:** Mangësi të konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e agjentëve tatimorë.

**Situata:** Duke u bazuar në rregulloren e brendshme të institucionit të aplikuar për vitin 2022 miratuar me Vendimin nr. 21, datë 31.01.2022, të Kryetares të Bashkisë Patos, në këtë rregullore nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë MFK në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura, derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Patos dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Fier.

Në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë u konstatua se nga Bashkia Patos nuk është krijuar një bazë e dhënash e plotë dhe e saktë, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë

asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Patos, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit Fier.

Po kështu, edhe në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Patos nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit.

Përsa i përket rakordimeve me agjentët tatimorë, u konstatua se:

a) Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet bëhet rakordim periodik i rregullt mujor me Degën e Doganës Vlorë dhe mbahet korespondencë me Ministrinë e Financave. Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Në opinionin e grupit të auditimit vlerësohet se korespondenca vetëm me një degë doganore nuk është e mjaftueshme, pasi eksporte mund të bëhen edhe nga degë të tjera, gjë që e bën të domosdoshëm bashkëpunimin dhe rakordimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

b) Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin ndiqet rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier.

c) Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura janë mbajtur rakordime me DRSHTRR Fier në periudha të ndryshme brenda vitit.

ç) Taksa e kalimit të pronësisë është derdhur për llogari të Bashkisë në kohë jo periodike. Aktet e rakordimit nuk janë mbajtur rregullisht.

Për detyrimet e familjarëve konstatohet se “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Patos nuk është caktuar si agjent tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

Lekë			
Nr.	Emërtimi	Plani 2022	Realizimi 2022
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (Agjenti DRT Fier)	0	119,867
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Fier)	3,512,000	7,804,926
3	Taksa e rregjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	15,489,000	17,596,293
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	300,000	0
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana Vlorë)	71,243,000	76,567,420
<b>Totali</b>		<b>90,544,000</b>	<b>102,088,506</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., dhe Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15, dhe UMF nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

**Ndikimi:** Mos njohja e situatë çon në mungesë të ardhurash për Bashkisë Patos.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Patos dhe Agjentëve tatimorë si dhe mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordimin periodik mujor me agjentët tatimorë, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Patos nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Për agjentët tatimorë që nuk realizojnë mbledhjen e saktë të ardhurave, Bashkia të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

**5. Titulli i gjetjes:** Nga Bashkia Patos nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhit tatimor) për të gjithë subjektet.

**Situata:** Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, detyrimet për taksat e tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

-Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve:

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të Bashkisë. Për këtë, nga

Drejtoria e të Ardhurave Vendore përdoren kontratat e popullatës për furnizimin me energji elektrike sipas OSHEE me përditësimet përkatëse.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrimit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Tarifa mirëmbajtje vaditje + kullim aplikohet vetëm në NJA Zharrëz. Parashikimi bëhet në bazë të sipërfaqes së tokës brenda zonës ku ofrohet ky shërbim.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos nuk ka lidhur kontratë me “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a, Patos për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

-Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese:

shërbimi për familjet ofrohet në zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në dy NJA nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nëpërmjet kryepaqve dhe pleqësive të fshatrave.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmjasasë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Bashkia Patos në të dy NJA dhe në Zyrën me një ndalesë ka sportel të Postës Shqiptare ku pranohen pagesat e detyrimeve vendore për familjarët dhe bizneset.

Me VKB nr. 5, datë 28.01.2021, Bashkia Patos ka miratuar pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të taksave dhe tarifave vendore. Ky vendim ka pasur si qëllim ndihmën për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për pagesën e menjëhershme të këtyre detyrimeve.

Në mënyrë analitike parqiten të dhënat për detyrimet e përmbledhura për abonentët familjarë për taksat dhe tarifatat vendore si më poshtë:

Lekë					
Nr.	Emërtimi	Deri më datën 31.12.2021	Viti 2022	Totali progresiv	Numri i familjeve debitore
1	Taksa e tokës bujqësore	40,491,275	12,532,291	53,023,566	2,618
2	Taksa e ndërtesës	16,247,474	6,674,100	22,921,574	5,357
3	Tarifa e pastrimit	25,922,986	8,141,530	34,064,516	5,357
4	Tarifa e shërbimit komunitar	0	3,195,792	3,195,792	5,357
5	Tarifa vaditje + kullim	2,337,424	219,987	2,557,411	657
<b>Totali</b>		<b>84,999,159</b>	<b>30,763,700</b>	<b>115,762,859</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

(Shënim: Taksa vaditje + kullim është aplikuar nga Bashkia Patos nga viti 2019 dhe në vazhdim për Njësinë Administrative Zharës si dhe tarifa e shërbimit komunitar është aplikuar nga viti 2022).

Detyrimet e analitike për abonentët familjarë për taksat dhe tarifatat vendore sipas NJA.

Lekë							
Detyrimet deri më 31.12.2021							
Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit	Tarifa e shërbimit komunitar	Tarifa vaditje + kullim	Totali
1	Patos	11,562,071	9,611,954	20,332,996	0	0	41,507,021
2	Zharëz	14,583,034	3,362,720	5,589,990	0	2,337,424	25,873,168
3	Ruzhdië	14,346,170	3,272,800	0	0	0	17,618,970
<b>Totali</b>		<b>40,491,275</b>	<b>16,247,474</b>	<b>25,992,986</b>	<b>0</b>	<b>2,337,424</b>	<b>84,999,159</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Lekë							
Detyrimet nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022							
Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit	Tarifa e shërbimit komunitar	Tarifa vaditje + kullim	Totali
1	Patos	4,004,226	3,292,500	5,108,530	2,125,792	0	14,531,048



2	Zharëz	4,718,387	1,915,500	2,669,000	914,000	219,987	10,436,874
3	Ruzhdië	3,809,678	1,466,100	364,000	156,000	0	5,795,778
<b>Totali</b>		<b>12,532,291</b>	<b>6,674,100</b>	<b>8,141,530</b>	<b>3,195,792</b>	<b>219,987</b>	<b>30,763,700</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë nga abonentët familjarë në vlerën **115,762,859 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët (e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar) Buxhetin e Bashkisë Patos konkretisht:**

a) Vlerën **53,023,566 lekë** për **2,618 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore. Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Kadastrës (sot ASHK) si rezulton findi i tokës, struktura dhe ndaja sipas kategorive paraqitet si më poshtë:

Nr.	Njësitë Administrative	Tokë bujqësore gjithsej Ha në 1/8/1991	Numri familjeve që kanë marrë AMTP	Sipërfaqja e tokës ndarë në fakt ligji nr. 7501	Kategoria e tokës e ndarë sipas Ligjit nr. 7501/në hektar							Totali i kategorive	Sipërfaqja e tokës së pandarë
					I	II	III	IV	V	VI	VII		
1	Patos	2,434	1,962	1,406	12	143	188	500	168	172	223	<b>1,406</b>	<b>30</b>
2	Zharëz	2,100	1,407	2,090	4	490	1,179	388	29	0	0	<b>2,090</b>	<b>0</b>
3	Ruzhdië	1,363	673	2,092	0	0	0	0	0	892	1,200	<b>2,092</b>	<b>352</b>
<b>Shuma</b>		<b>5,897</b>											<b>382</b>
<b>Çmimi sipas VKB</b>			<b>4,042</b>	<b>5,588</b>	<b>5,600</b>	<b>4,900</b>	<b>4,200</b>	<b>3,600</b>	<b>3,000</b>	<b>2,400</b>	<b>1,800</b>	<b>5,588</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër konstatohet se me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën" janë trajtuar gjithsej 4,042 familje dhe 5,588 hektarë. Të dhënat mbi detyrimet e taksës së tokës bujqësore paraqiten si më poshtë:

Detyrimet e Taksës së tokës bujqësore		
Periudha	Numri i familjeve	Vlera e detyrimeve
Deri më datën 31.12.2021	2548	40,491,275
Për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022	2,618	12,532,291
<b>Totali/Progresiv</b>		<b>53,023,566</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

b) Vlerën **22,921,574 lekë** për **5,357 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës;

c) Vlerën **34,064,516 lekë** për **5,357 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos nga mos arkëtimi i taksës së pastrimit;

ç) Vlerën **3,195,792 lekë** për **5,357 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos nga mos arkëtimi i taksës së shërbimit komunitar;

d) Vlerën **2,557,411 lekë** për **657 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos nga mos arkëtimi i taksës së vaditjes dhe kullimit.

➤ **Detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh:**

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me menaxhimin e borxhit nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën **8,933,270 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët (e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar) për Buxhetin e Bashkisë Patos**. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Njësitë Administrative	Deri më datë 31.12.2021		2022	Totali progresiv
1	Subjektet fizik biznesi i vogël Patos	2,562,869	880,813		3,443,682
2	Subjektet juridik biznesi i madh Patos	1,166,478	383,191		1,549,669
3	Subjektet fizik biznesi i vogël Zharëz	2,473,428	1,131,079		3,604,507
4	Subjektet juridik biznesi i madh Zharëz	0	0		0
5	Subjektet fizik biznesi i vogël Ruzhdië	257,594	77,818		335,412
6	Subjektet juridik biznesi i madh Ruzhdië	0	0		0
<b>Totali</b>		<b>6,460,369</b>	<b>2,472,901</b>		<b>8,933,270</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Sa më sipër arihet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të Bashkisë Patos për asnjë nga subjektet ku me gjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve nuk kanë vazhduar më tej ndjekjen e procedurave dhe rrugët ligjore për arkëtim e këtyre detyrimeve. Gjithashtu konstatohet se nga Bashkia Patos nuk janë aplikuar kamatëvonesa për mos likuidimin e taksave dhe tarifave vendore.

**Kriteri:** Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, neni 114, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35, dhe Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 3, pikat 9-10. Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

**Ndikimi:** Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimitatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 124,696,129 lekë**, e cila përbëhet nga:

-53,023,566 lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 2,618 familje;

-22,921,574 lekë detyrime për taksën e ndërtesës për 5,357 familje;

-34,064,516 lekë detyrime për taksën e pastrimit për 5,357 familje;

-3,195,792 lekë detyrime për tarifën e shërbimit komunitar për 5,357 familje;

-2,557,411 lekë detyrime për tarifën vaditje dhe kullimi për 657 familje;

-7,383,601 lekë detyrime nga biznesi i vogël;

-1,549,669 lekë detyrime nga biznesi i madh;

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Patos, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

➤ **Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve:**

**6. Titulli i gjetjes:** Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e tokës bujqësore.

**Situata:** Bashkia Patos ka të mbartura nga ish-komuna Ruzhdie 65 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2012. Detyrimi për pagesën e qirasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në NJA Ruzhdie. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëri gjatë vitit, pagesat e tokës me qira nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ku konstatohet se detyrimet deri më datën 31.12.2022, janë në vlerën **1,963,641 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët (e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar) për Buxhetin e Bashkisë Patos**. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Njësia Administrative	Numri i kontratave	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>	Deri më datë 31.12.2021	Nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022	Totali progresiv
Ruzhdie	65	772,113	1,548,170	415,471	1,963,641
<b>Totali</b>	<b>65</b>	<b>772,113</b>	<b>1,548,170</b>	<b>415,471</b>	<b>1,963,641</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

**Kriteri:** Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar, Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998, “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998, “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për t’u lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, UKM nr. 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos në vlerën 1,963,641 lekë.

**Shkaku:** Mos likuidimi i detyrimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratat e dhënies me qira të tokave bujqësore.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhura Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në total në **vlerën 1,963,641 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatë vonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në total janë nënshkruar 9 kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve të cilat administrohen nga Bashkia Patos.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, Bashkia Patos posedon titull pronësi vetëm për 2 objekte për të cilat janë nënshkruar 4 kontrata qiraje ndërsa për 4 objekte për të cilat janë nënshkruar 5 kontrata qiraje nuk posedon titull pronësie. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Emri i pronës adresa	Zona kadastrale	Numri pasurie	Pronësia
1	V. G.	Godina e I. Lagja “Naftëtari”	2890	7/72	Vërtetim hipotekor me nr. 306, datë 04.09.2009
2	K. Shpk	Qendra Shëndetësore-ish materniteti, Lagja “29 marsi”	2890	1/20	Janë në inventarin e Bashkisë Patos
3	Posta Shqiptare Sh.a Filiali Patos	Godina e I. Lagja “Naftëtari”	2890	7/72	Vërtetim hipotekor me nr. 306, datë 04.09.2009
4	Posta Shqiptare Sh.a Filiali Zharrëz	Njësia Administrative Zharrëz	3922	119/1	Janë në inventarin e Bashkisë Patos
5	Posta Shqiptare Sh.a Filiali Ruzhdie	Njësia Administrative Ruzhdie	3250	837/8	Janë në inventarin e Bashkisë Patos
6	S.M.	Ish-zyrat e NFP Lagja “1 Maj”	2890	6/15	Certifikatë pronësie e datës 28.06.2021
7	Sh. J.	Ish-Bashkia “Lagja e Re”	2890	8/4	Janë në inventarin e Bashkisë Patos
8	E. M.	Qendra Shëndetësore ish-materniteti Lagja “29 Mars”	2890	1/20	Janë në inventarin e Bashkisë Patos
9	A. P.	Ish-zyrat e N. Lagja “1 Maj”	2890	6/15	Certifikatë pronësie e datës 28.06.2021

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Për vendosjen e tarifave për dhënien me qira të objekteve dhe ndërtesave/objekteve nga Bashkia Patos janë aplikuar çmimet e parashikuara në Vendimin nr. 22, datë 31.01.2022, të Kryetares të Bashkisë znj. R. B., si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia Administrative
1	Tarifë për dhënien me qira ndërtesa/objekteve	100 lekë për m <sup>2</sup> në muaj

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi likuidimin e tarifave për dhënien me qira të ndërtesave konstatohet se për 9 kontrata janë likuiduar detyrimet sipas çdo kontrate si më poshtë:

Lekë

Nr.	Subjekti	Nipti	Afati	Viti i lidhjes së kontratës	Sipërfaqe në m <sup>2</sup>	Vlera në vit	Vlera e likuiduar
1	V. G.	L..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 427/1 prot., datë 23.02.2022	44.6	53,520	53,520
2	K. shpk	L..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 887 prot., datë 05.04.2022	14.6	17,520	17,520
3	Posta Shqiptare sh.a Filiali Patos	J..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 1499 prot., datë 15.06.2022	23	27,600	27,600
4	Posta Shqiptare sh.a Filiali Zharëz	J..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 1500 prot., datë 15.06.2022	22.2	26,640	26,640
5	Posta Shqiptare sh.a Filiali Ruzhdie	J..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 1501 prot., datë 15.06.2022	7	8,400	8,400
6	S. M.	K..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 1742 prot., datë 14.07.2022	24.75	29,700	29,700
7	Sh. J.	K..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 2121 prot., datë 01.09.2022	48.6	58,320	58,320
8	E. M.	L..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 2040/1 prot., datë 13.09.2022	45.6	54,720	54,720
9	A. P.	J..	01.01.2022-31.12.2022	Nr. 3214 prot., datë 30.12.2022	23.3	27,960	27,960
<b>Totali</b>					<b>253.65</b>	<b>304,380</b>	<b>304,380</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

**7. Titulli i gjetjes:** Mangësi në dokumentacionit në fazën para lidhjes së kontratave për marrjen e ndërtesave me qira.

**Situata:** Nga auditimi i ligjshmërisë së 9 kontratave të sipërpërmendura për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën para lidhjes së kontratave si më poshtë:

- Në 9 raste nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Në 9 raste nuk disponohet planbiznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- Në 9 raste nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Në 9 raste nuk disponohet certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;
- Në 9 raste nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Në 9 raste nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.
- Gjithashtu pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Patos nuk janë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e 9 kontratave të sipërpërmendur për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve.

**Kriteri:** VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3 dhe pika 7.

**Ndikimi:** Parregullsi në procesin e dhënies së ndërtesave me qira.

**Shkaku:** Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Sektori Juridik të marrë sa që para lidhjes së kontratës për dhënien e ndërtesave me qira, për subjektet që nuk paraqesin dokumentacionin sipas kërkesave të dispozitave ligjore përkatëse të bëjë skualifikimin e tyre.

**Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Patos janë paraqitur observacionet elektronikisht në adresën zyrtare të KLSH, nga znj. N. H. Përgjegjës i Sektorit Juridik ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:**

*“Të drejtën e lidhjes së kontratës së enfitozës për pasuritë shtetërore, me afat deri në 20 (njëzetë) vjet, e ka Ministria përgjegjëse për ekonominë ose **organi i Qeverisjes Vendore**, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit mbi pronën. Nëntë Kontratat e lidhura nga ana e Bashkisë Patos janë me sipërfaqe nën 200 m<sup>2</sup>, kryesisht janë objekte me sipërfaqe 20 deri në 50m<sup>2</sup> dhe referuar pikës 5 të VKM-së 54 datë 05.02.2014 përcaktohet se: “**Përjashtohen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m<sup>2</sup>, të cilat jepen me afat deri në 1 vit; Këto kontrata janë të vazhdueshme nga qiramarrës të njëjtë për gati 10(dhjetë) vjet të cilët janë korrekt mbi pagesën e tarifës së qiras, dhe çdo vit rinovojnë lidhjen e kontratës me Bashkinë Patos.**”*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga znj. N. H. sqarojmë se:

Parregullsia e konstatuar nga grupi i auditimit nuk ka të bëjë me kontratat e qirasë enfiteozë e cila pretendohet nga Ju në observacion por ka të bëjë me kontratat apo rilidhjen e kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve konkretisht: Ju shpreheni se procedura për plotësimin me dokumentacion sipas pikës 5, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i përket dhënies me qira e objekteve me sipërfaqe deri në 200 m<sup>2</sup> pra nuk përfshihet në pikën 7. Në lidhje me këtë situatë ju bëjmë me dije se në pikën 7, gërma “dh” të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, përcaktohet se: “Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim”. Në kushte të tilla ky dokumentacion vlen për çdo rast lidhjeje kontrate të re apo rilidhje kontrate, për arsye se në këtë dokumentacion përfshihen vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, dëshmitë a është subjekti qiramarrës në procese gjyqësore, plani i biznesit etj., pra ky dokumentacion duhet të jetë i azhurnuar për çdo vit.

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

### ➤ **Bisneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Bashkia Patos ka implementuar sistemin TAIS (*Tax Administration Information System*) në vitin 2014. Ky sistem i ndërtuar nga “I. B. S.” Shpk dhe financuar nga U..., është ndërtuar mbi “M. D. N..”.

“TAIS” është një sistem i kompjuterizuar i ndërtuar me objektiv rritjen e produktivitetin në proceset e administrimit të taksave vendore. Nëpërmjet tij të gjitha sistemet e informacionit për taksat vendore dhe bazat përkatëse të të dhënave, integrohen duke mundësuar instrumente që luftojnë evazionin fiskal, nxisin pagimin e taksave dhe plotësojnë kërkesat për informacion në nivel drejtues e operacional dhe për kontroll të brendshëm. Funkcionalitetet që ka sistemi “TAIS” përfshijnë të gjithë ciklin e administrimit të taksave vendore nga bashkia, si regjistri i të dhënave të taksapaguesve, llogaritja e taksave, faturimi dhe pagesat, identifikimi i debitorëve dhe raportime të ndryshme.

Sistemi është i pajisur me manuale të ndryshme për proceset e punës si:

- Sistemi i administrimit të taksave lokale.
- Manual për administratoret e sistemit.
- Pyetje të përgjithshme për sistemin dhe proceset funksionale.
- Metoda filtrimi dhe personalizime.

Referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi “TAIS” nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore për vitin 2022 gjendja e bizneseve të regjistruara apo ç’regjistruara paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Njësia Administrative Patos	1	Biznesi i Madh	2022	100	2	2	110
Njësia Administrative Patos	2	Biznesi i Vogël	2022	377	12	10	379
<b>Total 1+2</b>				<b>477</b>	<b>14</b>	<b>12</b>	<b>489</b>
NJA Zharëz + Ruzhdie	3	Biznesi i Madh	2022	22	0	0	22
NJA Zharëz + Ruzhdie	4	Biznesi i Vogël	2022	115	10	6	119
<b>Total 3+4</b>				<b>137</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>141</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

**8. Titulli i gjetjes:** Nga DAV nuk janë hartuar raporte për informimin e strukturave drejtuese të Bashkisë Patos mbi situatën debitore nga taksat dhe tarifave vendore.

**Situata:** Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk disponohet regjistër në formë shkresore për taksapaguesit familjarë dhe privatë për taksën mbi token bujqësore, por të dhënat mbahen në programin Excel nga kjo drejtori. Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk harton raporte periodike gjatë vitit dhe as raporte vjetore me shkrim për titullarin e institucionit dhe Këshillit Bashkiak, për ta informuar për situatën e arketimeve dhe debitorëve. Gjithashtu nga kjo drejtori nuk dorëzohet lista shkresore e debitorëve të vitit buxhetor në arkiv dhe as në Drejtorinë e Financës për efekt kontabilizimi.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19 dhe Regullorja e Brendshme e institucionit miratuar me Vendimin nr. 21, datë 30.01.2022, neni 36, pika 5.

**Ndikimi:** Mosinformimi i strukturave drejtuese të Bashkisë Patos mbi situatën debitore nga taksat dhe tarifave vendore.

**Shkaku:** Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** DAV të hartojë raporte periodike mujore dhe në fund të vitit raportin vjetor drejtuar titullarit të institucionit dhe Këshillit Bashkiak mbi realizimin e të ardhurave dhe gjendjen debitore. Lista e debitorve në fund të vitit buxhetor të protokollohet dhe një kopje e saj të dorëzohet në Drejtorinë e Financë për efekt kontabilizimi.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitor nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

**9. Titulli i gjetjes:** Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Situata:** Duke u bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas listave të sjella nga Drejtoria Rajonale e Aluiznit Fier (sot ASHK) me shkresë të destinuar për regjistrim në ASHK Fier, deri më datën 31.12.2021, sipas listave për leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **1,524 persona në vlerën 33,340,042 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për Buxhetin e Bashkisë Patos**. Të dhënat paraqiten si më poshtë:

Lekë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë				
Viti	Persona	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2021	1,524	49,214,453	15,874,411	33,340,042
<b>Totali</b>	<b>1,524</b>	<b>49,214,453</b>	<b>15,874,411</b>	<b>33,340,042</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Për vitin 2022, nga DAV dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban nuk ka asnjë korrespondencë në formë shkresore me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Fier në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Referuar akt rakordimeve me Degën e Thesarit Fier të ardhurat e realizuara për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme për periudhën janar-dhjetor 2022 janë në vlerën 0 lekë.

Gjithashtu nuk disponohet listaemërore sipas banesave të legalizuara në territorin e bashkisë për vitin 2022 për kalimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Grupi i auditimit më datë 28.02.2023, bërë kërkesë për informacion drejtuar DAV dhe Drejtorisë së Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban për arkëtimet dhe detyrimet ndaj Bashkisë për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Në lidhje me këtë situatë Bashkia Patos me shkresën nr. 636 prot., datë 28.02.2023, është drejtuar ASHK Fier në lidhje me këtë situatë. Deri më datën 24.03.2023, nga ASHK Fier nuk ka asnjë përgjigje zyrtare.

**Kriteri:** Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos në vlerën 33,340,042 lekë.

**Shkaku:** Mos kryerja e aktrakordimeve midis DAV dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban dhe ASHK Rajonale Fier për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në **vlerën 33,340,042 lekë ndaj 1,524 persona**.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të vazhdojë korrespondencën zyrtare me ASHK Fier në lidhje me situatën debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2022.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

**10. Titulli i gjetjes:** Mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i licencave/autorizimeve të subjekteve që tregtojnë karburante.

**Situata:** Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si përshembull në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Nga të dhënat e paraqitura nga DAV si dhe nga verifikimi në faqen e internetit të QKB u konstatua se në Bashkisë Patos figurojnë rreth 13 subjekte me aktivitet në territorin e Bashkisë Patos dhe në NjA Zharëz të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bisneseve në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre u konstatua se 13 subjekte janë pajisur me autorizim të cilat janë përpara objekt auditimi konkretisht: 12 subjekt për tregtim karburanti dhe 1 subjekt tregtim me shumicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

Në total nga 13 subjekte të cilat kanë ushtuar aktivitetin deri më datë 31.12.2022, pesë prej tyre kanë ende pa likuiduar detyrimin në vlerën **5,350,000 lekë e cila konsiderohet e detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për buxhetin e Bashkisë Patos.**

Nr.	Subjekti	Nipti	Adresa	Aktivitet	Fillimi	Përfundimi	Lekë		
							Detyrime për tu paguar	Detyrimi i paguar	Diferenca
1	A. P.	K..	Patos	Karburant	05.09.2018	04.09.2023	1,000,000	400,000	600,000
2	H. Shpk	K..	Patos	Karburant	17.07.2020	16.07.2025	1,000,000	150,000	850,000
3	L. Shpk	K..	Patos	Karburant	13.01.2020	12.01.2025	1,000,000	1,000,000	0
4	E. Shpk	L..	Patos	Karburant	05.02.2015	04.02.2020	1,000,000	0	1,000,000
5	P. S. Shpk	K..	Patos	Karburant	30.09.2019	29.09.2024	1,000,000	1,000,000	0
6	B. Sha P.	K..	Patos	Tregti meshumicë	29.07.2013	Pa afat	1,000,000	1,000,000	0
7	O. Shpk P.	J..	Patos	Karburant	16.08.2019	15.08.2024	1,000,000	1,000,000	0
8	E. Shpk	L..	Zharës	Karburant	-	-	1,000,000	0	1,000,000
9	A. O. Shpk	L..	Zharës	Karburant	07.11.2018	06.11.2023	1,000,000	1,000,000	0
10	G. O. Shpk	L..	Zharës	Karburant	22.09.2015	21.09.2020	2,000,000	100,000	1,900,000
11	S. Shpk	J..	Patos	Karburant	16.08.2019	15.08.2024	1,000,000	1,000,000	0
12	O. Shpk Zh.	J..	Zharëz	Karburant	02.10.2020	01.10.2025	1,000,000	1,000,000	0
<b>Totali</b>							<b>13,000,000</b>	<b>7,650,000</b>	<b>5,350,000</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos në vlerën 5,350,000lekë.

**Shkaku:** Mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë licencën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga Bashkia Patos, Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve

për automjetet, vajrave lubrifikanëte dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifën e plotë për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **5,350,000 lekë**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

➤ **Të ardhurat nga asetet e fondit pyjor kullor:**

**11. Titulli i gjetjes:** Detyrime nga kontrata për dhënie me qira të burimeve minerare.

**Situata:** Grupi i auditimi bëri kërkesë për kontratat e qirave të fondit pyjor/kullor lidhur me subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare në Bashkinë Patos.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN konkretisht Regjistrin e Lejeve Minerare, DRT Fier, QKB konstatohet se për vitin 2022, në territorin e Bashkisë Patos ushtrojnë aktivitet subjektet si më poshtë:

1. OE "C." Shpk, i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1356, datë 04.06.2009, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Ruzhdie, Fier, për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km<sup>2</sup>.

2. OE "A." Shpk, i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1736, datë 23.12.2014, për shfrytëzimin e vendburimit Zharrëz, për llojin e mineralit kongomeratë me sipërfaqe 0.428 km<sup>2</sup>.

1.1. OE "C." Shpk, për vitin 2022 ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifën vendore si më poshtë:

- Tarifë pastrimi 100,000 lekë
- Tarifë gjelbërimi 5,000 lekë
- Tarifë ndriçimi 5,000 lekë

**Totali 110,000 lekë**

Për sa i përket detyrimeve të kontratës së qirasë konstatohet se:

Në zbatim të kontratës së qirasë me nr. 3133/1 prot., datë 28.12.2018, të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Patos të përfaqësuar nga znj. R. B.j dhe OE "C." Shpk, përfaqësuar nga Administratori z. A. Q., në nenin 10 dhe nenin 11, përcaktohet se:

10. "Qiramarrësi", duhet të paguajë të gjitha detyrimet e prapambetura për periudhën 04.06.2019-04.06.2017, gjithsej 1,732,320 lekë sipas sipërfaqes së shfrytëzuar, parashikuar në programin e punës të miratuar nga AKBN, e cila është 3.208 ha x 540,000 lekë = 1,732,320 lekë.

11. "Qiramarrësi", duhet të paguajë të gjitha detyrimet e prapambetura për periudhën 04.06.2017-04.06.2018, gjithsej 414,900 lekë sipas sipërfaqes së shfrytëzuar, parashikuar në programin e punës të miratuar nga AKBN, e cila është 0.7685 ha x 540,000 lekë/ha = 414,990 lekë.

Sipas kontratës së qirasë me nr. 3113/1 prot., datë 28.12.2018, OE "C." Shpk, për periudhën nga data 04.06.2019, deri më 04.06.2019, ka detyrime ndaj Bashkisë në vlerën 2,527,718 lekë.

Për shlyerjen e këtyre detyrimeve ndërmjet palëve është nënshkruar akt marrëveshja me nr. 3113/2 prot., datë 18.06.2019, ku OE "C." Shpk, ka kryer pagesën e kështit të pare në vlerën 200,000 lekë më datë 21.06.2019.

Detyrimi total i OE "C." Shpk, ndaj Bashkisë Patos sipas kontratës së qirasë me nr. 3113/1 prot., datë 28.12.2018, është **në vlerën 2,327,718 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.

Në kushtet kur nga OE "C." Shpk, nuk janë kryer më pagesa për likuidimin e detyrimeve sipas akt marrëveshjes me nr. 3113/2 prot., datë 18.06.2019, Bashkia Patos me shkresën nr. 2060 prot., datë 11.08.2021, ka pezulluar kontratën deri në regjistrimin e pronës në emër të bashkisë.

1.2. OE "A." Shpk, për vitin 2022 ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifën vendore si më poshtë:

- Taksë ndërtese 50,820 lekë
- Taksë trualli 47,430 lekë
- Tarifë gjelbërimi 4,000 lekë
- Tarifë ndriçimi 4,000lekë
- Tarifë pastrimi 70,000lekë
- Taksë tabele 120 lekë

**Totali 176,370 lekë**



OE "A." Shpk, nuk ka detyrime kontraktuale për arsye se nuk ka kontratë qiraje të nënshkruar me Bashkinë Patos por ka kontratë qiraje noteriale me nr. 3690 rep., nr. 1172 kol., datë 16.10.2015, dhe kontratën me nr. 25 prot., datë 03.01.2017, me OE "A." Shpk.

Gjithashtu në Bashkinë Patos dy subjektet që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi konkretisht për rërë bituminoze dhe konglomeratë nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së.

**Kriteri:** Ligji nr. 10 304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", neni 15, pika 5, neni 24, pika 10, Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullor", pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor" i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Patos në vlerën 2,327,718 lekë.

**Shkak:** Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **2,327,718 lekë** të papaguara ndaj subjektit "C." Shpk sipas kontratës së qirasë me nr. 3133/1 prot., datë 28.12.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Ruzhdie, Fier për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km<sup>2</sup>.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor. Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa të menjëhershme ku t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Znj. R. B., me detyrë Kryetar i Bashkisë Patos.
2. Z. A. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.
3. Znj. S. M., me detyrë Specialist i taksave dhe tarifave për të ardhurat pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.
4. Z. E. Q., inspektor për mbledhjen e taksave dhe tarifave pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.
5. Z. E. A., inspektor për mbledhjen e taksave dhe tarifave pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.
6. Znj. N. H., me detyrë Përgjegjës i Sketorit të Juridik.
7. Z. O. G. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit. Pyjor.
8. Z. L. Ç., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban.

### **2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022.**

#### **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme", janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (CASH FLOW).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

### **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat financiare vjetore të **Aparatit të Bashkisë Patos për vitin 2022** janë të nënshkruara nga z. Sh. B., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. M. Sh., me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Fier me shkresën nr. 616 prot., datë 27.02.2023, të Kryetares të Bashkisë znj. R. B. brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar me shkresën me nr. 177 prot., datë 28.02.2023.

### **Rakordimi i pasqyrave financiare me Thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

### **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:**

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
  - Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
  - Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
  - Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
  - Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

### **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël janë kryer me regjistra ose në programin "E."
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat qe kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

### **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Aparatit të Bashkisë Patos për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2022, deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Fier për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në cash në vitin 2022.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2022, të pozicionit financiar të “Aparatit Bashkia Patos”, Formatit nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		Lekë
<b>Aktivët Neto janë të barabarta me Aktivët - Pasivët = Aktivët Neto</b>		<b>1,564,557,766</b>
Aktivët		1,639,169,643
Pasivët		74,611,877
Aktivët Neto		1,564,557,766

		Lekë
<b>Aktivët Afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën</b>		
Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”		281,916,203
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		26,242,094
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		38,888,943

## **A. AKTIVET**

### **I. Aktivët Afat Shkurtra**

#### **1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:**

					Lekë
Logaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021	
531	Mjete monetare ne arkë	0	0		0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0		0
520	Disponibilitete në thesar	281,916,203	268,943,234		12,972,969
50	Letra me vlerë	0	0		0

532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>281,916,203</b>	<b>268,943,234</b>	<b>12,972,969</b>

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 281,916,203 lekë përbëhet nga: gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në shumën 246,193,269 lekë (fondi i trashëguar 246,193,569 lekë nga transferata e pakushtëzuar 67,427,901 lekë, transferata specifike në vlerën 28,882,736 lekë dhe të ardhurat e veta, në vlerën 149,882,932 lekë, 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerë 35,722,634 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën 35,722,934 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

## 2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë				
Logaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
31	Materiale	2,592,735	1,770,607	822,128
32	Inventar i imët	23,649,359	22,950,536	398,823
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje të pambritura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>26,242,094</b>	<b>24,721,143</b>	<b>1,520,951</b>

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Aparatit të Bashkisë Patos në datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 26,242,094 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,592,735 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 23,649,359 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,520,951 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në shumën -1,520,951 lekë.

-**Llogaria 312 “Materiale”**, ka vlerën 2,592,735 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë		Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2022			1,770,607
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022			23,444,687
Dalje ng amagazina gjatë vitit 2022			22,622,559
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>			<b>2,592,735</b>

-**Llogaria 327 “Objekte inventari”**, ka vlerën 23,649,359 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë		Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2022			22,950,536
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022			7,893,882
Dalje ng amagazina gjatë vitit 2022			7,195,059
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>			<b>23,649,359</b>

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

## 3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë				
Logaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme			

411	Klientë e llogari tengjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatimbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësinatore që mbulonshiteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitjaletra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë tendryshëm	14,234,425	14,298,391	- 63,966
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	24,654,518	39,379,075	- 14,724,557
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>38,888,943</b>	<b>53,677,466</b>	<b>- 14,788,523</b>
	Të tjera aktiveafatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferencakontvertimiaktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**12. Titulli i gjetjes:** Mos kontabilizimi në bilanc i vlerës 151,141,148 lekë e cila është detyrim i debitorëve për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Patos.

**Situata:** Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet për vitin 2021 në vlerën 14,298,391 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2022 paraqitet në vlerën 14,234,425 lekë me një zbritje në vlerë 63,966 lekë. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten të dhënat për Bashkinë Patos dhe NJA si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Llogaria kontabël	Shuma
1	Bashkia Patos	468	13,179,302
2	Njësia Administrative Ruzhdie	468	199,533
3	Njësia Administrative Zharrëz	468	855,590
	<b>Totali</b>		<b>14,234,425</b>

Lekë

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		
Çelje e vitit 2022		14,298,391
Shtesa (K)		203,249,555
Pakësime (D)		203,313,521
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>		<b>14,234,425</b>

Vlera e mësipërme e pasqyruar në bilanc prej 14,234,425 lekë përbëhet nga:

Lekë

Nr.	Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		
1	Detyrime të biznesit të madh për taksa dhe tarifa vendore		8,843,221
2	Detyrime të biznesit të vogël për taksa dhe tarifa vendore		1,545,676
3	Detyrime të taksapaguesve familjar për taksën e tokës bujqësore		0
4	Debitorë të ndryshëm		10,388,897
	<b>Totali</b>		<b>14,234,425</b>

Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në datën 31.12.2022, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 14,234,425 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 151,141,148 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 136,906,723 lekë.

Nga të dhënat e Drejtoria e të Ardhurave Vendore konstatohet se, në datën 31.12.2022, gjendja e debitorëve është si më poshtë:

Lekë

Nr.	Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		
1	Detyrime të biznesit të madh për taksa dhe tarifa vendore		1,568,509
2	Detyrime të biznesit të vogël për taksa dhe tarifa vendore		15,328,091
3	Detyrime të taksapaguesve familjar për taksën e tokës bujqësore		40,491,275

4	Debitorë të ndryshëm	79,518,848
<b>Totali</b>		<b>136,906,723</b>

Në mënyrë analitike paraqiten debitorët me vlera më të larta si më poshtë:

		Lekë
Nr.	Lista e debitorëve me vlera më të larta	
1	A. D. shpk	80,120
2	S. O. & D.	351,360
3	A. shpk	289,370
4	L. shpk	116,081
5	E. shpk	40,120
6	E. shpk	332,412
7	F. T. shpk	77,255
8	Q. G.	700,000
9	S. H.	950,000
10	E.B.	1,000,000
11	E. B.	1,000,000
12	A. G.	1,900,000

Nga Drejtoria Financës llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është mbajtur në mënyrë analitike, e cila në fund të vitit 2022 paraqitet me një zbritje në vlerën 63,966 lekë. Nga verifikimi i pasqyrave financiare konstatohet se, totali i llogarisë analitike në fund të vitit 2022, kuadron me llogarinë sintetike në Aktivitet të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe me lëvizjet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyruara në Librin e Madh (Centralizatorin 2022).

Në total nga shuma prej 14,234,425 lekë të pasqyruar në bilanc në datën 31.12.2022, shuma prej 10,388,897 lekë ose 72.9% të debitorëve e zënë debitorët e taksave.

**Kriteri:** Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5.

**Ndikimi:** Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.

**Shkaku:** Mos zbatim nga nëpunësi zbatues i kërkesave ligjore të përshkruara më lart, në mbajtjen e sistemit të kontabilitetit. Mos vendosje e rregullave të shkruara nga menaxhimi i lartë, për përcaktimin e detyrimit të kalimit në mënyrë zyrtare të listës së debitorëve nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore në financë dhe kontabilizimin e tyre.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të sistemojë në kontabilitet llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të kategorisë privat dhe familjar.

**-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 24,654,518 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 14,207,167 lekë shpenzimet korrente dhe 10,447,351 lekë shpenzimeve kapitale, si dhe përbëhet nga:

		Lekë
Emërtimi i llogarive	Vlera	
<b>Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”</b>		<b>10,461,281</b>
<b>Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”</b>		<b>605,711</b>
Paga personellillogaria 42		9,650,411
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431		611,672
Sigurime shoqërorellogaria 435		2,925,633
Sigurime shëndetësore 436		399,810
<b>Totali</b>		<b>24,654,518</b>

		Lekë
<b>Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)</b>		
Çelje e vitit 2022		39,379,075
Shtesa (K)		24,654,518

Pakësime (D)	39,379,075
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>24,654,518</b>

Nga auditimi rezultoi se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, është paraqitur në vlerën 0 lekë, kjo në zbatim të Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni 3.1, për të cilën është kredituar llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, për vlerën 605,711 lekë në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën 605,711 lekë.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

## II. AKTIVET AFAT GJATA

### 1. Aktivet Afatgjata Jomateriale

**-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”**më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 305,478 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 454,545 lekë, dhe amortizim vjetor në vlerën 62,876 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 697,156 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Përshkrimi	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Çelje datë 01.01.2022	836,000
	2	Shtesë	+ 454,545
	3	Pakësime	0
	4	<b>Studime-Projektme (kosto historike) analiza</b>	<b>1,290,545</b>
		Studim Projektim KUZ G. L.	300,000
		Projekt KUZ VERBAS	130,000
		Projekt KUZ Frashër-Sheqishtë	406,000
		Studim Projektim i objektit “Rehabilitimstacionit të pompimit të Belinës dhe pjesërisht i rrjetitujtës të saj në vitin 2022”	454,545
		<b>Totali</b>	<b>1,290,545</b>
	5	Amortizim i akumuluar	530,522
6	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2022-31.12.2022	62,876	
7	<b>Gjendja më datë 31.12.2022</b>	<b>697,156</b>	

Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” konstatohet se, vlera prej 836,000 lekë i përket periudhës përpara vitit 2022 por është regjistruar në këtë llogari për arsye se këto projekte nuk janë zbatuar ndërsa projekti në vlerën 454,545 lekë në proces zbatimi të punimeve.

### 2. Aktivet Afatgjata Materiale

**13. Titulli i gjetjes:** Mos dokumentimi i plotë në bilanc i aktiveve të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, dhe aktiveve të llogarisë 211 “Pyje, kullota plantacione”, si dhe përlllogaritje e gabuar të amortizimit të tyre.

**Situata: 1.**Në total aktivet të cilat i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, për koston historike në vlerën 4,220,846 lekë Bashkia Patos prej 1039 prona të cilat janë transferuar sipas VKM respektive vetëm për 29 prona posedon titull pronësie si dhe vetëm 91 prej tyre janë të regjistruara në kontabilitet. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Me VKM nr. 443, datë 15.06.2016, NJA Patos i janë kthyer gjithësej 280 prona nga të cilat:

-106 prona objekte (Shkolla, kopështe, vendstrehime, buste, objekte të tjera) nga të cilat 36 prej tyre janë të regjistruar në kontabilitet.

-59 prona rrugë nga të cilat 15 prej tyre janë të regjistruar në kontabilitet.

-115 prona të tjera (toka pa frut, hapsira publike) nuk janë të regjistruara në kontabilitet.

Me VKM nr. 432, datë 15.05.2013, NJA Zharrëz i janë transferuar 95 prona nga të cilat:

-40 objekte (Shkolla, kopështe, vendstrehime, lapidar) nga të cilat 20 prej tyre janë të regjistruar në kontabilitet.

-10 prona rrugë të cilat janë të regjistruara në kontabilitet.

-45 janë prona të tjera (tokapafut, hapsira publike) nuk janë të regjistruara në kontabilitet.

Me VKM nr. 559 datë 27.07.2016, NJA Ruzhdie i janë transferuar 664 prona nga të cilat:

-15 objekte (Shkolla, qendër shëdetësore, lapidar) nga të cilat 10 prej tyre janë të regjistruar në kontabilitet.

-649 prona të tjera (toka pa frut, hapsira publike, rrugë, kanale) nuk janë të regjistruara në kontabilitet.

Gjithsej në NJA Ruzhdie janë regjistruar: 1 objekt me certifikatë pronësie si dhe 11 prona me vërtetim hipotekor.

Nr.	Bashkia/Njësia	Nurmi i pronave në inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara deri Dhjetor 2019	Nr. Praktikave të Certifikuara 2019-2021	Prona të pa certifikuara
1	Zharrës	95	0	2	93
2	Patos	280	0	15	265
3	Ruzhdie	664	0	12	632
<b>Totali</b>		<b>1,039</b>	<b>0</b>	<b>29</b>	<b>990</b>

(Shënim: Në njësin administrative Ruzhdiendodhen edhe 11 prona Pyje me Vërtetim Hipotekor).

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c”.

**2. Llogaria 211“Pyje, platicione”** paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2022, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Patos me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferim në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave, sipas inventarit, aktualisht në administrim të MM e të ish-Komunave/Bashkive” i ndryshuar, sipas listës në faqen 555 të VKM, janë transferuar 682.75 ha pyje. Të regjistruara në ASHK janë 4 pasuri me nr. 2/8, 2/1, 2/5, 2/3 me sipërfaqe 4 ha në ekonominë pyjore “Ana e Lumit Seman 2”, ndësa pjesa tjetër është në proces certifikimi, mbasi ka përfunduar faza e parë dhe e dytë e regjistrimit e inicuar nga MTM dhe kompanisë së kontraktuar “C. P. & D.”.

**3. Nga auditimi i llogarisë 210 “Troje, toka, terrene”** konstatohet se është përlllogaritur normëa mortizimi në vlerën 1,074,287 lekë si më poshtë:

Referenca	Nr.	Përshkrimi	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	4,220,846
	2	Amortizim i akumuluar	908,679
	3	<b>Çelje datë 01.01.2022</b>	<b>3,312,167</b>
	4	Shtesë apo pakësime	0
	5	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2022-31.12.2022	<b>165,608</b>
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2022</b>	<b>3,146,559</b>

Duke u bazuar në SKK nr. 5, “Afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, i përmirësuar, pika 30, citohet se, “Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përrjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për grososje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme”. Në kushte të tilla për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

**Kriteri:** SKK nr. 5, “Afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, i përmirësuar, pika 30, VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c”.

**Ndikimi:** Pasqyrat financiare paraqesin informacion të gabuar për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, kullota plantacione”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së institucionit.



**Shkaku:** Mos marrja e masave për inventarizimin e pasurisë që paraqitet në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, mos pasqyrimin e vlerave të tyre në aktivin e pasqyrave financiare. Mos marrja e masave për regjistrimin e pasurive të kësaj llogarie në ASHK.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, kullota plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot NJA të Bashkisë. Bazuar në legjisllacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,074,287 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” si dhe për këto llogari mos të aplikohetnormëamortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

**-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”** më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 547,911,628 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 46,235,904 lekë, pakësime në vlerën 1,816,296 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 26,616,562 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 562,714,674 lekë.

			Lekë
Referencë	Nr.	Përshkrimi	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	715,077,652
	2	Amortizim i akumuluar	167,166,024
	3	<b>Çelje datë 01.01.2022</b>	<b>547,911,628</b>
	4	Shtesë	+ 46,235,904
		Pakësime, transferimeNdërmarrjeVartëse	- 1,816,296
	5	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2022-31.12.2022	- 29,616,562
6	<b>Gjendja më datë 31.12.2022</b>	<b>562,714,674</b>	

(Analiza e detajuar e kësaj llogarie është paraqitur në Projektraportin e Auditimit)

**-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 80,290,890 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 66,719,459 lekë, pakësim në vlerën 25,937,391 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 12,276,939 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 108,796,019 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

			Lekë	
Referenca	Nr.	Përshkrimi	Vlera	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	93,442,926	
	2	Amortizim i akumuluar	13,152,036	
	3	<b>Çelje datë 01.01.2022</b>	<b>80,290,890</b>	
	<b>Shtesë</b>			
	4	Blerje bazë materiale për zgjerim KUZ në Lagjen 29 Marsi	+719,124	
	5	Blerje bazë materiale për ndriçim rrugor	+ 14,407,644	
	6	Bordura metalike mbrojtëse për këmbësorët në Rreres, Ura e çobaneve dhe kthesa e Verbasit	+ 731,399	
	7	Rikonstruksion dhe shtrim me asfalto beton Rruga Xhepaj Siquece	+ 10,079,224	
	8	Rehabilitim i rrjetit ujitës Belinë	+ 9,566,835	
	9	Shtesa tjera	+ 31,215,233	
	10	Pakësime, transferimendërmarrjevartëse	- 25,937,391	
	11	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2022-31.12.2022	- 12,276,939	
12	<b>Gjendja më datë 31.12.2022</b>	<b>108,796,019</b>		

**-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”**, më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 7,415,385 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 1,355,260 lekë, pakësim në vlerën 118,900 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 391,045 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,379,045 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

			Lekë
Referenca	Nr.	Përshkrimi	Vlera
Ditari i	1	Kosto historike	10,94,777
	2	Amortizim i akumuluar	3,534,392
	3	<b>Çelje datë 01.01.2022</b>	<b>7,415,385</b>

veprimeve	4	Shtesë vegla pune	+ 1,355,260
		Pakësime, transferime Ndërmarrje Vartëse	- 118,900
	5	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2022-31.12.2022	- 391,045
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2022</b>	<b>8,379,600</b>

(Analiza e detajuar e kësaj llogarie është paraqitur në Projektraportin e Auditimit)

**-Llogaria 215 “Mjete transporti”**, më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 3,787,446 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 5,496,000 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 757,489 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,525,957 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë				
Nr.	Emërtimi	Përgjegjësi material	Targa	Vlera Kontabël
1	B.	A. H.	A.....	1,450,000
2	B.	M. Xh.	A.....	1,560,000
3	F.	E. P.	A.....	960,000
4	Blerje mjete tip I. për MNZ	A. H.	E pa targar	5,280,000
5	Autoveturë Njësia Administrative Zharrëz	G. M.	A.....	5,186,400
6	Autobus B.	E. P.	F.....	1,917,600
7	Miniekavator për Ujitje dhe Kullimin	R. P.	E pa targar	5,496,000
<b>Totali kosto historike</b>				<b>16,354,000</b>
Shtesa				5,496,000
Amortizimi i akumuluar				- 12,566,554
Çelje më datë 01.01.2022				16,354,000
Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2022-31.12.2022.				- 757,489
<b>Gjendja më datë 31.12.2022</b>				<b>8,525,957</b>

(Kosto historike në vlerën 16,354,000 – amortizimin e akumuluar në vlerën 12,566,554 lekë = 3,787,446 lekë gjendja më datë 01.01.2022).

**14. Titulli i gjetjes:** Kontabilizim jo i saktë i llogarisë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare.

**Situata:** Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 8,525,957 lekë. Në këtë vlerë është përfshirë edhe automjeti tip B. me targë A.... me vlerë kosto historike 1,450,000 lekë i cili nuk është në gjendje pune dhe është nxjerrë jashtë përdorimit sipas Vendimit nr. 27, datë 13.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 1,450,000 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti” duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohët në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

**Kriteri:** Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1.

**Ndikimi:** Paraqitje jo e saktë e llogarisë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare.

**Shkaku:** Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,450,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 1 automjeti të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

**-Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 40,529,442 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 1,380,170 lekë, pakësim në vlerën 6,850,180 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 8,002,797 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 33,700,919 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Përshkrimi	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	82,918,218
	2	Amortizim i akumuluar	42,388,776
	3	<b>Çelje datë 01.01.2022</b>	<b>40,529,442</b>
	4	Shtesë	+ 1,380,170
		Pakësime, transferime Ndërmarrje Vartëse	- 6,850,180
	5	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2022-31.12.2022	8,082,797
6	<b>Gjendja më datë 31.12.2022</b>	<b>33,700,919</b>	

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 551,631,519 lekë, ku është kontabilizuar vlera për 6 kontrata punimesh të cilat janë në proces zbatimi punimesh. Nga testimi i kontratave konstatohet se nuk ka kontrata punimesh të cilat janë ende të pa likuiduara nga viti 2022.

Lekë

Referenca	Nr.	Përshkrimi	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Rikonstruksioni i magjistralit kryesor të Ujësjellësit, rrjeti shpërndarës dhe rrjetit të brendshëm Qytetit Patos (Loti I + Loti II)	444,027,052
	2	Rikonstruksion dhe shtrim me asfalto beton rruga Fshati i Ri Sheqishtë	14,341,601
	3	Sistemimi i hapësirave në lagjen 29 Marsi	42,143,854
	4	Sistemimi i hapësirave për parkim	10,445,340
	5	Përmirësimi i banesave ekzistuese për familje në nevojë	8,239,522
	6	Rikonstruksion Shkolla M. Shehu	32,434,150
<b>Totali</b>			<b>551,631,519</b>

## B. PASIVET (DETYRIMET)

### I. Pasivet Afatshkurtra

#### 1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Patos më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	10,461,281	25,344,587	(14,883,306)
42	Detyrime ndaj personelit	9,650,411	8,998,929	651,482
16,17,18	Hua afatshkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	611,672	576,789	34,883
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	2,925,633	2,697,661	227,972
436	Sigurime shëndetësore	399,810	368,319	31,491
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	35,722,934	30,392,300	5,330,634
467	Kreditorë të ndryshëm	605,711	1,392,790	(787,079)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	14,234,425	14,298,391	(63,966)
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
<b>Gjendje në fund të periudhës</b>		<b>74,611,877</b>	<b>84,069,766</b>	<b>(9,457,889)</b>

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në datën 31.12.2022, është në vlerën 10,461,281 lekë paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Patos. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si më poshtë:

<b>Llekë</b>	
<b>Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"</b>	
Çelje e vitit 2022	25,344,587
Shtesa (K)	279,189,086
Pakësime (D)	294,072,392
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>10,461,281</b>

Gjendja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në shumën 10,461,281 kë përbëhet nga:

<b>Llekë</b>				
<b>Faturat e pa likuiduara deri më datë 31.12.2022</b>				
Nr.	Datë	Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	Subjektet	Detyrimi
1	06.01.2023	Karburant	O. SHPK	13,930
2	10.01.2023	Mbikëqyrësi "Sistemim i bllokut të zjarrëfiksës në Lagjen 29 marsi"	S.	723,282
3	27.12.2022	Rikonstruksioni i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës Late Bregu tek pallatet dy katësh	C. R.	9,724,069
<b>Totali</b>				<b>10,461,281</b>

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 25,344,587 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 279,189,086 lekë dhe pakësim në vlerën 294,072,392 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,461,281 lekë. Gjatë kësaj periudhe është likuiduar vlera minimale 13,930 lekë. Shtesa e detyrime të Bashkisë Patos për llogarinë 401-408 gjatë vitit 2022 është në vlerën 10,447,351 lekë e cila përbëhet nga 2 shpenzime konkretisht një kontratë për mbikëqyrje të punimeve dhe një kontratë punimesh. Angazhime të marra mbi bazën e planifikimit të pritshëm për realizimin e të ardhurave të veta të bashkisë por këto angazhime janë marrë pa u siguruar të ardhurat reale nga llogaria e njësisë vendore në thesar.

**-Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 9,650,411 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

<b>Llekë</b>	
<b>Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"</b>	
Çelje e vitit 2022	8,998,929
Shtesa (K)	112,429,429
Pakësime (D)	111,777,947
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>9,650,411</b>

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

<b>Llekë</b>		
<b>Urdhër Shpenzimi</b>		<b>Vlera</b>
Nr.	Datë	
1	12.01.2023	9,405,876
2	12.01.2023	244,535
<b>Totali</b>		<b>9,650,411</b>

**-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"**, paraqitet në vlerën 611,672 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

<b>Llekë</b>	
<b>Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"</b>	
Çelje e vitit 2022	576,789
Shtesa (K)	6,839,515
Pakësime (D)	6,804,632
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>611,672</b>

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2022 konstatohet se:

<b>Llekë</b>		
<b>Urdhër Shpenzimi</b>		<b>Vlera</b>
Nr.	Datë	
4	16.01.2023	<b>611,672</b>
<b>Totali</b>		<b>611,672</b>

**-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”,** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2022 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 2,925,633 lekë dhe 399,810 lekë.

Lekë

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”	
Çelje e vitit 2022	2,697,661
Shtesa (K)	33,791,627
Pakësime (D)	33,563,655
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>2,925,633</b>
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”	
Çelje e vitit 2022	368,319
Shtesa (K)	4,610,986
Pakësime (D)	4,579,495
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>399,810</b>

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

Lekë

Urdhër Shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
4	16.01.2023	2,925,633
<b>Totali</b>		<b>2,925,633</b>

Lekë

Urdhër Shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
4	16.01.2023	399,810
<b>Totali</b>		<b>399,810</b>

**-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Patos në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 35,722,934 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Fier.

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2022	30,392,300
Shtesa (K)	13,225,145
Pakësime (D)	7,894,511
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>35,722,934</b>

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Lekë

Garanci punimesh			Objekti i shpenzimit	Debi	Kredi
Nr.	Kodi	OE			
1	C.....	Sh.	Ndërtim lulishte pranë Stadiumit A. N.		132,038
2	C.....	Sh.	Ndërtim Varreza Publike		184,119
3	C.....	Sh.	Ndërtim rrugelagjia 1 Maji		86,525
4	C.....	Sh.	Ndriçim i rrugëve Verbas-Belinë në NJA Zharrëz		176,417
5	C.....	Sh.	Rikonstruksion Rrugës Qendër Zharrëz		103,460
6	C.....	Sh.	Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltbeton Rruga Xhepaj, Siceq		492,089
7	C.....	Sh.	Rikonstruksion Shkolla Muhamet Shehu pjesa nga m.arsimit		1,621,708
8	C.....	S.	Lyerje e Pallatit të Kulturës		46,229
9	C.....	S. Shpk	Rikonstruksion trotuari rruga kinemaja e vjetër		888,982
10	C.....	R. G.	Blerje mjete transporti		96,000
11	C.....	R. G.	Blerje mjete tip skrep		330,000
12	C.....	I. SHPK	Suvatim Sallës së Këshillit		19,956
13	C.....	I. SHPK	Rikonstruksioni i Rrugës Dhori Tanaka		26,987
14	C.....	I. SHPK	Ndërtim muri mbajtës në Lagjen 1 Maji, 2016		12,540
15	C.....	I. SHPK	Linjë TM 6 KV për furnizimin e pompës me ujë		25,427
16	C.....	I. SHPK	Përmirësimi i banesave ezistuese për familjet ne nevojë		411,676
17	C.....	A.	Sistemimambjente publike		23,713
18	C.....	A.	Ndërtimi i Trotuarit A. N., G., 2016		27,820
19	C.....	A. G.	Blerje mjetiteknologj, 2016		157,200
20	C.....	H. K.	Rikonstruksion rruga lagje e re + M.Matohiti, 2016-2017	65,508	
21	C.....	Sh.	Rikonstruksion rruga Rrapi Tiku, 2016-2017	464,279	
22	C.....	A..Shpk	Shpim pusi, 2017		77,340

23	C.....	L.. C.	Sinjalist.rrugore Shëtitorja		419,436
24	C.....	G.. C.	Trajtim mur mbajtes në rrugën Rruzhdie-Gjinoqar,2019		244,590
25	C.....	S. SHPK	Rikontruksion rruga kënetë e Mitros Zharrëz,2019	745,199	
26	C.....	S. SHPK	Sistemim i hapësirave për parkim pas ish-bashkisë		522,267
27	C.....	K. G.	Ndërtim rrjetit KUZ, KUB në lagjen Dukas Patos,2019		138,122
28	C.....	G. SHPK	Rikonstruksioni i Shkollës M. Matohiti,2019	4,298,087	
29	C.....	K. I.	Rikontruksion Godinës së Bashkisë 2020		1,148,659
30	C.....	K. I.	Rikontruksion i zyrave mbështetëse të Bashkisë 2020		402,003
31	C.....	2..	Rikontruksion Magjistralit kryesor ujësjellësit Loti I		20,500,000
32	C.....	H.	Rikontruksion Rruga Çamëria 2020	443,852	
33	C.....	H.	Ndërtim KUZ në Rruga Çamëria	65,838	
34	C.....	H.	Rikonstruksioni i rrugësVarreza Dukas		537,266
35	C.....	L.	Adaptim i ish-qendrës Kualif.në Banesa Sociale,Seksioni 2	1,166,448	
36	C.....	L....	Rehabilitim i rrjetit ujitës Belinë		461,113
37	C.....	M. I. G.	Sistemim i hapësirave në Lagjen 29 marsi		2,107,194
38	C.....	G.	Ndërtimi Emergjent i muritmbajtës në rrugën Ruzhdije si pasojë e rrëshqitjes së tokës		398,539
39	C.....	C.	Rikontruksion Shkolla Koli Dimo në adaptim kopështi		201,055
40	C.....	C.	Rikontruksion i ambjenteve të kopështit të fëmijëve qendër Zharrëz dhe sistemim i hapësirave publike		135,436
41	C.....	C.	Rikontruksion i ambjenteve të Shkollës Sotir Capo për adaptimkopështi për fëmijë		149,260
42	C.....	A. C.	Sistemim e rivitalizim i minibloqvelagjia e re		327,621
43	C.....	A. C.	Rikontruksion dhe shtrim me asf-beton rrugfshati i ri sheqishtë		717,080
44	C.....	A. C.	Rikontruksion Magjistralit kryesor ujësjellës Loti II		1,500,000
45	C.....	A.	Rehabilitim i pjesshëm i Godinës NJA Zharrës + dhomat e zhveshjes sporti		270,019
1	C.....	Parapagimkopesht/çerdhe	Parapagim kopesht/çerdhe	138,000	342,000
3	C.....	Parapagim kontrata banesa sociale	Parapagim kontrata banesa sociale		213,243
2	C.....	Taksë pulle Gjendja Civile	Taksë pulle Gjendja Civile	507,300	47,505
<b>Gjendje në datën 31.12.2022</b>				<b>7,894,511</b>	<b>35,722,934</b>

**15. Titulli i gjetjes:** Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, në pasqyrat financiare.

**Situata:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është në vlerën 35,722,934 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 13,225,145 lekë dhe pakësim në vlerën 7,894,511 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 35,722,934 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,208,274 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Patos nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç‘bllokimin e këtyre fondeve.

**Kriteri:** Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

**Ndikimi:** Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

**Shkaku:** Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Patos, Drejtorja e Financës dhe Drejtorja e Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 605,711 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

**Lekë**

<b>Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”</b>	
Çelje e vitit 2022	1,392,790
Shtesa (K)	237,430,243
Pakësime (D)	238,217,322
<b>Gjendja kreditore në 31.12.2022</b>	<b>605,711</b>

Faturat e pa likuiduara të kontabilizuara në pasqyrat financiare më datë 31.12.2022, të cilat janë likuiduar përgjatë muajve janar-shkurt 2023. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

**Lekë**

Nr.	Fatura	Lloji i shërbimit	Subjekti	Vlera
1	471/2022	Uji Dhjetor 2022	Sha Ujësjetës Patos	105,534
2	366/2022	Lavazho Dhjetor 2022	G.	24,240
3	25/2023	Posta dhjetor	Posta	27,885
4	Përmbledhëse	Energjia Dhjetor	FSHU	428,199
5	337/2022	Internet dhjetor 2022	M.	19,853
1	471/2022	Uji Dhjetor 2022	Sha Ujësjetës Patos	105,534
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>				<b>605,711</b>

**Lekë**

Urdhër Shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
66	10.03.23	105,534
32	20.02.23	24,240
34	20.02.23	27,885
6	23.01.23	428,199
10	24.01.23	19,853
<b>Totali</b>		<b>605,711</b>

**-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Patos në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 14,234,425 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

**Lekë**

<b>Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”</b>	
Çelje e vitit 2022	14,298,391
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	63,966
<b>Gjendja debitore në 31.12.2022</b>	<b>14,234,425</b>

(Analiza e detajuar e kësaj llogarie është paraqitur në Projekt Raportin e Auditimit)

## TË ARDHURAT

### 1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

**-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 129,862,412 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 73,686,492 lekë ose me zbritje në vlerën 56,175,920 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

**Lekë**

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
<b>70</b>	<b>I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME</b>	<b>73,686,492</b>	<b>129,862,412</b>
<b>700</b>	<b>1. Tatimi mbi të ardhurat</b>	<b>181,078</b>	<b>529,560</b>
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	181,078	529,560
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
<b>702</b>	<b>2. Tatimi mbi pasurinë</b>	<b>55,740,057</b>	<b>83,922,200</b>
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	55,740,057	83,863,540
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	58,660
<b>703</b>	<b>3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>17,744,257</b>	<b>45,372,902</b>
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	17,744,257	45,372,902
<b>704</b>	<b>4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimdoganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
<b>705</b>	<b>5. Taksë e rrugës</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>708</b>	<b>6. Të tjera tatime e taksa kombëtare</b>	<b>21,100</b>	<b>37,750</b>
<b>709</b>	<b>7. Gjoha e kamatëvonesa</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

## 2. Të ardhurat jo tatimore:

**Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 59,260,827 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 25,888,450 lekë se me zbritje në vlerën 33,372,377 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
<b>71</b>	<b>III. TË ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>25,888,450</b>	<b>59,260,827</b>
<b>710</b>	<b>1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	<b>2,061,527</b>	<b>2,250,475</b>
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	2,061,527	2,250,475
<b>711</b>	<b>2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare</b>	<b>23,612,306</b>	<b>35,324,001</b>
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	19,924,339	24,839,080
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	3,275,767	9,906,598
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	76,000	152,000
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhëmtime	336,200	426,323
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
<b>719</b>	<b>3. Të tjera të ardhura jo tatimore</b>	<b>214,617</b>	<b>21,686,351</b>

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

## 3. Të ardhura të tjera:

**-Llogaria 72 “Grante korente”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 511,218,806 lekë ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 556,263,840 lekë ose me ritje në vlerën 45,045,034 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
<b>72</b>	<b>V. GRANTE KORENTE</b>	<b>556,263,840</b>	<b>511,218,806</b>
<b>720</b>	<b>1. Grant korent i brendshëm</b>	<b>556,263,840</b>	<b>511,218,806</b>
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	206,683,617	189,568,233
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	231,633,267	227,099,348
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçmete ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulimdeficitit (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatimenacionale	103,515,198	76,472,182
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	14,207,167	16,807,171
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	224,591	1,271,872
7209	Të tjera grantekorente të brendshme	0	0
<b>721</b>	<b>2. Grant korent i huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**-Llogaria “Të ardhura të tjera”**, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 172,121,440 lekë ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 238,550,934 lekë ose me ritje në vlerën 66,428,949 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
<b>VI. TË ARDHURA TË TJERA</b>		<b>238,550,934</b>	<b>172,121,440</b>
781	Të ardhura nga investimet në ekonomi	0	0
782	Rimarrje shumash të parashikuara për aktiveafatshkurtra	0	0
783	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatgjata	0	0
784	Rimarrjeshumash për shpenzime të viteve të ardhshme	0	0
787	Tërheqje nga seksioni i investimeve	238,550,934	172,121,440



## SHPENZIMET

### 1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 135,207,772 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 134,718,816 lekë ose me zbritje në vlerën 488,956 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 22,002,883lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 22,877,115 lekë ose me rritje në vlerën 874,232 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Fier me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
6001	Paga, personel i përhershëm	134,718,816	135,207,772
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	18,315,115	19,882,683
6011	Kontribut i SigurimeveShëndetësore	4,562,000	2,120,200
<b>Totali</b>		<b>157,595,931</b>	<b>157,210,655</b>

### 2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2021, ka qenë në vlerën 47,252,054 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 52,623,412 lekë ose me ritje në vlerën 5,371,358 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Fier me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
<b>602</b>	<b>III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME</b>	<b>52,623,412</b>	<b>47,252,054</b>
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	3,549,127	1,785,979
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,729,052	3,598,365
6022	Shërbime nga të tretë	5,578,868	7,883,053
6023	Shpenzime transporti	933,645	7,009,183
6024	Shpenzime udhëtimi	106,760	217,409
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1,656,686	3,569,079
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	0	0
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	39,069,274	23,188,986

**Për vitin 2022** totali i te ardhurave në vlerë është 894,389,716 lekë dhe totali shpenzimeve është 648,196,447 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 246,193,269 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerë 246,193,269 lekë.

### Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

**16. Titulli i gjetjes:** Përfitimi i shërbimeve pa kontratë dhe pa procedurë prokurimi.

**Situata:** Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë kontatohet se, në 10 raste janë zhvilluar projekte artistike, të cilat nuk janë përfitur nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 7-9 dhe nenet 65-70 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i projektit	Urdhër Shpenzimi		Operatori Ekonomikë	Vlera
		Nr.	Datë		
1	Bolero në vilën e pleqëve	132	20.04.2022	E...	200,000
2	Miss dhe mister Patosi	133	20.04.2022	N.....	500,000
3	Ninulldashurie (dita ndërkombëtare e gruas)	176	17.05.2022	A. S.	30,000
4	Yjet Fest	283	22.07.2022	A...	565,000
5	Open kinema	312	04.08.2022	S. G.	300,000
6	S. B.	475	16.11.2022	L. Th., E. M., M. Rr.	60,000
7	Brez pas brezimyeqar	476	16.11.2022	R. I., R. J.	100,000
8	Infermiere E.	551	20.012.2022	A. F.	100,000
9	4 Shfaqeteatrore për qytetin	553	21.12.2022	T. Sh. Ç.	500,000
10	Këngëterinisë	587	30.12.2022	R. Ll.	200,000
<b>Totali</b>					<b>2,555,000</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 71, datë 14.12.2021, të KB me objet “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të Projekt Buxhetit AFM 2022-2024 dhe buxhetin e Bashkisë Patos për vitin 2022”. Duke u bazuar në VKB e mësipërme fondet e miratuara për projektet artistike është në vlerën 3,690,000 lekë nga të cilat është shpenzuar shuma 2,550,000 lekë.

Nga Bashkia Patos për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 10 subjekte është likuiduar shuma 2,550,000 lekë. Për këto projekte nuk ka as kontrata të lidhura ndërmjet palëve por pagesa e këtij shërbimi është kryer mbi bazën e faturave tatimore të lëshuara nga subjektet përkatëse.

**Vlera 2,550,000 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.**

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 7-9 dhe nenet 65-70 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

**Ndikimi:** Shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vlerën 2,555,000 lekë.

**Shkaku:** Nuk janë respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

### 3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Patos nuk ka pasur subvencione.

### 4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 208,610,476 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”**, paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 207,860,476 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
	<b>V. TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>208,610,476</b>	<b>212,735,283</b>
<b>604</b>	<b>I. Transferime korente të brendshme</b>	<b>750,000</b>	<b>21,189,071</b>

6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	0	0
6041	Transferime korente tek institucione të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek Organizata jo fitimprurëse	750,000	21,189,071
<b>605</b>	<b>2. Transferime korente me jashtë</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6051	Transferime për Organizatat Ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për Qeveritë e Huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korrente me jashtë shtetit	0	0
<b>606</b>	<b>3. Transferime për buxhetet familjare e individë</b>	<b>207,860,476</b>	<b>191,546,212</b>
6060	Transferime të paguara nga ISSH e ISKSH	202,672,924	183,545,557
6061	Transferime të paguara nga institucionet e tjera Pushtetit Vendor	5,187,552	8,000,655

Për vitin 2021, numri i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 137 prot., datë 28.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë dhe VKB nr. 69, datë 14.12.2021, “Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njëjësive administrative për vitin 2022”, me numër 131 punonjës. Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative paraqitet si më poshtë:

Viti	Muajt	Plani/Numër punonjës Nëpunës Civil	Realizimi/Numër punonjës Nëpunës Civilë	Diferenca	Plani/Numër punonjës Kod Pune	Realizimi/Numër punonjës Kod Pune	Diferenca
2022	Janar	66	53	13	65	64	1
2022	Shkurt	66	53	13	65	64	1
2022	Mars	66	53	13	65	64	1
2022	Prill	66	53	13	65	64	1
2022	Maj	66	53	13	65	64	1
2022	Qershor	66	53	13	65	64	1
2022	Korrik	66	53	13	65	64	1
2022	Gusht	66	53	13	65	64	1
2022	Shtator	66	53	13	65	64	1
2022	Tetor	66	60	6	65	64	1
2022	Nëntor	66	60	6	65	64	1
2022	Dhjetor	66	60	6	65	64	1

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura konstatohet se, për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 82.9% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 98.4%. Në total realizimi i strukturës është në masën 90.6%.

**17. Titulli i gjetjes:** Rekrutim i punonjësve jo në përputhje me kriteret e pozicionit të punës.

**Situata:** Nga auditimi me zgjedhje i 10 dosjeve të punonjësve të aparatit të Bashkisë Patos konstatohet se, në një rast punonjësi nuk është emëruar në përputhje me kriteret e pozicionit të punës konkretisht:

Pozicioni i punës	Punonjësi/Arsimi
Këshilltar i Kryetarit për teknologjinë dhe informacionin	J.B. i diplomuar në Inxhinieri Naftë dhe ka 7 (shtatë) vite punë në pozicionin Specialist IT në Bashkinë Patos.

Veprime këto në kundërshtim me kriteret për punësim ku përcaktohet që:

Arsimi: Master Shkencor në Inxhinieri. Përvoja: Të paktën 3 vjetpunësim në administratë në fushën e teknologjisë dhe informacionit.
--

**Kriteri:** Kriteret e pozicionit të punës.

**Ndikimi:** Mos efektivitet në përdorim e burimeve njerëzore

**Shkaku:** Keq interpretim i dispozitave ligjore

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa që rekrutimet e punonjësve të kryhen në përputhje me kriteret e pozicioneve të punës.

### **Procesi i inventarizimit**

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të

paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

**18. Titulli i gjetjes:** Regjistri i aktiveve nuk është hartuar sipas formatit përkatës. Ngritja e komisionit të inventarizimit nuk është kryer në përputhje me dispozitat ligjore.

**Situata:** Bashkia Patos ka të hartuar regjistrin e aktiveve në formë elektronike në programin “E.” në vartësi të llojit të aktiveve afatgjata apo afatshkurtra si dhe grupit përkatës brenda llojit. Gjithashtu regjistri nuk është i plotësuar me të gjithë elementët përbërës konkretisht: datën e skadencës, vendodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

Për vitin 2022, Kryetaria e Bashkisë Patos znj. R. B. ka nxjerrë Urdhrin nr. 168, datë 02.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të vetë institucionit dhe NJA Zharrëz dhe Ruzhdie i përbërë nga 15 punonjës si dhe Urdhrin nr. 169, datë 02.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të asetëve i përbërë nga nga 7 punonjës. Procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit është kryer dy herë radhazi nga i njëjti komision i cili ka ushtruar këtë funksion në vitin 2021 në zbatim të Urdhrit nr. 131, datë 21.10.2021, të Kryetares të Bashkisë znj. R. B..

**Kriteri:** Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30 dhe pika 84.

**Ndikimi:** Paraqitje jo e plotë e pozicionit financiar.

**Shkaku:** Kjo vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e rrishtit nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Patos të marrë masa për të eliminuar praktikën e kryerjes së procesit të inventarizimit peridik të aktiveve, dy herë me rradhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision.

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit është hartuar relacioni shoqërues i inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve të inventarit për Bashkinë Patos dhe NjA sipas shkresës nr. 440 prot., datë 13.02.2023, në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 85, gërma “c”.

Me Vendimin nr. 27, datë 13.02.2023, të Kryetaria e Bashkisë znj. R. B. është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit të materialeve të inventarit për vitin 2022 si më poshtë:

Lekë		
Nr.	Llogaria kontabël	Vlera
1	Llogaria kontabël 327/1 (inventar i imët)	1,373,121
2	Llogaria kontabël 218/1 (inventar informatik)	751,289
3	Llogaria kontabël 218 (inventar ekonomik)	811,382
4	Llogaria kontabël 214 (inventar makineri e pajisje vegla pune)	18,000
5	Llogaria kontabël 215 (inventar mjete transporti)	1,450,000
<b>Totali</b>		<b>4,403,792</b>

Deri më datën 24.03.2023, në të cilën përfundon faza e auditimit në terren nuk është realizuar procesi i asgjësimit të aktiveve të cilat janë vlerësuar për nxjerra jashtë përdorimit sipas Vendimit nr. 27, datë 13.02.2023, të Kryetares të Bashkisë znj. R. B..

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

- 1 Znj. R. B. me detyrë Kryetare e Bashkisë Patos.
- 2 Z. Sh.B. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 3 Znj. M. Sh. Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

## 2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

### 2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet të Këshillit Bashkiak.

#### 2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Patos (regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve) si dhe të dhënave nga Sistemi i Prokurimit Elektronik të APP-së për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten si më poshtë:

Lekë						
Periudha	Lloji i procedurës	Nr. Proc.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
01.07.2019-31.12.2019	Hapura	3	509,559,993	497,527,501	12,032,492	2.3%
	Kërkese për propozim	6	21,081,585	19,789,481	1,292,104	6.1%
2020	Hapura	4	657,619,953	634,392,262	23,227,690	3.53
	Kërkes për propozim	12	37,232,325	34,633,830	2,598,494	6.97%
2021	Hapura	5	145,506,697	120,624,673	20,321,291	13.7%
	Kërkes për propozim (E hapur e thjeshtuar)	16	55,968,357	48,145,400	7,822,955	13.97%
	Me negocim pa shpalljepraprake të njoftimit	1	7,028,081	7,011,559	16,521	0.23%
2022	Hapura	5	189,379,985	161,332,567	20,322,109	10.7%
	E hapur e thjeshtuar	7	28,194,337	26,704,194	1,490,142	5.28%
	Me negocim pa shpalljepraprake të njoftimit	1	2,390,844	2,378,865	11,978	0.5%
<b>Shuma procedura sipas llojit</b>		<b>60</b>	<b>1,653,962,157</b>	<b>1,552,540,337</b>	<b>89,135,779</b>	<b>5.3%</b>
Periudha	Procedura sipas objektit	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	% ndarë në lloje	
					Fond limit	Kontratës
01.07.2019-31.12.2019	Ne fushën e ndërtimeve	3	481,206,828	470,598,209	10,608,619	2.2%
	Në shërbime/ blerje, etj	6	49,434,750	46,718,773	2,715,977	5.4%
2020	Ne fushën e ndërtimeve	8	671,431,934	647,188,505	24,243,431	3.61%
	Në shërbime/ blerje, etj	8	23,420,341	21,837,588	1,582,753	6.75%
2021	Ne fushën e ndërtimeve	11	140,242,734	115,190,112	22,511,565	16%
	Në shërbime/ blerje, etj	11	68,260,397	60,591,521	5,649,202	8.27%
2022	Ne fushën e ndërtimeve	4	153,668,169	125,755,550	27,912,618	18.1%
	Në shërbime/ blerje, etj	9	66,296,997	64,660,007	1,602,120	2.41%

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022, janë realizuar **në total 60** procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit në shumën **1,653,962,157** lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **1,552,540,337** lekë pa Tvsh, ndërsa për secilin vit buxhetor janë realizuar si më poshtë:

-Për 6-mujorin e dytë të vitit 2019 janë realizuar **9** procedura prokurimit me vlerë të lartë me fond limit në shumën **530,641,578** lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **517,316,982** lekë pa Tvsh, nga të cilat referuar llojit të procedurës janë realizuar, **3** procedura prokurimit në fushën e ndërtimeve me fond limit në shumën **481,206,828** lekë pa Tvsh dhe **6** procedura prokurimit në fushën e shërbimeve dhe blerjeve etj., me fond limit **49,434,750** lekë pa Tvsh.

-Për vitin 2020 janë realizuar **16** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit në shumën **694,852,278** lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **669,026,096** lekë pa Tvsh, nga të cilat referuar llojit të procedurës janë realizuar, **8** procedura prokurimit në fushën e ndërtimeve me fond limit në shumën **671,431,934** lekë pa Tvsh dhe **8** procedura prokurimit në fushën e shërbimeve dhe blerjeve etj., me fond limit **23,420,341** lekë pa Tvsh.

-Për vitin 2021 janë realizuar **17** procedura prokurimi me fond limit në shumën **201,475,054** lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **168,770,074** lekë pa Tvsh, nga të cilat referuar llojit të procedurës janë realizuar, **11** procedura prokurimit në fushën e ndërtimeve me fond limit në shumën **140,242,734** lekë pa Tvsh dhe **11** procedura prokurimit në fushën e shërbimeve dhe blerjeve me fond limit **68,260,397** lekë pa Tvsh.

-Për vitin 2022 janë realizuar **13** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit në shumën **219,965,166** lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **190,415,628** lekë pa Tvsh, nga të cilat referuar llojit të procedurës janë realizuar, **4** procedura prokurimit në fushën e ndërtimeve me fond

limit në shumën **153,668,169** lekë pa Tvsh dhe **9** procedura prokurimit në fushën e shërbimeve dhe Blerjeve etj., me fond limit 66,296,997 lekë pa Tvsh.

-Mbi likuidimin e procedurave të prokurimeve me vlera të larta për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022, paraqitet si më poshtë:

Periudha	Vlera e kontratave me Tvsh	Likuiduar	Realizimi në %
Nga data 01.07.2019-31.12.2019	613,915,009	480,888,925	78.3%
2020	792,540,467	110,935,807	13.9%
2021	210,791,085	168,215,247	79.8%
2022	206,119,400	103,421,391	50.1%
<b>Totali</b>	<b>1,823,365,961</b>	<b>863,461,370</b>	<b>47.3%</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022, janë realizuar **në tota 160** procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit në shumën **1,653,962,157** lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **1,552,540,337** lekë pa Tvsh, nga të cilat janë audituar **10** procedura me fond limit në shumën **1,323,416,128** lekë pa Tvsh ose në masë **80%** të fondit limit. Me vlerë të kontratave të lidhura **1,273,984,149.65** lekë pa Tvsh ose 96% e vlerës së prokuruar.

a. Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.07.2019, deri më 31.12.2019**, paraqiten si më poshtë:

### 1. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”.

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, Bashkia Patos, viti 2019.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 8 datë 07.05.2019	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr.1067/1 prot., datë 07.05.2019	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> Nr.1067/1 prot., datë 07.05.2019
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	1 D. K. (Jurist) 2. A. K. (Ing. Ndërtimi) 3. F. K. (Ekonomist)	1. A. P. (Kryetar)-Akitekt 2. E. R. (Akitekt) <b>3. B. F.</b> 3. I. Sh. (Juriste)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 74,258,784 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE & “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk, vlera e ofertës 72,259,124 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,999,660 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 24.06.2019	<b>9. Burimi Financimit:</b> Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE “4...” Shpk 2. OE “A. K.” Shpk 3. OE “A. K.” Shpk 4. BOE “B..” Shpk 5. BOE “B.” Shpk 6. OE “E.” Shpk 7. OE “F. K.” Shpk 8. BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk 9. OE “L. K.” Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b>	<b>12. Përgjigjeankesës nga AK,</b> - Ankesa me nr.1910 prot, datë 11.07.2019 e OE “L. K.” Shpk ka marrë përgjigje me shkresën nr. 1910/5 prot., datë 17.07.2019. - Ankesa me nr.1918 prot, datë 12.07.2019 e OE “B.” Shpk ka marrë përgjigje me shkresën nr. 1918/3 prot., datë 17.07.201	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b> Vendimi nr. 586/1 2019, datë 04.09.2019
<b>b. Kontrata nr. 1667 prot., datë 24.09.2019</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 24.09.2019</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>86,710,948.80</b>

### Hartimi i kritereve të DT:

Me shkresën nr. 1067/7 prot., datë 09.05.2019, nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali nr. 1, me objekt “Mbi diskutimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit”.

Me shkresën nr. 1067/8 prot., datë 09.05.2019, Njoftimi i kontratës së shkurtuar, botuar në Buletin me nr. 19 datë 13 Maj 219, faqe 22/546.

### **Ankesapër DT**

Me shkresën me nr. 1343 prot., datë 13.05.2019, OE “B..” Shpk, ka paraqitur ankesë për DT të procedurës.

Me nr. 1343/1 prot., datë 15.05.2019 Titullari i AK ka urdhër pezullimi e procedurës së prokurimit dhe është ngritur KSHA (me nr. 1334/2 prot., datë 15.05.2019) i përbërë ng: A. P., E. R. e I. Sh..

Vendimi i KSHA me nr. 1343/3 prot., datë 15.05.2019, miratuar nga Titullari i AK për miratimin pjesërisht të ankesës për DT.

Me nr. 1343/5 prot., datë 17.05.2019 “Kthim përgjigje” i është drejtuar OE “B...” Shpk, vendimi i marrë nga Titullari i AK.

Me shkresën me nr. 1359 prot., datë 15.05.2019 OE “S.” Shpk ka paraqitur ankesë për DT të procedurës.

Me nr. 1359/1 prot., datë 15.05.2019 Titullari i AK ka urdhër KSHA për shqyrtimin e:

-ankesës nr. 1359 prot., datë 15.05.2019 të OE “S.” Shpk;

-ankesës nr. 1360 prot., datë 15.05.2019 të OE “A.” Shpk;

-ankesës nr. 1361 prot., datë 15.05.2019 të OE “K. K.” Shpk;

Vendimi i KSHA me nr. 1359/2 prot., datë 20.05.2019, miratuar nga Titullari i AK, për mos miratimin e ankesës të OE “S.” Shpk për DT.

Me nr. 1359/4 prot., datë 17.05.2019 “Kthim përgjigje” i është drejtuar OE “S.” Shpk, vendimi i marrë nga Titullari i AK.

Vendimi i KSHA me nr. 1360/1 prot., datë 20.05.2019, miratuar nga Titullari i AK, për pranimin e ankesës të OE “A.” Shpk për DT.

Me nr. 1359/4 prot., datë 17.05.2019, “Kthim përgjigje” i është drejtuar OE “A.” Shpk, vendimi i marrë nga Titullari i AK.

Vendimi i KSHA me nr. 1361/1 prot., datë 20.05.2019, miratuar nga Titullari i AK, për miratimin e pjesëshëm të ankesës të OE “K. K.” Shpk për DT.

Me nr. 1361/3 prot., datë 20.05.2019 “Kthim përgjigje” i është drejtuar OE “K. K.” Shpk, vendimi i marrë nga Titullari i AK.

### **Ndryshimet në DT:**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 21.05.2019, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, Bashkia Patos me fond limit **74.258.784 lekë pa Tvsh**, AK Bashkia Patos në lidhje me procedurën me REF--21292-05-09-2019, në lidhje me disa konstatime në DT.

Me nr. 1067/1 Prot., datë 21.05.2019 datë është publikuar në SPE “Shtojca e DT”. Nga monitorimi që APP po i bën procedurave NJP ka vendosur ndryshimet në DT dhe paraqitjen në SPE të shtojcës:

Me nr. 1067/14 prot., datë 14.06.2019, NJP ka kërkuar pezullimin nga Titullari i AK, pasi janë hartuar një Shtojcë për DT, në zbatim të Manualit nr. 2, datë 06.02.2018 “Për rolin e administratorit, NjP dhe KVO”.

Me nr. 1067/13 Prot., 19.06.2019 datë është publikuar në SPE “Shtojca e DT”. Nga monitorimi që APP po i bën procedurave NJP ka vendosur ndryshimet në DT dhe paraqitjen në SPE të shtojcës.

**19. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirect pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **Situata:**

**1. Në pikën 2.2 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “..në lidhje me licencat profesionale (kategoritë dhe nivelin e klasifikimit), rezulton se AK ka kërkuar disponimin e kategorie:...

NS-8 Ndërtime të parapërgatitura, beton-arme/metalike “Kategoria A”

NS-12 Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit “Kategoria A”

NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni “Kategoria A”

**2. Në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Dëshmitë për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

(Mjetet mund te jene ne pronesi ose me qera)

- Kamiona, kapaciteti total mbajtës 10- 20 toncopë 4
- Kamiona, kapaciteti total mbajtës 2- 3 ton copë 2
- Kamionçine, kapaciteti total mbajtes 2 - 4 toncopë 2
- Kamion me vinccopë 2
- Autobot uji mbi 5000 litra copë 2
- Pompe per shtresat e varfra copë 1
- Pajisje ndricimi për kantier copë 1
- Minieskavator copë 1
- Bobcat copë 1
- Eskavator me goma copë 2
- Tokmak elektrik copë 1
- Matrapik copë 5
- Kompresor copë 1
- Tranzh copë 2
- Pirun copë 1
- Saldatrice copë 4
- Gjenerator copë 2

Vendosja e kërkesës për disponimin e mjete/makineri të mësipërme, mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet, punimet konkrete që do të realizohen dhe volumet e tyre nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**3. Në pikën 2.4 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Në lidhje me fuqinë punëtore të operatorit ekonomik kërkohet:

Mbi argumentimin e stafit teknike:

- Mbi punimet e prishjes 9 puntorë + 1 teknik + 1 manovrator mjete transporti + 1 skrepist + 1 inxhinier
  - Punimet e muratures: 5 specialist + 3 puntorë.
  - Punime të suvatimit dhe bojatisje + shtresa+çatie: 5 suvaxhinj + 5 bojaxhinj + 10 puntorë. + 3 specialist + 6 puntore + 2 manovrator trans+ 2 automakinist
  - Punime dyer+dritare:2 specialist dritaresh + 2 puntor .
  - Punime ndërtimi palestere: 5 karpentier + 5 hekurkthyes + 5 puntor+ 2 manovrator + 3 manovrator transporti
  - Punime hidrosanitare: 3 pllakashtrues + 3 hidraulike+ 5 puntorë.
  - Punime elektrike dhe ngrohje: 3 mekanike + 2 hidraulike+ 4 puntore.+ 3 manovrator + 2 manovrator mjetesh
  - Punime të sistemit të jashtëm: 3 pllakashtrues + 6 puntorë+4 saldator
- Totali i stafit është:
- Specialistë: - 48 persona
  - Puntorë: - 16 persona
  - Manovratorë : - 6 persona
  - Teknik ndërtimit: - 1 person
  - Inxhiniera - 9 persona
  - Mjek - 1 person
  - Auditues energjie - 1 person
  - Ekspert MNZ - 1 person
  - Teknikë - 2 persona
- Totali: - 85 persona**

Kërkesat për fuqinë punëtore (85) i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “ ...Kriteret duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.”,

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.



Kriteri që 6 (gjashtë) manovrator, e 3 (tre) shofere, të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë operatori ekonomik për ekzekutimin e kontratës, kërkohen të jenë *në pronësi ose me qera*. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listëpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit.

**4. Në pikën 2.4.1 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “*..në lidhje me drejtuesit teknik që duhet të figurojnë në licencën dhe në listëpagesat e OE, ndër të tjerë, AK ka kërkuar:*

- Inxhinier ndërtimi Profili Strukturist (1))
- Inxhinier topograf (1)
- Inxhinier mjedisi (1) i pajisur me VNM
- Inxhinier elektronik (1)
- Arkitekt (1)

Referuar punimet konkrete të parashikuara në preventiv, nuk është parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do të ishte e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar nga AK dhe do të ishte e nevojshme ekspertiza plotësuese e **inxhinierëve**: ndërtimi profili strukturist: mjedisi i pajisur me VNM e elektronik.

**elektronik.**

**5. Në pikën 2.4.2 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 43 (dyzete e tre) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose institucion ekuivalent me profesionet si më poshtë:*

- Elektricitist 5
- Hidraulik 4
- Karpentiere 5
- Bojaxhi 5
- Mekanik 5
- Saldator 5
- Pllakashtrues 3
- Hekurkthyes 3
- Murator 5
- Konstruktor metalik 1
- Specialist termoteknik 1
- Specialist izolimi 1

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucion ekuivalent, kontratat e punës të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën tetor 2018 - mars 2019.*

Kërkesat për fuqinë punëtore 43 punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

**5. Në pikën 2.4.4 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003 për të paktën 6 muajt e fundit. Në rastin e bashkimit të operatorëveekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm”.*

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata

kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Vendosja e këtij kriteri, penalizon/kufizon pjesëmarrjen e OE/BOE, që nuk janë të detyruar për marrjen në punë të mjekut të ndërmarrjes referuar VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar (pika 12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.).

**6. Në pikën 2.4.5 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë Ing. Auditues Energjie 1 (një) person të pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë, për të cilin duhet të ketë këto dokumenta provues: Kontrata e punës e vlefshme, Diploma dhe certifikata për efikasitetin e energjisë, të jetë i pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit.

Kërkesa për Auditues Energjie, referur komponentët në lidhje me efikasitetin e energjisë janë ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumenteve teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi), nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, duke konsideruar faktin që; kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorisë në fjalë), dhe nuk përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**5. Në pikën 2.4.6 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij Ekspert zjarrfikës 1 (një) person, për të cilin operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Ekspertit zjarrfikës, CV si dhe Kontraten e punës të vlefshme dhe të rezultojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit.”

**6. Në pikën 2.4.7 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij një person të pajisur me certifikatë për mbrojtjen e shëndetit dhe tësigurisënë punë, lëshuar nga autoritete të certifikuara. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikate për mbrojtjen.

Shëndetit dhe të Sigurisë në punë, CV, dhe të figurojë në listepagesë për të paktën 6 muajt e fundit”.

**7. Në pikën 2.5 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar, “ në lidhje me disponimin e liçinsave nga QKB, AK ka kërkuar: Kandidati/ofertuesi duhet të jetë i pajisur me liçencat e mëposhtme:

Licencë nga QKB me kod I.2.A;

Licencë nga QKB me kod III.2.B ;...

- Zbatimin e përcaktimeve të nenit 46 Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që parashikon se “...çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhë me natyrën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa për licencën e mësipërme duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;

- Ekspertizat profesionale në fjalë janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacioneve teknike.

- Garantimi i realizimi të punimeve respektive në fazën e zbatimit përmbushet nëpërmjet disponimit nga ofertuesit të kategorisë respektive në licencën profesionale.

Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon: a) “Shërbime ekspertize” me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit.

Veprimtaritë e nënkategorisë **III.2.B** specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

Kriteri për disponimin e licencë me Kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve.

**8. Në pikën 2.3.6. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar, “në lidhje me çertifikatën ISO të prodhuesit/distributorit, AK ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori dhe certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit/distributorit të autorizuar, për pajisjet e pasqyruara në preventiv, për:*

Në lidhje me kërkesën që produktet të jenë të pajisura me certifikatën ISO 9001:2015, nga NJHDT, nuk i është në përputhje me:

- nenit 46, pika 2 të LPP parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organet e pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuar atë cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit*”.

- nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 parashikohet se: “*AK për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”.

Operatorët ekonomikë ofertues në këtë procedurë prokurimi, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të produkteve të kërkuara prej jush, por e sigurojnë mallin nga prodhuesit. Në këtë rast kërkesa për paraqitjen e çertifikatës ISO të prodhuesit rezulton t’i adresohet palëve të treta (prodhuesit), të cilët nuk janë konkurrent në procedurën e prokurimit.

**Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik,** në lidhje me çertifikatën ISO, AK ka kërkuar:

*Çertifikata ISO 3834-2:2006 (e vlefshme); “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim”*

*Çertifikata ISO 8000 -2014 (e vlefshme) “Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë sociale”*

*Çertifikata ISO 9001-2015 (e vlefshme) “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”*

*Çertifikata ISO 14001-2015 (e vlefshme) “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”*

*Çertifikata OHSAS 18001-2007 (e vlefshme) “Shëndetin dhe Sigurimin në punë”,*

*Çertifikata PAS 99-2012 (e vlefshme) “Sistemet e menaxhimit të integruar”*

*Çertifikata ISO 50001 -2011 (e vlefshme) “Për sistemet e menaxhimit të energjisë”;*

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mëspërme nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: ...*Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mire argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirect pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: *znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.*

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK Bashkia Patos, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që. në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe

vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mire argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. K., z. F. K.**

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e Njësisë së Prokurimi: **Znj. D. K., z. F. K. e z. A. K. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/23.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimin nr. 21, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.**

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO me nr. 2, datë 24.06.2019 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 9 (nëntë) OE/BOE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

Procesverbali i KVO me nr.3, datë 08.07.2019 “I hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat e ekonomike”.

Procesverbali me nr. 4, datë 00.10.2019 “Mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave” për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar të 1 BOE, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk.

**Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. OE “4...” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **55,674,899** (pesëdhjetë e pesëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) **lekë pa Tvsh.**

2. OE “A. K.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

3. OE “A. K.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **73,841,894** (shtatëdhjetë e tre milion e tetëqind e dyzetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa Tvsh.**

4. OE “B.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

5. OE “B.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **59,054,627** (pesëdhjetë e nëntë milion e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) **lekë pa Tvsh.**

6. OE “E. V.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

7. OE “F. K.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **73,281,194** (shtatëdhjetë e tre milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa Tvsh.**

8. BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **72,259,124** (shtatëdhjetë e dy milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e katër) **lekë paTvsh.**

**9. OE “L.K.” Shpk**, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **56,437,555.30** (pesëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesëpikë tre) **lekë pa Tvsh.**

**Janë skualifikuar OE/BOE si më poshtë:**

1. OE “4...” Shpk;
2. OE “A. K.” Shpk;
3. OE “A. K.” Shpk;
4. OE “B.” Shpk;
5. OE “B.” Shpk;
6. OE “E. V.” Shpk;
7. OE “F. K.” Shpk;
8. OE “L. K.” Shpk;

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, është informuar **BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A. S.” Shpk**, është identifikuar si oferta e suksesshme. Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 08.07.2019.

- **Ankesa me nr. 1910 prot.**, datë 11.07.2019 e OE “L. K.” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 1910/5 prot., datë 17.07.2019.

- **Ankesa me nr. 1918 prot.**, datë 12.07.2019 e OE “B.” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 1918/3 prot., datë 17.07.2019.

Për këtë procedurë ka vendim të KPP-së me nr. 586/1, datë 04.09.2019, në Bashkinë Patos me nr. 2090/4 prot., datë 09.09.2019.

Raporti përmbledhës me nr. 1067/15 prot., datë 1.09.2019, miratuar nga i titullarit të AK znj. R. B.. Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr. 1067 prot., datë 11.09.2019.

Kontrata me **BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A. S.” Shpk**, me nr. 1007 prot., datë 24.09.2019. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **85,964,816** (tetëdhjetë e pesë milionë e nëntëqindë e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqindë e gjashtëmbëdhjetë) **lekë me Tvsh.**

**Lidhur me BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A. S.” Shpk, të shpallur fitues**, rezulton se BOE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**20. Titulli i gjetjes:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Me nr. 3126 rep., nr. 1365/1 kol., datë 15.06.2019, kontrata e bashkpunimit të përkohshëm ndërmjet OE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, ku punimet do të realizohen në raporte respektive 8.67%, 23.58% e 67.75% ku mardhëniet nga dita e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e punimeve do të kryhen nga përfaqësues i BOE “G.” Shpk, me administrator z. A. B..

Me nr. 3127 rep., nr. 1366/1 kol., datë 15.06.2019, prokura e posaçme, ku emërohet përfaqësues i BOE “G.” Shpk, me administrator z. A. B., nga OE “Sh.” me administrator z. Y. B..

**BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, nuk plotëson pikën 2.1** “për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2018, kudo ku operatori ushtron aktivitet” pasi:

**BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, nuk plotëson pikën 2.3** “Kopje të certifikuar të bilancit të viteve 2016, 2017 dhe 2018 të paraqitura në autoritetin përkatës Drejtoria e Tatimeve, të konfirmuara nga ky autoritet si dhe nga një Ekspert Kontabël i Autorizua”.

**OE “Sh.” Shpk, ka deklarua në Shtojcën 10**

**I. Kamiona, kapaciteti total mbajtës 10- 20 ton-5 (pesë) Copë**

**a.** Kamion 10-20 ton -1 copë: Targa AA...; Leje qarkullimi nr. TR.....; Shasia nr. WD.....; Kontrata e qirasë nr. 3067 Rep., nr. 1331 Kol., datë 13.06.2019. Çertifikata me nr. 498 prot., datë 28.01.2019 me nr. 20 “Për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit”, nga Bashkia Vorë.

**b.** Kamion 10-20 ton -1 copë: Targa AA.....; Leje qarkullimi nr. TR.....; Shasia nr. WD.....; Kontrata e qirasë nr. 3067 Rep., nr. 1331 Kol., datë 13.06.2019.

Çertifikata me nr. 499 prot., datë 28.01.2019, me nr. 21 “Për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit” nga Bashkia Vorë.

c. Kamionë 10-20 ton; Targa AA.....; Leje qarkulliminr. FR.....; Shasia nr. WD.....; Kontrata e qerasë nr.1515 Rep., nr. 774 Kol., datë 29.09.2019 (10 vite)

d. Kamion 10-20 ton; Targa AA.....; Leje qarkullimi nr. FR.....; Shasia nr. WM.....; Kontrata e qirasë nr. 894 Rep., nr. 447 Kol., datë 24.05.2016 (10 vite), me qiradhënës z. Z. M.. Çertifikata e kryerjes së operacionit teknik ka përfunduar më datë 02.07.2019.

e. Kamion 10-20 ton; Targa AA...; Leje qarkullimi nr. SR...8; Shasia nr. ZC.....; Kontrata e qirasë nr. 2559 Rep., nr. 983 Kol., datë 08.11.2018 (10 vite).

Me qiradhënës OE “J. C.” Shpk. Me kapacitet 23 ton (40,000-17,000).

Çertifikata me nr. 01, datë 20.02.2018, “Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet”, lëshuar nga DRSHTRR, Sarandë.

#### **OE “Sh.” Shpk, nga 5 kamion të paraqitur**

#### **II. Kamiona, kapaciteti total mbajtës 2- 3 ton-2 copë**

a. Kamion 2-3 ton; Targa AA.....; Leje qarkullimi nr. FR.....; Shasia nr. WD.....; Kontrata e qirasë nr. 1347 Rep., nr. 1073 Kol., datë 09.05.2016 (10 vite).

Çertifikata me nr. 132, datë 06.06.2017, “Për transport ndërkombëtar mallrash për nevojat e vetë” nga DRSHTRR, Fier, për OE “Sh.” Shpk.

b. Kamionë 2-3 ton -1 copë; Targa AA.....; Leje qarkullimi nr. TR.....; Shasia nr. WD..... Kontrata e qirasë nr. 3067 Rep., nr. 1331/1 Kol., datë 13.06.2019, (për objektin e prokuruar). Çertifikata me nr. 17 prot., datë 21.03.2019, me nr. 21 “Për transport mallrash për nevojat e veta brenda vendit” nga Bashkia Ura Vajgurore për OE “E. K.” Shpk. Certifika e kryerjes së operacioneve teknika ka përfunduar më datë 10.02.2019.

#### **III. Kamionçinë, kapaciteti total mbajtës 2-4 ton**

##### **- IV. Kamion me vinç-copë 2**

##### **- V. Autobot uji mbi 5000 litra copë 2**

**BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk**, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor të shpalltefitues **BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk** “por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga Titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e **BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk**. Sa më sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet: “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO znj. A. P., znj. E. R., znj. B. F. e znj. I. Sh.

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **72,259,124 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **72,259,124 lekë pa Tvsh.**

**Konkluzioni:** Referuar sa më sipër, kualifikimi i BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: znj. A. P., në cilësinë e Kryetare e KVO, znj. I. Sh. e znj. E. R. dhe znj. B. F. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. R. B..

Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, në kushtet kur duhej anuluar dhe AK të zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **72,259,124 lekë pa Tvsh**, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK, anëtarët e NJHDT dhe KVO.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetare e Bashkisë Patos në cilësinë e titullarit të AK, znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit. dhe znj. A. P., znj. E. R., znj. I. Sh. dhe znj. B. F. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe Titullaren e AK znj. R. B..

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave :Znj. A. P., znj. E. R., znj. B. F. e znj. I. Sh. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/23.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimin nr. 21, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*  
**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

## 2. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)”, Bashkia Patos.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës)”, Bashkia Patos, viti 2019		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 2 datë 16.08.2019	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 2214 Prot., datë 18.08.2019	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 2214/4, datë 19.08.2019:</b>
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar”	1. F. K. P. Sektorit të Prok. Publik 2. A. K. Dr. Hartimi të Polit./Projekt 3. M. N. Specialist Prokurimi/Jurist	1. Sh. B. (Kryetar) 2. A. P. (Anëtare) 3. G. A. (Anëtar)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> <b>450,024,892 lekë</b>	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “2...” Shpk, vlera e ofertës, 444,056,344 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 5,968,548 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 30.09.2019	<b>9. Burimi Financimit:</b> AKUM	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE “S.” Shpk 2. OE “S.” Shpk 3. OE “A.” Shpk 4. OE “B.” Shpk 5. OE “S.” Shpk 6. OE “L.” Shpk 7. OE “A. K.” Shpk 8. OE “A. S.” Shpk 9. OE “G.” Shpk 10. OE “A. I. G.” Shpk 11. OE “2...” Shpk
<b>11. Ankimime AK, Ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> - Ankesa me nr. 2948 prot., datë 31.10.2019 e OE “2...” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 2948/4 prot., datë 06.11.2019. - Ankesa me nr. 2907 prot, datë 29.10.2019 e OE “S.” Shpk ka marrë përgjigje me shkresën nr. 2907/5 prot., datë 04.11.2019 - Ankesa me nr. 2930 prot, datë 30.10.2019 e BOE “L.” Shpk & “Sh. I.” Shpk & “B.” Shpk ka marrë përgjigje me shkresën nr. 2930/4 prot, datë 05.11.2019.	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> KPP-së me Nr. 100/2020, Tiranë, më 05/03/2020
<b>b. Kontrata 2214 prot., datë 31.03.2020</b>		
<b>15. Vlëra e kontratës (me tvsh)</b>	<b>532,867,612.8</b>	

**Hartimi fondit limit:** Projekt zbatimi, grafiku i punimeve, projekt preventive dhe përlllogaritja e fondit limit është realizuar, nga BOE “I.” Shpk & “A.” Shpk.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e Prokurimit me Procesverbalin e datës 18.08.2019, është autorizuar z. F. K., nëpunësi i cili do të kryejë veprimet bë SPE.

Me shkresën nr. 2213/2 prot., datë 16.08.2019, Titullari i AK, i është drejtuar “Ujësjiellës Kanalizime” Sha, Patos për caktim e një specialisti të fushës për tu bërë pjesë e KVO-së.

Me nr. 114 prot., datë 19.08.2019, nga administratori i UK Sha, Patos është rekomanduar z. G. A. (inxhinier ndërtimi, Kryetar i Bordit Drejtues të Ujësjiellësit)

Më datë 19.08.2019 (pa numër protokolli) Kriteret e vlerësimit, formuluar/nënshkruar nga z. A. K..

Procesverbali mbi diskutimin dhe miratimin e DT me nr. 2214/5 prot., datë 19.08.2019, formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP. Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DT.

Me nr. 2214/6 prot., datë 20.08.2019 Njoftimi i shkurtuar i kontratës.

Deklarata e mospasjes së konfliktit të interesit më datë 19.08.2019 (pa numër protokolli) nga anëtarët e KVO-së.

Me Procesverbalin nr. 272 prot., datë 22.09.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP.

### **Ndryshime në DT: Shtojca 7, datë 05.10.2021 në SPE.**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 21.08.2019, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE, autoritetit kontraktor Bashkia Patos në lidhje me procedurën.

Bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 42, pika 2, dhe në nenin 62 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Njësia e Prokurimit me iniciativën e vet vendosi të bëjë modifikimin e DT për procedurën me objekt: “Rikonstruksioni i magjistratit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjiellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës), me fond limit 450,024,892 (katërqind e pesëdhjetë milion e njëzetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy)lekë pa Tvsh.

**21. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT nuk ka formuluar Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mire argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **Situata:**

**1. Në Pikën 2.3. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licencë disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar”.

Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

N.P.1: Punimegërmimi nëtokë. “Kategoria B”

NP 4 B; Rrugë, Autostrada, Mbikalime, Hekurudha, Tramvaj, Metro, Pista Aeroportuale “Kategoria B”

NP 5 A; Punime nëntokësore, Ura dhe Vepra Arti “Kategoria A”

NP 7 F; Ujësjiellësa, Gazsjellësa, Vajsjellësa, Vepra kullimi dhe vaditje “Kategoria F”

**N.P.12: Punime të inxhinierisë Mjedisore “Kategoria A”**

Për procedurat e punës të përcaktuara në projekt-preventiv, të sistemimit, spostimit apo ndryshimit të linjave të transmetimit të tensionit të mesëm të rrjetit të energjisë elektrike

NS 6A; Sinjalistika rrugore jo ndriçuese “Kategoria A”

NS 9A; Punime strukturorë speciale. “Kategoria A”

NS-18: Punime topogjeodezike. “Kategoria A”

**2. Në Pikën 2.3. ii. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin e mëposhtëm ;



3. Në Pikën 2.3. ii. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “a. Stafi Teknik i Shoqërisë të ketë në përbërje :

1. Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
2. Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
3. Inxhinier Topograf	1 (një)
4. <b>Inxhinier Gjeolog</b>	<b>1 (një)</b>
5. Inxhinier Mekanik	1 (një)
6. <b>Inxhinjer Mjedisi</b>	<b>1 (një)</b>

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë në **Listëpagesat për periudhën (Gusht 2018-Korrik 2019)** dhe në **licencën e shoqërisë**.

Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- **kontratë pune e vlefshme**

- **diploma;**

4. Në Pikën 2.3. ii. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “**b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, dhe të figurojë në listëpagesa ne periudhën e kërkuar më sipër, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve që plotëson kriteret e VKM nr. 742, datë 06.11.2013, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. (marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës”.**

5. Në Pikën 2.3. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “**c. Operatori ekonomik duhet të ketë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Gusht 2018-Korrik 2019) si pjesë e stafit teknik;**

c1. Drejtuesi i punimeve në kantier që do të vendoset një inxhinier që përmbush kriteret për të qenëkoordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Për specialistin e kërkuar si më sipër, duhet të paraqitet:

- **Certifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i akredituar, licencuar/certifikuar, certifikimishqiptar ose i huaj.**

c2. **Specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dëshmuar me kontratë pune dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH.**

Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: “...**Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.**”

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: “**fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit**”.

6. Në Pikën 2.3. iv. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “**Operatori ekonomik duhet të jetë e pajisur me licencat e lëshuara nga QKB si më poshtë:**

- **Licencë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ndryshme, kodi III .2.B”.**

7. Në Pikën 2.3. v, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “**Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:**

a. **ISO 9001-2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente (e vlefshme).**

b. **ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalente (e vlefshme).**

c. **OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 (Sistemi i menaxhimit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente (e vlefshme).**

d. ISO 39001-2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugore) ose ekuivalente (e vlefshme).

e. ISO PAS 99:2012 (Për sistemin e integruar të menaxhimit) ose ekuivalente (e vlefshme).

f. ISO 3834-2:2006 (Kërkesat e cilësisë për saldime me shkrirje të materialeve metalike) ose ekuivalente (e vlefshme).

g. ISO 50001: 2011 (Për sistemin e menaxhimit të energjisë) ose ekuivalente (e vlefshme).

8. Në Pikën 2.3. vi.të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kërkohen të jenë në dispozicion këto makineri, pajisje e mjete pune;

Vendosja e kërkesës për disponimin e mjete/makineri të mësipërme, mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurorët, punimet konkrete që do të realizohen dhe volumet e tyre nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimi rregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

OE konkurues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore, mund t’i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (Inerte dhe betone etj.), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të shtetit shqiptar. Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore”.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuarateksituata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi Ing. A. M., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, që ka hartuar kriteret teknike të vlerësimit.

**Ndikimi:** Kufizimii pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurim të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikimet teknike; të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me e gërmën “c”, “ç”, d”, të pikës 2, neni 1; gërmën “a”, “b”, “c” të nenit 2; neni 20; neni 23, neni 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e kriterit mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. A. K., z. F. K. e z. M. N. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit: z. F. K., z. M. N. e z. A.

*K. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 119/8 prot., datë 06.04.2023, për Akt Konstatimin nr. 22, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

### **- Zhvillimi i procedurës.**

Më datë 30.09.2019, Procesverbali nr. 2, (pa numër protokolli) për hapjes së procedurës së prokurimit, ku është konstatuar që në këtë procedurë kanë marrë pjesë 11 (njëmbëdhjetë) OE/BOE.

Më datë 30.09.2019, Procesverbali nr. 3, (pa numër protokolli) i hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertave ekonomike.

Më datë 24.09.2019, Procesverbali nr. 4, (pa numër protokolli) mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave të prokurimit të sipërcituar.

**Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 11 (njëmbëdhjetë) OE/BO ofertues me vlerat ekonomike përkatëse të ofruara:**

1. OE “S.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

2. OE “S.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

3. OE “A. C.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

4. OE “B..” Shpk, me vlerë ekonomike, sipas formularit të oferteës **245,930,810** (dyqind e dyzetë e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e dhjetë) **lekë pa Tvsh.**

5. OE “S.” Shpk, me vlerë ekonomike, sipas formularit të ofertës **337,191,647** (treqind e tridhjetë e shtatë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) **lekë pa Tvsh.**

6. BOE “L.” Shpk & “Sh. I.” Shpk & “B...” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **359,215,072** (treqind e pesëdhjetë e nëntë milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa Tvsh.**

7. OE “A. K.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **380,605,941** (treqind e tetëdhjetë milion e gjashtëqind e pesë mijë e nëntëqind e dyzetë e një) **lekë pa Tvsh.**

8. BOE “A. S.” Shpk & “Gj.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **398,380,000** (treqind e nëntëdhjetë e tetë milion e treqind e tetëdhjetë mijë) **lekë pa Tvsh.**

9. OE “G.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **400,089,765** (katërqind milion e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) **lekë pa Tvsh.**

10. OE “A. I. G. C.” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **420,591,187** (katërqind e njëzetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) **lekë pa Tvsh.**

11. OE “2...” Shpk, me vlerë ekonomike sipas formularit të ofertës **444,056,344** (katërqind e dyzetë e katër milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzetë e katër) **lekë pa Tvsh.**

- **Ankesa me nr. 2948 prot.**, datë 31.10.2019 OE “2...” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr.2948/4 prot, datë 06.11.2019.

- **Ankesa me nr.2907 prot.**, datë 29.10.2019 OE “S.” Shpk, ka marrëpërgjigje me shkresën nr.2907/5 prot., datë 04.11.2019.

- **Ankesa me nr.2930 prot.**, datë 30.10.2019, e BOE “L.” Shpk & “Sh. I.” Shpk & “B..” Shpk ka marrë përgjigje me shkresën nr.2930/4 prot., datë 05.11.2019.

Për këtë procedurë ka dalë Vendim të KPP-së me nr. 100/2020, datë 05.03.2020, në Bashkinë Patos **me nr. 736 prot., datë 09.03.2020**, kunë pikat 1 dhe 2 të saj është vendosur të mos pranohen dy ankesat paraqitura nga: BOE “L.” Shpk & “Sh. I.” Shpk & “B...” Shpk & “S.” Shpk, dhe në pikën 3 të vendimit AK lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur është njoftuar OE “2....” Shpk me vlerë ekonomike të ofertës **444,056,344** (katërqind e dyzetë e katër milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzetë e katër) **lekë pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Më datë 10.03.2020, u ngarkua njoftim fituesi ne SPE, u bë publikimi më datë 11.03.2020. Njoftimi i Klasifikimit ishte bërë në datë 08.11.2019.

Më datë 18.03.2020, KVO zhvilloi rivlerësim të procedurës për shkak të një gabimi aritmetik në ofertën ekonomike të OE “2...” Shpk, pasi i dërgoi kërkesë OE “2....” Shpk, i cili ra dakort me gabimet aritmetike të ofertës duke pranuar vlerën e re.

**Raporti përmbledhës** me nr. 2214/15 prot., datë 26.03.2020, miratuar nga i titullarit të AK znj. R. B.. Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr. 2214/16 prot., datë 26.03.2020.

Kontrata me OE “2...” Shpk, fitues nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **532,867,612.80** (pesë qind e tridhjetë e dy milionë e tetëqindë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqindë e dymbëdhjetë pikë tetë) **lekë me Tvsh.**

**Lidhur me OE “2...” Shpk**, rezulton se OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

**Konkluzioni:** Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetar i Bashkisë Patos në cilësinë e titullarit të AK, **z. A. K., z. F. K. e z. M. N. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

### 3. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”, Bashkia Patos.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”, Bashkia Patos, viti 2019.		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr. 26, datë 19.09.2019.	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhërinr. 2484 prot., datë 19.09.2019.	<b>3. Komisioni Vlerësimi Ofertave-</b> Urdhri nr. 2484/2 prot., datë 23.09.2019.
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”	1. D. K. (Jurist) 2. A. K. (Inxh. Ndërtimi ) 3. F. K. (Ekonomist)	1. K. A. Kryetar (Financier) 2. I. Sh. Anëtar (Arkitekte) 3. M. M. Anëtar (Jurist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 8,042,742 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk me fond limit 7,397,540 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,999,660 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 21.10.2019	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë Patos	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> <b>OE të Kualifikuar</b> -BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk <b>OE të s’kualifikuar</b> - BOE “6.....” Shpk & “Sh.” Shpk - OE “Sh.” Shpk - OE “S.” Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b>	<b>12. Përgjigjeankesës nga AK,</b> - Ankesa ka marr përgjigje me shkresën nr. 3005/5 prot., datë 11.11.2019, BOE “6...” Shpk & “Sh.” Shpk	<b>13. PërgjigjeAnkesës nga APP apo KPP.</b> <b>Nuk ka</b>
b. Kontrata nr. prot., datë 02.12.2019		
<b>14. Lidhja e kontratës 02.12.2019</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>8,877,048 lekë</b>

Me VKM nr. 81, datë 20.12.2018, është miratuar buxheti për vitin 2019, ku pjesë e saj është parashikuar si kategori edhe shpenzimi në vlerën 12,264,000 lekë për objektin: “Rrugë lidhëse ndërmjet rrugës Gani Banaj dhe rrugës Çamëria”.

Nga grupi i punës i përbërë nga ing. z. A. K., ing. znj. S. T., ing. z. P. G. dhe arkitekt z. R. B. është hartuar projekti për objektin: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”. Projekti është përcjellë me shkresën nr. 2297 prot., datë 29.08.2019, pranë NjP dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Kontrollit të Zhvillimit.

Më datë 19.09.2019, NjP e përbërë nga znj. D. K., z. A. K. dhe z. F. K. ka mbajtur procesverbalin me objekt “Mbi rillogaritjen e fondit limit për procedurën “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”.

Me Urdhrin nr. 26, datë 19.09.2019, Titullare e AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”.

Në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 2, ku përcaktohet se: “Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publik dhe në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla”, znj. R. B. me shkresën nr. 2434/4 prot., datë 23.09.2019, ka kryer njoftimin e kontratës për procedurën e prokurimit për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria” publikuar në SPE.

**22. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me përzgjedhjen e operatorëve ekonomik që është dërguar ftesë për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

**Situata:** Referuar procedurës së aplikuar konkretisht “Kërkesë për propozim”, Bashkia Patos është drejtuar pesë operatorëve ekonomikë me ftesës sipas shkresës nr. 2484/5 prot., datë 24.09.2019, OE si më poshtë:

- OE “E. K.” Shpk;
- OE “Sh.” Shpk;
- OE “S.” Shpk;
- OE “H.” Shpk;
- OE “I. D.” Shpk;

**Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 1 dhe pika 4.

**Shkaku:** NjP nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë në zhvillimin e kësaj procedure, veprim që nuk është në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe ngarkon me përgjegjësi: znj. R. B. Titullare e Autoritetit Kontraktor dhe znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

**Ndikimi:** Në procedurën e prokurimit: “Kërkesë për propozim”, autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar kuadrin ligjor në argumentimin dhe nuk dokumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që u ka dërguar ftesë për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK në hartimin në procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”, duhet të të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë për pjesëmarrje.

### **Hartimi i kritereve të DT:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 26, datë 19.09.2019, të titullarit të AK, me shkresën nr. 2481/1 prot., datë 20.09.2019, ing. A. K. ka hartuar kriteret e vlerësimit të cilat janë dërguar pranë NjP.

Me shkresën nr. 2484/3 prot., datë 23.09.2019, nga NjP është hartuar procesverbali nr. 1, me objekt: “Mbi diskutimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit” në të cilën janë miratuar dokumentet e tenderit.

### **Ndryshime në DT (shtojca):**

- Me shkresën nr. 2583 prot., datë 30.09.2019, nga OE “A.” Shpk, është paraqitur pranë Bashkisë Patos formulari i ankesës në lidhje kriteret e vendosura në DT. Me shkresën nr. 2583/1 prot., datë 01.10.2019, Kryetare e Bashkisë deri në momentin e trajtimit të ankesës ka pezulluar procedurën e prokurimit. Me shkresën nr. 2583/2 prot., datë 01.10.2019, është ngritur KSHA i përbërë nga z. V. N., znj. S. T. dhe znj. I. T.. Me shkresën nr. 2583/3 prot., datë 03.10.2019, KSHA ka marrë vendimin se ankesa e OE “A.” Shpk, nuk do të pranohet. Vendimin nr. 2583/4 prot., datë 03.10.2019, i Titullari të AK, ankesa e OE “A.” Shpk, nuk është pranuar. Me shkresën nr. 2583/5 prot., datë 03.10.2019, i është kthyer përgjigje OE “A.” Shpk, në lidhje me trajtimin dhe mos pranimin e ankesës.

- Më datë 01.10.2019, nga APP i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Patos, rezulton se: për procedurën e me REF-36713-09-23-2019, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Çamëria”, Bashkia Patos me fond limit 8,042,742 lekë pa Tvsh, ka sygjerruar disa kriteret e DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Me shkresën nr. 2484/6 prot., datë 15.10.2019, Njësia e Prokurimit ka hartuar shtojcë në DT.

**23. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:**

**1. Në Pikën 2.3.3.1 të Kapacitetit Teknik,** në lidhje me liçencat, **të DT është kërkuar:** “Liçencat profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, referuar preventivit të punimeve si dhe llojit të punimeve të parashikuara në të duhet të ketë këto pika në liçensën profesionale: ...NP-12 A...”.

**2. Në Pikën 2.3.3.6, të Kapacitetit Teknik,** në lidhje me drejtuesit teknik, **në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë ing. si më poshtë:

- **Inxhinier gjeolog** 1 (një)
- **Inxhinier mjedisi** 1 (një)

Të gjithë ing. e kërkuar më sipër të jenë të shoqëruar me CV, diplomë, librezë pune dhe kontratë noteriale pune me kusht që kontratat të jenë me afat vlefshmëriebrandaafatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë pjesëmarrëse në këtë prokurim, se inxhinierët e mësipërm janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

**3. Në Pikën 2.3.3.6, të Kapacitetit Teknik,** në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek ndërmarrjeje të punësuar, në bazë të paragrafit 12/2 te VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003”.

Kjo pikë do të vërtetohet me paraqitjen e : a) Licencës, b) Kontratës së punës c) Diplomën e mjekut si dhe të jetë i regjistruar në listpagesa për periudhën Mars 2019-Gusht 2019.

(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve pika “c” duhet të plotësohet nga secili operator në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Në rast se operatori ka më shume se 15 puntorë të siguruar)

**4. Në Pikën 2.3.3. 11/7 të Kapacitetit Teknik,** në DT është kërkuar: “Mbështetur në: Ligj nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta, ndryshuar me Ligjin nr 10137, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Kreu II Neni 9 Detyrime të krijuesit të mbetjeve

Neni 12 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën III.2.B Grumbullim dhe transportim i mbetjeve”.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitete juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK Bashkia Patos, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që. në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Për sa trajtuar më sipër,** kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të

caktuar. Vlen të theksohet se për kushtet e përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim konkretisht a) liçencën N.P.12: Punime të inxhinierisë mjedisore, b) Inxhinier gjeolog dhe c) Inxhinier mjedisi janë dhënë rekomandimet përkatëse nga APP-ja sipas email-it të sipërpërmendur por nga Bashkia Patos nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tyre.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. K., z. F. K.***

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit: **Znj. D. K., z. F. K. e z. A. K. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 119/8 prot., datë 06.04.2023, për Akt Konstatimin nr. 10, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.***

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Me shkresën nr. 2484/2 prot., datë 23.09.2019, të titullarit të AK znj. R. B. është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. K. A. kryetar me detyrë Nënkyetar i Bashkisë (Financier) si dhe anëtarët znj. I. Sh. dhe znj. M. M..

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë për të cilët referuar procesverbalit nr. 4, datë 21.10.2019, KVO-ja i përbërë nga z. K. A. kryetar dhe anëtarët znj. I. Sh., znj. M. M. ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

**1. BOE “6...” Shpk & “Sh.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 5,000,000 lekë pa Tvsh.**

**2. OE “Sh.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 6,188,605 lekë pa Tvsh.**

**3. BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 6,188,605 lekë pa Tvsh.**

**4. OE “S.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 7,639,205 lekë pa Tvsh.**

Me shkresën nr. 2484/8 prot., datë 22.11.2019, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilën e titullarit të autoritetit kontraktor. Me shkresën nr. 2484/9 prot., datë 26.11.2019, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk.

Me procesverbalin nr. 2434/11 prot., datë 02.12.2019, KVO ka shqyrtuar dokumentacionin origjinal të BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk.

**Lidhja e kontratës:** Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 2484/12 prot., datë 02.11.2019, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Patos, të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë znj. R. B. dhe BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”, Bashkia Patos, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specififikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **8,877,048 (tetë milionë e tetëqindë e shtatëdhjetë mijë e dyzetë e tetë) lekë me Tvsh.**

**Lidhur me BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk të shpallur fitues**, rezulton se ky BOE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK

**24. Titulli i gjetjes:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kakualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk. KVO duhet të kishte skualifikuar BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK, anulimin e procedurës së prokurimit pasi asnjë prej OE pjesëmarrës në prokurim nuk plotësonin kushtet e DT. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese. Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**1. Për pikën 2.2.2.1.** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2019, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKR. *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-së).*

**a)** OE “Sh.” Shpk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrime për taksat dhe tarifave vendore me shkresën nr. 2066 prot., datë 19.04.2019, vërtetim i lëshuar nga Bashkia Vau i Dejës. Në këtë shkresë citohet se, OE “Sh.” Shpk ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Vau i Dejës deri më datë 19.04.2019”. Ky vërtetim nuk i referohet shlyerjes së detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2019, por deri më datë 19.04.2019, në kushte të tilla vërtetimi i cili duhej të paraqitej nga OE “Sh.” Shpk, duhet të ishte i muajit shtator të vitit 2019.

Nga OE “Sh.” Shpk nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Durrës dhe Fushë-Arrëz referuar likudimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Durrës dhe Pukë ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete referuar kontratave si më poshtë:

-Kontrata me nr. 756 prot., datë 18.07.2019, me objekt: “Rikonstruksion godine” institucioni Gjykata e Apelit Durrës. Fatura me nr. 4906, datë 20.09.2019, në vlerën 1,692,848 lekë regjistruar më datë 27.09.2019, dhe likuiduar më datë 30.09.2019, nga Dega e Thesarit Durrës.

-Kontrata me nr. 756 prot., datë 18.07.2019, me objekt: “Rikonstruksion godine” institucioni Gjykata e Apelit Durrës. Fatura nr. 3761, datë 31.07.2019, në vlerën 1,578,948 lekë regjistruar më datë 01.08.2019, dhe likuiduar më datë 02.08.2019, nga Dega e Thesarit Durrës.

-Kontrata me nr. 50 prot., datë 10.01.2019, me objekt: “Rikonstruksion i plotë rrjeti” institucioni Bashkia Fushë-Arrëz. Fatura nr. 7986, datë 27.06.2019, në vlerën 947,425 lekë regjistruar më datë 18.07.2019, dhe likuiduar më datë 19.07.2019, nga Dega e Thesarit Pukë.

**b)** Nga OE “H.” Shpk nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Gjirokastrë dhe Divjakë referuar likudimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Gjirokastrës dhe Lushnje ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete referuar kontratave si më poshtë:

-Kontrata me nr. 1452/1 prot., datë 03.06.2019, me objekt: “Rikonstruksion godine” institucioni Dogana Gjirokastrë. Fatura nr. 42, me numër serie 21395042, datë 02.10.2019, në vlerën 4,975,798 lekë regjistruar më datë 24.10.2019, dhe likuiduar më datë 25.10.2019, nga Dega e Thesarit Gjirokastrë.

-Kontrata me nr. 1452/1 prot., datë 03.06.2019, me objekt: “Rikonstruksion godine” institucioni Dogana Gjirokastrë. Fatura nr. 35, me numër serie 21395035, datë 11.07.2019, në vlerën 3,650,500 lekë regjistruar më datë 17.07.2019, dhe likuiduar më datë 18.07.2019, nga Dega e Thesarit Gjirokastrë.

-“Kasa kolektorësh” institucioni “Ujësjetllës Kanalizime Divjakë” Sh.a. Fatura nr. 21395028, datë 22.05.2019, në vlerën 142,272 lekë regjistruar më datë 26.08.2019, dhe likuiduar më datë 30.08.2019, nga Dega e Thesarit Lushnje.



**2. Për pikën 2.2.2.3.** Kopje të certifikuar të bilancit të viteve 2016, 2017 dhe 2018, të paraqitura në autoritetin përkatës Drejtoria e Tatimeve, të konfirmuara nga ky autoritet.

-Bilancet e paraqitura nga OE "H." Shpk, për vitet 2016, 2017 dhe 2018 janë depozituar pranë DRT Fier në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por nuk është marrë konfirmi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.

Sa më sipër, BOE "H." Shpk & "Sh." Shpk, nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT dhe referuar përcaktimeve të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "H." Shpk & "Sh." Shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr. 1, gërma "ç", neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 si dhe kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 2 "Qëllimi i ligjit".

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. K. A., znj. I. Sh., znj. M. M..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **7,397,540 lekë pa Tvsh**.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE "H." Shpk & "Sh." Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **7,397,540 lekë pa Tvsh**.

**Konkluzioni:** Referuar sa më sipër, kualifikimi i BOE "H." Shpk & "Sh." Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: z. K. A., në cilësinë e kryetarit të KVO, znj. I. Sh. dhe znj. M. M. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. R. B..

Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, është kualifikuar BOE "H." Shpk & "Sh." Shpk, në kushtet kur duhej anuluar dhe AK të zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **7,397,540lekë pa Tvsh**, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK, anëtarët e NJHDT dhe KVO.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetare e Bashkisë Patos në cilësinë e titullarit të AK, znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit. dhe z. K. A., znj. I. Sh., znj. M. M. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave :Z. K. A. e znj. I. Sh. anëtarët me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/25.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimin nr. 10, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

**b.** Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2020, deri më 31.12.2020**, paraqiten si më poshtë:

**4.** Procedura e prokurimit me objekt: **"Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II"**.

**a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: **"Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II", Bashkia Patos, viti 2020.**

<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> Nr. 9, datë 06.08.2020	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> nr.1851 prot datë 06.08.2020	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr.1851/2 prot., datë 07.08.2020:
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	1. D. K. (Jurist) 2. A. L. (Ing. Ndërtimi) 3. M. N. (Financier)	1. A. P. (Kryetar) 2. Sh. B. (Anëtar) 3. K. A. (Anëtar) 4. V. N. (Anëtar) 5. E. R. (Anëtar)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 608,941,395 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “A. C.” Shpk & “L.” Shpk, vlera e ofertës 596,422,235 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit:</b> 12,519,160.06 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 16.09.2020	<b>9. Burimi Financimit:</b> AKUM	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE “A. C.” Shpk & “L.” Shpk. 2. OE “G....” Shpk
<b>11. Ankimime AK:</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK: 1</b>	<b>13. Përgjigje ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 1851/11 prot., datë 11.12.2020</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 11.12.2020</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>705,415,837.32 lekë</b>

Burimi i Financimit: vënë në dispozicion nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë-Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve sipas Vendimit nr. 42, datë 28.10.2019, të Këshillit Teknik të AKUM-it, për objektin: “Rikonstruksioni i Magjstralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.

Prokurimi i këtij objekti do të bëhet me vlerë të plotë por periudha e financimit do të jetë nga viti 2020-2023, sipas miratimit të planit të buxhetit për shpenzimet kapitale me shkresën me nr.4473/1 prot., datë 30.06.2020, sipas kualifikimit: Për vitin **2020** financimi do të jetë me vlerë **144,095,000 (njëqind e dyzetë e katër milion e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë me Tvsh;** për vitin **2021** financimi do të jetë në vlerën **100,000,000 (njëqin dmlion) lekë me Tvsh;** për vitin **2022** financimi do të jetë në vlerën **40,000,000 (dyzetë milion) lekë me Tvsh,** kurse pjesa tjetër për vitin **2023.**

- Me Urdhër e prokurimit me nr. 9, me shkresën nr. 1851 prot., datë 06.08.2020, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe NJHDT: znj. D. K., z. A. L. (Përgjegjës i Drejtorisë së Shërbimeve Publike) e z. M. N. (Specialist Prokurimi/Jurist).

- Urdhri i Titullarit të AK për ngritje e KVO me nr. 1851/2 prot., datë 07.08.2020, ku KVO përbëhet nga: znj. A. P. (Kryetare); z. Sh. B., z. K. A.; z. V. N. e znj. E. R..

**Hartimi fondit limit:** Projekt zbatimi, grafiku i punimeve, projekt preventive dhe përlogaritja e fondit limit është realizuar, nga BOE “I.” Shpk & “A.” Shpk.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Me nr. 1851/1 prot., datë 06.08.2020, kriteret e vlerësimit, formuluar/nënshkruar nga ing. A. L..

Procesverbali nr. 1, mbi diskutimin dhe miratimin e Dokumenteve të Tenderit me nr. 1851/3 prot., datë 07.08.2020, formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP. Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DT. Me nr. 1851/4 prot., datë 10.08.2020, Njoftimi i shkurtuar i kontratës.

Deklarata e mospasjes së konfliktit të interesit më datë 07.08.2020, (pa numër protokoll) nga anëtarët e KVO-së.

#### **Ndryshimet në DT:**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 20.08.2020, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Rikonstruksioni i Magjstralit Kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”, Bashkia Patos me fond limit **608,941,395 lekë pa Tvsh,** autoritetit kontraktor Bashkia Patos.

Me nr. 1851/6 prot., datë 01.09.2020, NJP ka kërkuar pezullimin nga Titullari i AK (Administratori i SPE), pasi janë hartuar një Shtojcë për DT, në zbatim të Manualit nr. 2, datë 06.02.2018, “Për rolin e Administratorit”, NJP dhe KVO.

**25. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT nuk ka formuluar Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në

përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:**

**1. Në pikën 2.1 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin e mëposhtëm;

**a. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si drejtues teknik stafin inxhinierik të mëposhtëm:**

Inxhinier Ndërtimi	2 (dy)
Inxhinier Hidroteknik	2 (dy)
Inxhinier Gjeolog	2 (dy)
Inxhinier Mekanik	2 (dy)
Inxhinjer Elektrik	1 (një)
Inxhinier Gjeodet	2 (dy)
Inxhinier Gjeoteknik	1 (një)

Secili prej pjesëtarëve të stafit teknik të mësipërm duhet jetë ne listëpagesa për periudhën (Janar 2020-Qershor 2020), dhe në licensën e shoqërisë.

Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- **Kontratë noteriale pune**

- Diploma

- CV

**b. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin teknik për periudhën Janar 2020- Qershor 2020 stafin si më poshtë:**

Inxhinier Ndërtimi	2 (dy)
<b>Inxhinier Ndërtimi profili transport</b>	1 (një)
Inxhinier Elektrik	1 (një)
<b>Inxhinjer Mjedisi</b>	1 (një)
Inxhinier Gjeolog	1 (një)
Inxhinier Mekanik	1 (një)
Inxhinier Gjeodet	1 (një)

Për secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- **Kontratë noteriale pune**

- Diploma

- CV

Punonjësit e kërkuar në pikën 2.1/a dhe b duhenplotësuar në mënyrë kumulative.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, për punonjësit e kërkuar, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”.

**2. Në pikën 2.1.d. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik duhet të ketë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Janar 2020-Qershor 2020) si pjesë e stafit teknik 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë: “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq, shoqëri të akredituara ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

**3. Në pikën 2.1.e. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik duhet të ketë në staf 1 (një) punonjës që disponon certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**4. Në pikën 3 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik duhet të jetë e pajisur me licencat e lëshuara nga QKB si me poshtë:

a. Licencë për grumbullim, transportim dhe riciklimin e mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje inerte), kodi III.2.B”

**5. Në pikën 4 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'ivihen në

dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën. Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushurkontratën.

d. Për fabrikën e asfaltit, impiantin e betonit dhe nyjen inerte nëse janë në pronësi duhet te paraqiten kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore e lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qerasë. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit dhe betonit mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën noteriale të furnizimit leja mjedisore e lëshuar nga QKL.

**6. Në pikën 5 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme:**

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente (e vlefshme)
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor)ose ekuivalente (e vlefshme)
- OHSAS 18001-2007/2013 ose ISO 45001-2018 (Sistemi i menaxhimit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente (e vlefshme).
- ISO 39001-2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugore) ose ekuivalente (e vlefshme)
- ISO PAS 99:2012 (Për sistemin e integruar të menaxhimit) ose ekuivalente (e vlefshme)
- ISO 3834-2:2006 (Kërkesat e cilësisë për saldime me shkrirje të materialeve metalike) ose ekuivalente (e vlefshme)
- ISO 50001: 2011 (Për sistemin e menaxhimit të energjisë) ose ekuivalente (e vlefshme)

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë dhe ngarkojnë me përgjegjësi Ing. A. M., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, që ka hartuar kriteret teknike të vlerësimit.

**Ndikimi:** Kufizimii pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikimet teknike, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e kriteri mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, sa më sipër **ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga Znj. D. K., z. A. L. z. M. N. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e Njësisë së Prokurimi: **Znj. D. K., z. M. N. e z. A. L. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/25.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimin nr. 23, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.**

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

**- Zhvillimi i procedurës.**

Më datë 16.09.2020, Procesverbali nr. 2, (pa numër protokolli) për hapjes së procedurës së prokurimit, ku është konstatuar që në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 (dy) OE/BOE.

Më datë 16.09.2020, Procesverbali nr. 3, (pa numër protokolli) i hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertave ekonomike.

Formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interesit, me datë 16.09.2020, formuluar/nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Më datë 09.10.2020, Procesverbali nr. 4, (pa numër protokolli) mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave të prokurimit të sipërcituar, bashkangjitur KVO ka deklaruar se është mbyllur vlerësimin dhe informon NJP për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës

**Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “A. C.” Shpk & “L.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **596,422,234.94** (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëzetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e katër) **lekë pa Tvsh.**

**1. OE “G. C.” Shpk**, ofron vlerën sipas formularit të ofertës **608,118,178.04** (gjashtëqind e tetë milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë zero katër) **lekë pa Tvsh.**

**Njësia e Prokurimit i ka formuluar/nënshkruar kur është hapur procedura.**

Raporti përmbledhës me nr. 1851/7 prot., datë 19.10.2020, miratuar nga Titullarit i AK.

Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr. 1851/1 prot., datë 19.10.2020.

Është informuar **BOE “A. C.” Shpk & “L.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **596,422,234.94** (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëzetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e katër pike nëntëdhjetë e katër) **lekë pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Ky Akt-Konstatim, mbahet në 2 (dy) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i lihet institucionit dhe 1 (një) kopje merret nga përfaqësuesit e autorizuar të KLSH-së.

Kontrata me OE fitues nr. **1851/11 prot., datë 11.12.2020**, vlera totale përfundimtare e kontratës: **705,415,837.32** (shtatëqind e pesë milion e katërqindë e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqindë e tridhjetë e shtatë pikë tridhjetë e dy) **lekë me Tvsh.**

**Lidhur me BOE “A. C.” Shpk & “L.” Shpk**, të shpallur fitues, rezulton se OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

**Konkluzioni:** Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetar i Bashkisë Patos në cilësinë e titullarit të AK, znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

**5. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas”,**

<b>a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas”, Bashkia Patos, viti 2020.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> 15, datë 09.10.2020.	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 2345/5 prot., datë 19.12.2020. 1. D. K. (Jurist) 2. A. M. (Inxh Ndërtimi) 3. M. N. (Jurist)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 2484/2 prot., datë 23.09.2019. 1. Sh. B. Kryetar (Jurist) 2. A. P. Anëtar (Arkitekt) 3. E. R. Anëtar (Arkitekt)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Tender i hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 12,160,227.50 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk me fond limit 8,956,609 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit:</b> 3,203,618.50 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 19.01.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë Patos	<b>10. Operatorët Ekonomikë OE të Kualifikuar</b>

		-BOE "H." & "Sh." <b>OE të s'kualifikuar</b> BOE "A." & "2...." -OE "E..." Shpk -OE "K...." Shpk -OE "Sh." Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA Nuk Ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje ankesës nga APP apo KPP. Nuk Ka</b>
<b>b. Kontrata nr. prot., datë 10.03.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 10.03.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>10,747,930.80 lekë</b>

#### **Hartimi i kritereve të DT:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 15, datë 09.12.2020, të titullarit të AK, me shkresën nr. 2345/7 prot., datë 09.12.2020, ing. A. M. ka hartuar kriteret e vlerësimit të cilat janë dërguar pranë NjP dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë.

Me shkresën nr. 2345/8 prot., datë 10.12.2020, nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali nr. 1, me objekt "Mbi diskutimin dhe miratimin e DT".

#### **Ndryshime në DT (shtojca):**

Me shkresën nr. 3134 prot., datë 17.12.2020, nga OE "2...." Shpk është paraqitur pranë Bashkisë Patos dhe për dijeni të APP formulari i ankesës në lidhje kriteret e vendosura në DT. Me shkresën nr. 3143/1 prot., datë 18.12.2020, znj. R. B. Kryetar i Bashkisë deri në momentin e trajtimit të ankesës ka pezulluar procedurën e prokurimit. Me shkresën nr. 3134/2 prot., datë 18.12.2020, Titullari i AK ka ngritur KSHA të përbërë nga z. Sh.B., znj. A. P. dhe znj. E. R.. Me shkresën nr. 3143/3 prot., datë 21.12.2020, KSHA ka marrë vendimin që ankesa e OE "2...." Shpk ku në disa prej çështjeve të ngritura nga OE janë marrë në konsideratë pjesërisht. Me Vendimin sipas shkresës nr. 3143/4 prot., datë 21.12.2020, të Titullarit të AK është vendosur të pranohet pjesërisht ankesën e OE "2...." Shpk. Me shkresën nr. 3143/5 prot., datë 21.12.2020, Bashkia Patos i ka kthyer përgjigje OE "2...." Shpk.

-Më datë 29.12.2020, nga asistenca që APP i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Patos, rezulton se: për procedurën e me REF-81871-12-11-2020, me objekt: "Rikonstruktion i rrugës së varrezave, Dukas", Bashkia Patos me fond limit 12,160,227.50 lekë pa Tvsh, ka sygjerruar disa kriteret e DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Me shkresën nr. 2345/10 prot., datë 07.01.2021, Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. D. K., z. A. M. dhe z. M. N. kanë hartuar shtojcë në dokumentet e tenderit.

**26. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

#### **Situata:**

##### **1. Në Pikën 3.2. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:**

- Skrep copë 2 (dy)
- Rimorkiator copë 1 (një)
- Matrapik copë 4 (katër)
- Tokmak për ngjeshje dheu copë 4 (katër)
- Kontinier stacioner copë 1 (një)
- Depozitë për grumbullim materiale copë 1 (një)
- Kontinierstacioner copë 1 (një)
- Depozitë për grumbullim materiale copë 1 (një)

**2. Në Pikën 3.8. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** "Mbështetur në: Ligj nr. 9010, datë 13.02.2003, "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta, Ndryshuar me ligjin nr 10137, datë

11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

Kreu II Neni 9 Detyrime të krijuesit të mbetjeve

Neni 12 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën III.2.B Grumbullim dhe transportim i mbetjeve”.

**3. Në Pikën 3.8. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Shoqëria duhet të jetë e pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme:

a. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë certifikatë **ISO 9001-2015 – Standard për sistemin e menaxhimit të cilësisë (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO).

b. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë certifikatë **ISO 14001 - 2004 - Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

c. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë certificate **OHSAS 18001-2007 ose ekuivalenten e saj ISO 45001-2018 Standart për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë nëpunë (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën OHSAS/ISO).

d. Certifikatë **ISO 99-2012-Sistemi i menaxhimit të integruar (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën OHSAS/ISO).

e. Certifikatë **ISO 28001:2007-Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën OHSAS/ISO).

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure dhe ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. K., z. A. M., z. M. N. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK Bashkia Patos, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që. në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhurangushtë me aftësinëzbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. M., z. M. N. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika “1”, “3”, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. M., z. M. N. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimiti dhe titullari i AK, znj. R. B., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e Njesisë së Prokurimi: **Znj. D. K., z. M. N. e z. A. M. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/13.1**

*prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimin nr. 11, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

#### **Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:**

Me shkresën nr. 2345/6 prot., datë 09.12.2020, të titullarit të AK znj. R. B. është ngritur KVO i përbërë nga z. Sh. B. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm (jurist) dhe anëtarët znj. A. P. me detyrë Nënkryetare e Bashkisë (arkitekte), znj. E. R. me detyrë Specialiste Urbanistike (arkitekte).

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik për të cilët referuar procesverbalit nr. 4, të datës 16.02.2021, KVO-ja i përbërë nga z. Sh. B. kryetar dhe anëtarët znj. A. P., znj. E. R. ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

- 1. BOE “A.” Shpk & “2...” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 11,092,348 lekë pa Tvsh.**
- 2. OE “E. K.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 10,018,800 lekë pa Tvsh.**
- 3. BOE “H.” Shpk & “Shpresa-AI” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 8,956,609 lekë pa Tvsh.**
- 4. OE “K....” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 9,522, 386 lekë pa Tvsh.**
- 5. OE “Sh.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 8,955,667 lekë pa Tvsh.**

Me shkresën nr. 2345/13 prot., datë 24.02.2021, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilën e titullarit të autoritetit kontraktor. Me shkresën nr. 2345/14 prot., datë 24.02.2021, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e BOE “H.” Shpk Fier & “Sh.” Shpk.

**27. Titulli i gjetjes:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

#### **Situata:**

**1. Për pikën 2.1.** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2020. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-së).

a) OE “Sh.” Shpk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore me shkresën nr. 4850 prot., datë 25.08.2020, vërtetim i lëshuar nga Bashkia Vau i Dejës. Në këtë shkresë citohet se, “OE “Sh.” Shpk, ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Vau i Dejës”. Në këtë dokument nuk përcaktohet se a janë likuiduar detyrimet e vitit 2020, në kushte të tilla vërtetimi i cili duhet të paraqitet nga OE “Sh.” duhet të ishte i muajit Dhjetor të vitit 2019.

Nga OE “Sh.” Shpk nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Përmet, Elbasan dhe Lezhë referuar likuidimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Përmet, Elbasan dhe Lezhë ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete referuar kontratave si më poshtë:

-Kontrata me nr. 725 prot., datë 17.03.2020, me objekt: “Karburant dhe vaj” institucioni Bashkia Përmet. Fatura nr. 14301, me numër serie 92385801 datë 02.11.2020, në vlerën 626,920 lekë regjistruar më datë 10.12.2020, dhe likuiduar më datë 14.12.2020, nga Dega e Thesarit Përmet.

-Kontrata me nr. 725 prot., datë 17.03.2020, me objekt: “Karburant dhe vaj” institucioni Ndërmarrja Pastrim Gjelbërim. Fatura nr. 14302, me numër serie 92385802, datë 02.11.2020, në vlerën 188,076 lekë regjistruar më datë 09.12.2020, dhe likuiduar më datë 11.12.2020, nga Dega e Thesarit Përmet.

-Kontrata me nr. 725 prot., datë 17.03.2020, me objekt: “Karburant dhe vaj” institucioni Ndërmarrja Pastrim Gjelbërim. Fatura nr. 372, me numër serie 81130372, datë 01.10.2020, në vlerën 184,824 lekë regjistruar më datë 26.11.2020, dhe likuiduar më datë 27.11.2020, nga Dega e Thesarit Përmet.

-Kontrata me nr. 725 prot., datë 17.03.2020, me objekt “Karburant dhe vaj” institucioni Ndërmarrja Pastrim Gjelbërim. Fatura nr. 37, me numër serie 81130371, datë 01.10.2020, në vlerën 508,266 lekë regjistruar më datë 29.10.2020, dhe likuiduar më datë 30.10.2020, nga Dega e Thesarit Përmet.



-Kontrata me nr. 725 prot., datë 17.03.2020, me objekt “Karburant dhe vaj” institucioni Ndërmarrja Pastrim Gjelbërim. Fatura nr. 347, me numër serie81130347, datë 01.09.2020, në vlerën 192,456 lekë regjistruar më datë 29.09.2020, dhe likuiduar më datë 30.09.2020, nga Dega e Thesarit Përmet.

-Kontrata me nr. 725 prot., datë 17.03.2020, me objekt: “Karburant dhe vaj” institucioni Bashkia Përmet. Fatura nr. 345, me numër serie81130346, datë 01.09.2020, në vlerën 689,634 lekë regjistruar më datë 28.09.2020, dhe likuiduar më datë 29.09.2020, nga Dega e Thesarit Përmet.

-Kontrata me nr. 725 prot., datë 17.03.2020, me objekt: “Karburant dhe vaj” institucioni Bashkia Përmet. Fatura nr. 2175, me numër serie81122175, datë 03.08.2020, në vlerën 689,634 lekë regjistruar më datë 28.09.2020, dhe likuiduar më datë 29.09.2020, nga Dega e Thesarit Përmet.

-Kontrata me nr. 10213/10 prot., datë 30.12.2019, me objekt: “Rivitalivim i lulishtes Kozma Naska” institucioni Bashkia Elbasan. Fatura nr. 306, datë 05.02.2020, në vlerën 4,000,000 lekë regjistruar më datë 14.07.2020, dhe likuiduar më datë 15.07.2020, nga Dega e Thesarit Elbasan.

-“Të tjera materiale dhe shërbimespeciale”, institucioni Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë. Fatura nr. 6167, datë 05.02.2020, në vlerën 36,600 lekë regjistruar më datë 18.02.2020, dhe likuiduar më datë 20.02.2020, nga Dega e Thesarit Lezhë.

**b) Nga OE “H.” Shpk, nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Sarandë dhe Divjakë referuar likuidimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Sarandë dhe Lushnje ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete referuar kontratave si më poshtë:**

-Kontrata me nr. 348 prot., datë 10.08.2020, me objekt: “Përmirësimi i ujërave të zeza Sarandë ITUN” institucioni “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Sarandë. Fatura nr. 571, datë 02.12.2020, në vlerën 11,392,750 lekë regjistruar më datë 29.12.2020, dhe likuiduar më datë 30.12.2020, nga Dega e Thesarit Sarandë.

-Kontrata me nr. 348 prot., datë 10.08.2020, me objekt: “Përmirësimi i ujërave të zeza Sarandë ITUN” institucioni “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Sarandë. Fatura nr. 568, datë 16.10.2020, në vlerën 3,310,115 lekë regjistruar më datë 19.10.2020, dhe likuiduar më datë 20.10.2020, nga Dega e Thesarit Sarandë.

-Kontrata me nr. 55 prot., datë 24.04.2020, me objekt: “Tuba e rekorderi ujësjellsi PE 250mm” institucioni “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Divjakë. Fatura nr. 568, datë 16.10.2020, në vlerën 1,658,244 lekë regjistruar më datë 13.07.2020, dhe likuiduar më datë 16.07.2020, nga Dega e Thesarit Lushnje.

**2. Për pikën 2.3.** Kopje të certifikuar të bilancit të viteve 2016, 2017 dhe 2018, të paraqitura në autoritetin përkatës Drejtoria e Tatimeve, të konfirmuara nga ky autoritet.

Pasqyrat financiare të paraqitura nga OE “H.” Shpk, për vitet 2016, 2017 dhe 2018 janë të depozituara pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por nuk është marrë konfirmi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.

BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, për realizimin e kontratës kanë lidhur aktmarëveshjen me nr. 74 rep., datë 13.01.2021, ku përcaktohet se preventivi do të realizohet 51% nga OE “H.” Shpk dhe 49% nga OE “Sh.” Shpk.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE të shpallurfitues janë konstatuar se 2 kritereve janë mbulluar nga një OE për realizimin e preventivit dhe jo sipas % të përcaktuar në aktmarëveshje, si më poshtë:

Nr.	Mjet/Pajisje sipas DT	Numri i kërkuar/copë në DT	Disponibiliteti nga OE “Harmonia” Shpk 51%	Disponibiliteti nga OE “Shpresa-AI” Shpk 49%
1	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës mbi/oso 15 ton	2	0	1. AA..... 2. AB.....
2	Auto-Betoniere	2	0	1. A..... 2. A.....

Për sa trajtuar më sipër BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK të shpalltefitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuarateksituata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO K. A., znj. I. Sh., znj. M. M..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **8,956,609 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallurfitues BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **8,956,609 lekë pa Tvsh**.

**Konkluzioni:**Referuar sa mësipër, kualifikimi i BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: z. Sh. B., në cilësinë e kryetarit të KVO, znj. A. P. dhe znj. E. R. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e AK znj. R. B..Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, është kualifikimi BOE “H.” Shpk & “Sh.” Shpk, në kushtet kur duhej anuluar dhe AK të zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **8,956,609 lekë pa Tvsh**, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK, anëtarët e NJHDT dhe KVO.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetare e Bashkisë Patos në cilësinë e titullarit të AK, znj. D. K., z. A. M., z. M. N. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit. dhe z. Sh. B., znj. A. P., znj. E. R. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Znj. A. P., Z. Sh. B. e znj. E znj. E. R. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/13.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimin nr. 11, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

c. Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2021, deri më 31.12.2021**, paraqiten si më poshtë:

**6. Procedura e prokurimit me objekt: “Sistemim i hapësirave, lagjja 29 Marsi, Bllokutezjarrëfiksja”.**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim i hapësirave, lagjja 29 Marsi, Blloku te zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, viti 2021.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr.13, datë 23.03.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 851 prot., date 23.03.2021	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> Nr.831/1 prot., datë 26.03.2021
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	1 D. K. (Jurist) 2. A. M. (Ing. Ndërtimi) 3. M. N. (Ekonomist)	1. A. P. (Kryetar) 2. Sh. B. 3. E. R.
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 49,795,880.70 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “M...” Shpk & “L. K.” Shpk, vlera e ofertës <b>40,828,749.25</b> lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit:</b> <b>10,322,176.70</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 05.05.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë	<b>10. OperatorëtEkonomikë</b> 1. BOE “A.” Shpk & “E. K.” Shpk 2. BOE “A. K.” Shpk & “S...” Shpk 3. BOE “C.” Shpk & “N.” Shpk 4. OE “E..” Shpk 5. BOE K. I.” Shpk & “A. C.” Shpk 6. OE “M.” Shpk 7. BOE “M...” Shpk & “L. K.” Shpk 8. OE “Sh.” Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b>	<b>12. Përgjigjeankesës nga AK,</b> - Kthim përgjigje BOE “A.” Shpk & “E. K.” Shpk Nr. 1440/3 prot., datë 14.06.2021 - Kthim përgjigje OE “E. A.” Shpk nr. 1439/5 prot., datë 14.06.2021 - Kthim përgjigje BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, nr. 1451/3 prot., datë	<b>13. PërgjigjeAnkesës nga APP apo KPP.</b> Vendim KPP i përbashkët për dy ankesat Nr.1129/2022 date 22.11.2022

	14.06.2021	
<b>b. Kontrata nr. 851/15 prot., datë 03.08.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 03.08.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>48,994,499.10</b>

#### **Hartimi i kriterëve të DT:**

Me procesverbalin nr.1, nr. 851/1 prot., datë 26.03.2021, nga Njësia e Prokurimit ka diskutuar/miratuat dokumentet e tenderit, dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”.

Me shkresën nr. 851/4 prot., datë 29.03.2021, Njoftimi i kontratës së shkurtuar.

#### **Ndryshimet në DT:**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 07.04.2021, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Sistemim i hapësirave, lagjja 29 Marsi, Blloku te zjarrëfiksj” dhe ndërtim i palestrës”, Bashkia .

Me nr. 851/5 prot., datë 23.05.2022, është formuluar nga Njësia e Prokurimit ka vendosur paraqitjen në SPE e Shtojcës në DT.

**28. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT nuk ka formuluar Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

#### **Situata:**

**1. Në pikën 2.3.1 të Kapacitetin Teknik, në DT** është kërkuar: “Licencat profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontrates, referuar preventivit të puimeve si:

*N.S-8: Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri “Kategoria A”*

**2. Në pikën 2.3.6. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Shoqëria duhet të ketë në stafin e saj drejtues (në licencën e shoqërisë):

- Inxhinier ndërtim il (një)

- Inxhinier elektrik 1 (një)

- Inxhinier hidroteknik 1(një)

- Topograf 1 (një)

- Arkitekt/arkitekt pejsazhi 1 (një)

-Inxhinier mjedisi 1 (një”

**2.1. Në pikën 3.6.1 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 6 të jenë të shoqëruar me diplomë, kontrata pune, CV.

**3. Në pikën 2.3.7. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punonjës që përmbush kriterin për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe shëndetit nëpunë dhe që të disponoj dëshmi trajnimit si “**Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë**” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet **certifikata e trajnimit për “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”** e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës si dhe duhet të jetë i përfshirë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Shtator2020 -Shkurt 2021**”.

**4. Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Mbështetur në: Ligj nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, ndryshuar me Ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

*Kreu II Neni 9 Detyrime të krijuesit të mbetjeve*

*Neni 12 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit*

*Neni 24/1*

*Neni 25 Lejet mjedisore*

*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B”.*

**4. Në pikën 2.4.1. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “*Certifikat ISO:*

**a. ISO 9001-2015-Standard për sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e BOE, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

**b. ISO 14001-2015 - Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ose ekuivalente (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmikombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e BOE, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

**c. ISO 45001-2018- Standart për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalente (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e BOE, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure dhe ngarkojnë me përgjegjësi Ing. A. M., në cilësinë e **anëtarit të NJHDT, që ka hartuar kriteret teknike të vlerësimit.**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertuesqë kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikimet teknike; të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinëzbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e kriteri mund të sjellëkufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, sa më sipër **ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga nga znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. M., z. M. N. si dhe titullari i AK, znj. R. B., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e Njësisë së Prokurimi: **Znj. D. K., z. M. N. e z. A. L. i me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/27.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 25, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.***

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali nr. 2, i KVO, datë 05.05.2021, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 8 (tetë) OE/BOE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

Procesverbali nr.3, i KVO, datë 05.05.2021, i hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike.

Procesverbali KVO, datë 01.06.2021, “Mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave” për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar të 8 OE.

### **Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “A.” Shpk & “E. K.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **38,950,690.76** (*tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë*) **lekë pa Tvsh.**

**2. BOE “A. K.” Shpk & “S.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **39,473,704** (*tridhjetë e nëntë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e katër*) **lekë pa Tvsh.**

**3. OE “C.” Shpk & “N.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës, **36,704,559** (*tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë*) **lekë pa Tvsh.**

**4. OE “E.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës, **43,453,980,05** (*dyzetë e tre milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë pikë zeropesë*) **lekë pa Tvsh.**

**5. BOE “K. I.” Shpk & “A. C.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës, **41,366,619** (*dyzetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**

**6. OE “M.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës, **48,693,005,20** (*dyzetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëpikënjëzetë*) **lekë pa Tvsh.**

**7. BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk**, (me NIPT-e respektive L..... e K.....) me vlerë ekonomike të ofertës, **40,828,749.25** (*dyzetë milion e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzetë e nëntë pikë njëzetë e pesë*) **lekë pa Tvsh.**

**8. OE “Sh.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës, **34,870,541** (*tridhjetë e katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e dyzetë e një*) **lekë pa Tvsh.**

- **Ankesa me nr. 1439 prot.**, datë 07.06.2021, e OE “A.” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 1439/5 prot., datë 14.06.2021.

- **Ankesa me nr. 1440 prot.**, datë 07.06.2021, e OE “E.” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 1440/5 prot., datë 14.06.2021.

- **Ankesa me nr. 1451 prot.**, datë 07.06.2021, e BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 1451/3 prot., datë 14.06.2021.

Me nr. 1439/1 prot., datë 07.06.2021, Urdhëri për pezullim e procedurës, dhe shqyrtimin e ankesave, nga Komisioni i shqyrtimit të ankesave (nr. 1439/2 prot., datë 07.06.2021) i përbërë nga: z. V. N., znj. J. B. e I. Sh.

Njoftim për hapjen e fazës së vlerësimit nr. 851/7 prot., datë 15.06.2021, nga z. M. N. (zyrtar i autorizuar) drejtuar KVO, për rivlerësimin e procedurës.

-Procesverbal nr. 4, datë 15.06.2021, nga KVO, ku oferta e BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk kualifikohet.

Në dosjen e prokurimit gjendet Raport Përmbledhës nr. 851/8 prot., datë 25.06.2021, dhe miratim procedurës nga Titullari i AK.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, është informuar BOE “M. I. G.” & “L. K.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës, **40,828,749.25** (*dyzetë milion e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzetë e nëntë pikë njëzetë e pesë*) **lekë pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Kontrata me BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, nr. 851/15 prot., datë 03.08.2021. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **48,994,499.10** (*tetëdhjetë e pesë milion e gjashtëqindë e njëzetë e tetë mijë e tetëqindë e tetëdhjetë e gjashtë*) **lekë me Tvsh.**

**29. Titulli i gjetjes:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

### **Situata:**

Me nr. 2006 rep., nr. 406 kol., datë 30.04.2021, kontrata e bashkëpunimit të përkohshëm ndërmjet OE “M. I. G.” Shpk dhe OE “L. K.” Shpk, ku punimet do të realizohen në raporte respektive 65 % dhe 35% ku mardhëniet nga dita e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e punimeve do të kryhen nga përfaqësues i OE “M. I. G.” Shpk, me administrator znj. P. K..

Me nr. 2007 rep., nr. 407 kol., datë 30.04.2021, Prokura e posaçme, ku emërohet përfaqësues i BOE “M. I. G.” Shpk, nga OE “L. K.” Shpk me administrator z. F. Sh..

OE “L. K.” Shpk; gjatë vitit 2020 ka ushtruar aktivitet në bashkitë; Durrës; Lushnje; Kuçovë; Elbasan; Korçë; Kavajë; Tiranë; Gjirokastrë; Vlorë; Librazhd; Skrapar;

### **OE “L. K.” Shpk, ka këto mangësi:**

**Nuk plotëson pikën 2.1** Vërtetim e lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2020. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-së).

**Nuk plotëson pikën 2,** Dëshmitë për mjetet e pajisjet teknike Operatori Ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion nga operatorë të tjerë ekonomike për ekzekutimin e kontratës mjetet dhe makineritë e mëposhtme:

Autoboti i Ujit me targa AA....., i marrë me qira nga L. F., Me Certifikatë nr. 16199, Transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, dhe i ka përfunduar afat.

OE “M. I. G.” Shpk, mjete;

Kamion vetëshkarkues mbi/ose15 ton, Targa 5....., Leje Qarkullimi T.....;

Fadrom me goma, Targa A....., Leje Qarkullimi T.....;

Kamioçinë deri në 3.5 ton, Targa A....., Leje Qarkullimi T.....;

Për sa trajtuar më sipër BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. K. A., znj. I. Sh., znj. M. M..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **40,828,749.25 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **40,828,749.25 lekë pa Tvsh.**

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **40,828,749.25 lekë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B. me detyrë Kryetar i Bashkisë Patos në cilësinë e titullarit të AK, z. F. K. në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe znj. A. P., në cilësinë e Kryetare e KVO, znj. E. R. dhe znj. B. F. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: znj. A. P., znj. E. R. e*

**znj. B. F. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/23.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 25, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.**

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

## 7. Procedura e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë Patos” Bashkia Patos 2021.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë Patos” Bashkia Patos, viti 2021.		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> nr. 19, datë 16.07.2021.	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 1467/3 prot., datë 16.07.2021. 1. M. N. (Jurist) 2. A. M. (Inxh. Ndërtimi ) 3. F. K. (Ekonomist)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 1467/4 prot., datë 16.07.2021. 1. A. P. Kryetar (Arkitekt) 2. Sh. B. (Jurist) 3. E. R. Anëtar (Arkitekt)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 10,537,749.98 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “I...” Shpk & “2...” Shpk me vlerë 7,685,210 lekë pa Tvsh.	<b>7. Diferenca me fondin limit:</b> 2,852,539.98 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 08.09.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> 30% Të ardhurat e Bashkisë Patos dhe 70% kontribut nga HAP	<b>10. Operatorët Ekonomikë OE të Kualifikuar</b> -BOE “H.” & “Sh.” <b>OE të s’kualifikuar</b> -OE “N.” Shpk -OE “Sh.” Shpk -OE “S.” Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b>	<b>12. Përgjigjeankesës nga AK:</b> Tërheqje nga ankesa e OE “S. K.” për kriteret e DT me shkresën nr. 2080/1 prot., datë 16.08.2021, dhe relacion me shkresën nr. 2080/2 prot., datë 16.08.2021.	<b>13. PërgjigjeAnkesës nga APP apo KPP.</b> Me shkresën nr. 2080/7 prot., datë 01.09.2021 nuk ka paguar tarifën nr. 2567/5 prot., datë 01.02.2022, të KPP-së.
b. Kontrata nr. 1467/22 prot., datë 01.11.2021		
<b>14. Lidhja e kontratës 01.11.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>9,222,252 lekë</b>

### Hartimi i kriterëve të DT:

Më datë 16.07.2021, Njësia e Prokurimit ka mbajtur procesverbalin me objekt “Mbi rillogaritjen e fondit limit për tenderin “Procedurë e hapur e thjeshtura” për procedurën “Rehabilitimi i rrjetit ujitës, zona Belinë”. Me urdhrin nr. 19, datë 16.07.2021, Titullari i AK ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë” me fond limit në vlerën 10,537,749.98 lekë pa Tvsh.

NjP me shkresën nr. 1467/6 prot., datë 30.07.2021, ka hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikimi.

### Ndryshime në DT (shtojca):

- Me shkresën nr. 2080 prot., datë 16.08.2021, nga OE “S. K. K.” Shpk, është paraqitur pranë Bashkisë Patos formulari i ankesës në lidhje me kriteret e vendosura në DT. Me shkresën nr. 2080/1 prot., datë 16.08.2021, OE “S. K. K.” Shpk është paraqitur pranë Bashkisë Patos kërkesa për tërheqje nga ankimimi. Nga NjP është mbajtur relacioni sipas shkresës nr. 2080/2 prot., datë 16.08.2021, për mos shqyrtimin e ankesës në kushtet kur OE “S. K. K.” Shpk është tërhequr nga ankesa.

Në vijueshmërinë të shkresave nr. 1489/2 prot., datë 20.08.2021, në Bashkinë Patos me nr. 2080/5 prot., datë 25.08.2021, dhe shkresën nr. 1489/3 prot., datë 24.08.2021, në Bashkinë Patos me nr. 2080/6 prot., datë 26.08.2021, me KPP, nga Bashkia Patos është kryer përgjigje sipas shkresës nr. 2080/4 prot., datë 24.08.2021, duke i dhënë informacion mbi ankesën dhe tërheqjen nga ankesa të OE “S. K. K.” Shpk.

Me Vendimin nr. 547/2021, me nr. 1489/5 prot., datë 27.08.2021, KKP ka vendosur të vijojë me zhvillimin e procedurës “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë”.

Më datë 12.08.2021, nga asistenca që APP i jep AK në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Patos rezulton se: për procedurën me REF-02475-08-09-

2021, me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë” me fond limit 10,537,749.98 lekë pa Tvsh, ka sygjeluar disa kriteret e DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës..

Me shkresën nr. 1467/8 prot., datë 19.08.2021, Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. A. M., z. F. K. dhe z. M. N. kanë hartuar hartuar shtojcë e DT.

**Në lidhje me kriteret e vendosura nga NJHDT, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, konkretisht:**

**30. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, janë konstatuar kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:**

**1. Në Pikën 3.2. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- |   |               |
|---|---------------|
| a. NP-1: Punime gërmimi në tokë                                       | “Kategoria A” |
| b. NP-5: Punime nëntokësore, ura e vepra arti.                        | “Kategoria A” |
| c. N.P.7.a: Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje           | “Kategoria A” |
| d. NP-9: Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime | “Kategoria A” |
| e.N.S. 1: Punime për prishjen e ndërtimeve                            | “Kategoria A” |
| f. NS-18: Punime topogjeodezike.                                      | “Kategoria A” |

**2. Në Pikën 2.3.5. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik duhet të disponojëpunonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. **Teknike ndërtimi3 (tre)** për këtë duhet të paraqes diplomë të shkollës së mesme, kontrate pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT ose ekuivalente) dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim.

b. **Teknik topograf1 (një)** për këtë duhet të paraqes diplomë të shkollës, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT ose ekuivalente) dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim.

c. **Specialistë 8 (tetë)**

d. **Karpiertiere 4 (katër)** për këtë duhet të paraqes, kontrate pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT ose ekuivalente dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim.

f. **Nivelues betoni 4 (katër)** për këtë duhet të paraqes, kontrate pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT ose ekuivalente dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim.

g. **Puntorë të thjeshtë 10 (dhjetë)** për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim.

i. **Shoferë 3 (tre)** për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme leje drejtimi, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT ose ekuivalente dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim. (Në raste kur makinerit disponohen me qira, këta punonjës do të jenë të kontraktuar).

j. **Manovratorë 3 (tre)** për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme leje drejtimi, IQT (ekuivalente) dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë nga muaji Maj 2021 e në vazhdim. (Në raste kur makinerit disponohen me qira, këta punonjës do të jenë të kontraktuar).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- diplomë,
- kontrata pune,
- dëshmi kualifikimi,
- Në raste kur makinerit disponohen me qira, këta punonjës do të jenë të kontraktuar.

**3. Në Pikën 2.3.7. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:



1. Kamion me kapacitet mbajtës mbi/ose 15 toncopë 1 (një)
2. Kamion me kapacitet mbajtës (8 deri në 10 ton) copë 1 (një)
3. Kamioçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 toncopë 1 (një)
3. Skrep copë 1 (një)
4. Mini Fadrome copë 1 (një)
5. Betoniere copë 2 (dy)
6. Autobetoniere copë 1 (një)
7. Ekskavator me zinxhirë copë 1 (një)
8. Ekskavator me goma copë 2 (dy)
9. Depozitë uji copë 1 (një)
10. Pompë uji copë 2 (dy)
11. Vibrator betony copë 2 (dy)
12. Prerëse bari copë 2 (dy)
13. Matrapik copë 2 (dy)
14. Tokmak për ngjeshje dheu copë 2 (dy)
15. Gjenerator 3.5 KË copë 2 (dy)

#### **4. Në Pikën 2.3.8. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: Certifikat ISO:**

**b. ISO 14001 - 2015 - Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente,** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**d. ISO 3834-2006 Standart për kërkesat e cilësisë për saldimin e materialeve metalike (e vlefshme) ose ekuivalente,** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Vendosja e kërkesës, së mësipërme nuk përmbush përcaktimet pikës 3 të nenit 44 nëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet që *“Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”*.

**Për sa trajtuar më sipër,** kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara teksituata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve teknike të vlerësimit në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikimet teknike; të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e kriteri mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, e ngarkojnë me përgjegjësi Ing. A. M., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, që ka hartuar kriteret teknike të vlerësimit.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. M., z. në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit.**

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e njësisë së prokurimi: z. M. N., z. F. K. e z. A. M. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/14.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 13, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

### **Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:**

Me shkresën nr. 1467/4 prot., datë 16.07.2021, të titullarit të autoritetit kontraktor znj. R. B. është ngritur KVO i përbërë nga znj. A. P. (Kryetar) si dhe anëtarët z. Sh. B. e znj. E. R..

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë për të cilët referuar procesverbalit nr. 4, datë 21.09.2021.

**1. BOE “I...” Shpk & “2.....” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 7,685,210 lekë pa Tvsh.**

**2. OE “N.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 7,685,210 lekë pa Tvsh.**

**3. OE “Sh.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 7,904,493 lekë pa Tvsh.**

**4. OE “S.” Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**

Me shkresën nr. 1467/14 prot., datë 21.09.2021, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e BOE “I.....” Shpk & “2.....” Shpk. Me shkresën nr. 1467/15 prot., datë 29.09.2021, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilën e titullarit të autoritetit kontraktor.

Me procesverbalin nr. 1467/17 prot., datë 29.09.2021, KVO ka shqyrtuar dokumentacionin origjinal të BOE “I.....” Shpk & “2.....” Shpk.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “I.....” Shpk & “2.....” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar procedura.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “I.....” Shpk & “2.....” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim.

**31. Titulli i gjetjes:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

### **Situata:**

**1. Për pikën 2.2.3.** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2021.

Nga OE “2.. K.” Shpk, nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga Bashkitë; Sarandë, Selenicë, Tiranë dhe Përrenjas referuar likudimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Sarandë, Vlorë, Tiranë dhe Librazhd ndërkohë që ka ushtruar aktivitet në këto qytete referuar kontratave si më poshtë:

-Kontrata me nr. 122/1 prot., datë 12.04.2021, me objekt: “Sistemim i KUZ rrjeti sekondar dhe tercial Ksamil nga “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a, Sarandë fatura nr. 4/2021, datë 05.05.2021, në vlerën 9,341,884 lekë regjistruar më datë 10.02.2021, dhe likuiduar më datë 14.05.2021, nga Dega e Thesarit Sarandë.

-Kontrata me nr. 1752 prot., datë 04.06.2021, me objekt: “Riparim i shkarkuesit të rezervuarit Harvala zgjerimi i rrugës Resulaj Romës” institucioni Bashkia Selenicë, fatura nr. 19, datë 02.08.2021, në vlerën 3,944,139 lekë regjistruar më datë 09.08.2021, dhe likuiduar më datë 10.08.2021, nga Dega e Thesarit Vlorë.

-Kontrata me nr. 1235/4 prot., datë 17.05.2021, me objekt: “Rikonstruksion godine” institucioni Reparti Ushtarak Tiranë fatura nr. 19, datë 02.08.2021, në vlerën 2,615,350 lekë regjistruar më datë 29.06.2021, dhe likuiduar më datë 30.06.2021, nga Dega e Thesarit Tiranë.

-Kontrata me nr. 500 prot., datë 01.03.2021, me objekt “Për sistemim të qendrës fshati Përrenjas” institucioni Bashkia Përrenjas fatura nr. 8/2021, datë 14.05.2021, në vlerën 1,866,055 lekë regjistruar më datë 19.05.2021, dhe likuiduar më datë 20.05.2021, nga Dega e Thesarit Librazhd.

Kualifikimi nga ana e KVO e BOE “1....” Shpk & “2.....” Shpk, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në DT, është veprim në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 2 e neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. K. A., znj. I. Sh., znj. M. M..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **7,685,210 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “1....” Shpk & “2....” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **7,685,210 lekë pa Tvsh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. A. P., z. Sh. B. dhe znj. E. R. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “1....” Shpk & “2.....” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **7,685,210 lekë pa Tvsh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B.j me detyrë Kryetar i Bashkisë Patos në cilësinë e titullarit të AK, z. A. M. e në cilësinë e anëtarit të NjP dhe znj. A. P., z. Sh. B. e znj. E. R. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: A. P., z. Sh. B. dhe znj. E. R. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/14.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 13, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

## 8. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës Dukas Çoban”, zhvilluar në vitin 2021.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës Dukas Çoban”, Bashkia Patos, viti 2021.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 26, datë 18.10.2021.	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 2683/1 prot., datë 18.10.2021.	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 26832 prot., datë 18.10.2021.
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	1. M. N. (Jurist) 2. A. Sh. (Inxhinier Ndërtimi) 3. F. K. (Ekonomist)	1. J. Sh. Kryetar (Shke Sociale) 2. S. M. Anëtare (Inxh. Ndërtimi) 3. I. Sh. Anëtar (Jurist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 12,568,796.01 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “A. C.” Shpk & “6...n” Shpk vlera e ofertë 11,973,509.42	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 595,286.59 lekë

	lekë.	
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 08.11.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> 30% Të ardhurat e Bashkisë Patos dhe 70% kontribut nga HAP	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> <b>OE të Kualifikuar</b> - BOE "A. C." Shpk dhe "6...." Shpk <b>OE të s'kualifikuar</b> - BOE "S." Shpk -OE "A..." Shpk & "Sh." Shpk -OE "M." Shpk & "G." Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Ankesa ka marr përgjigje me shkresën nr. 2683/20 prot., datë 06.01.2022, BOE "M." Shpk & "Sh." Shpk	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b> Me shkresën nr. 2567/5 prot., datë 01.02.2022, të KP, në Bashkinë Patos me nr. 2683/23 prot., datë 07.02.2022.
<b>b. Kontrata nr. 2683/30 prot., datë 04.04.2022</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 04.04.2022</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	14,368,211.30

#### **Hartimi i kriterëve të DT:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 26, datë 18.10.2021, të titullarit të AK, me shkresën nr. 2683/3 prot., datë 20.10.2021, ing. A. M. ka hartuar kriteret e vlerësimit të cilat janë dërguar pranë Njesisë së Prokurimit dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë.

#### **Ndryshime në DT (shtojca):**

Me shkresën nr. 2683/7 prot., datë 27.10.2021, z. M. N. është drejtuar me kërkesë për pezullim të procedurës deri në hedhjen e shtojcës së hartuar në sistem. Me shkresën nr. 2683/6 prot., datë 27.10.2021, nga Njësia e Prokurimit është mbajtur njoftimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit e përbërë nga z. A. M., z. F. K. dhe z. M. N..

- Më datë 26.10.2021, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Patos, rezultoi se: për procedurën e me REF-09096-10-21-2021, me objekt: "Rikonstruksioni i ambienteve Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës Dukas Çoban" me fond limit 12,568,796.01 lekë pa Tvsh, ka sugjeruar disa kriteret të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Titulli i gjetjes 32:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, janë konstatuar kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

#### **Situata:**

**1. Në Pikën 2.3.5, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** "Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Teknike ndërtimi 2 (dy) për këtë duhet të paraqes diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figurojn në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

b. Specialiste 12 (dymbëdhjetë) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

Specialistët do të jenë sipas ndarjes më poshtë:

Suvatues 4 (katër)

Pllakashtrues 4 (katër)

Bojaxhinj 4 (katër)

c. Puntorë të thjeshtë 12 (dymbëdhjetë) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme, dhe të figurojn në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

d. Elektracistë 4 (katër) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

e. Hidraulike 2 (dy) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figurojn në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

f. Specialist ngrohje-kondicionimi 2 (dy) për këtë duhet të paraqes, kontrate bashkëpunim/pune të vlefshme ose deklarata disponibiliteti dhe eskuziviteti, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figurojn në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

g. Shoferë 2 (dy) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme leje drejtimi, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figurojn në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

(Në raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar.)

h. Manovratorë 2 (dy) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme leje drejtimi, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente) dhe të figurojn në listpagesën e shoqërisë nga muaji Gusht 2021 e në vazhdim.

i. (Në raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar.)”

**2. Në Pikën 2.3.6, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 43 (dyzet e tre) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

a) Vertetimet lëshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të rrethit përkatës **ose** me vullë elektronik.

b) Listëpagesat për periudhën e mësipërme (E-sig 25).

**3. Në Pikën 2.3.8, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Mbështetur në: Ligj nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, ndryshuar me Ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjisllacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”, Kreu II, Neni 9 “Detyrime të krijuesit të mbetjeve”. Neni 12 “Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit”; Neni 24/1; Neni 25 “Lejet mjedisore”.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B”.

Referuar objektit të prokuruar “rikonstruksion rruge” transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: *lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë, siguracionin, kolaudimin, certifikatë transporti.*

Kriteri për disponimin e licencë me Kodin III.2.B, “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve”, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferim i mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve.

**Për sa trajtuar më sipër,** kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përputhje me lidhëngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e kriterit mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, sa më sipër **ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. M. N., z. A. M., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e njësisë së prokurimit: z. M. N., z. F. K. e z. A. M. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/14.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 12, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**Përsa

#### **Vlerësimi i ofertave:**

Me shkresën nr. 2683/2 prot., datë 18.10.2021, të titullarit të AK znj. R. B. është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. J. Sh. Kryetar me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Burimeve

Njerëzore (Shkenca Sociale) si dhe anëtarët znj. S. M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projekttimeve (Inxhinier Ndërtimi), znj. I. Sh. me detyrë Specialist Jurist (jurist).

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë për të cilët referuar procesverbalit nr. 4, sipas shkresës nr. 2683/11 prot., datë 20.12.2021, KVO-ja i përbërë nga znj. J. Sh. kryetar dhe anëtarët znj. I. Sh., znj. S. M. ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

**OE “S.” Shpk;**

**BOE “A.” Shpk & “G.” Shpk;**

**BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk;**

**BOE “A. C.” Shpk & “6..” Shpk.**

Me procesverbalin nr. 2683/10 prot., datë 17.12.2021, KVO ka shqyrtuar dokumentacionin origjinal të BOE “A. C.” Shpk & “6..” Shpk.

Me shkresën nr. 2683/25 prot., datë 07.02.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilën e titullarit të autoritetit kontraktor. Me shkresën nr. 2683/26 prot., datë 07.02.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e sukseshme e BOE “A. C.” Shpk & “6..” Shpk, pas procesit të ankimimit.

**33. Titulli i gjetjes:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kakualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**Për pikën 2.2.2.** *“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilanci e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.*

-Pasqyrat financiare të paraqitura nga OE “A. C.” Shpk, për vitet 2019, 2020 janë të depozituara pranë DRT Fier, në një të vetëm në të cilat ndodhet vula e sekretarisë por nuk është marrëkonfirmimi me shkresë dhe me vulë nga kjo drejtori.

Për sa trajtuar më sipër BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK të shpallet fitues BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Kualifikimi nga ana e KVO e BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura në DT, është veprim në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 2 e neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **11,973,509 lekë pa Tvsh.**

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. K. A., znj. I. Sh., znj. M. M..

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **11,973,509 lekë pa Tvsh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. J. Sh., znj. S. M., znj. I. Sh. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriteve, ku evidentohet kriteret jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “A. C.” Shpk & “6...” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **11,973,509 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** znj. R. B. në cilësinë e Titullarit të AK, z. M. N., z. A. M. e z. F. K. anëtarë të NjP e znj. J. Sh., znj. S. M., znj. I. Sh. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: znj J. Sh., znj. S. M. e znj. I. Sh. me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/15.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 13, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

**d.** Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2022, deri më 31.12.2022**, paraqiten si më poshtë:

**9. Procedura e prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”, Bashkia Patos, viti 2021.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi:</b> nr. 19, datë 16.07.2021.	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhri nr. 1867/2 prot., datë 05.08.2022.	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhri nr. 1867/3 prot., datë 09.08.2022.
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Procedurë e hapur e thjeshtuar”	1. D. K. (Jurist) 2. M. N. (Jurist) 3. A. M. (Inxh. Ndërtimi)	1. Sh. B. Kryetar (Jurist) 2. N. H. Anëtar (Jurist) 3. B. M. (Inxh. Ndërtimi)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 15,932,480.83 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “I.” Shpk me fond limit 13,773,769.23 lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit:</b> 2,158,711.60 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 07.09.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e Bashkisë Patos dhe MFE.	<b>10. Operatorët Ekonomikë OE të Kualifikuar</b> OE “I.” Shpk
<b>11. Ankimime AK:</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 1867/16 prot., datë 28.09.2022</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 28.09.2022</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>16,528,523lekë</b>

**Hartimi i kriteve të DT:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 16, datë 05.08.2022, të titullarit të AK, me shkresën nr. 1867/4 prot., datë 18.08.2022, ing. A. M. ka hartuar kriteret e vlerësimit të cilat janë dërguar pranë NjP dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë. Urdhri i prokurimit është i miratuar elektronikisht në Degën e Thesarit Fier në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 154. Me shkresën nr. 1867/5 prot., datë 19.08.2022, nga NjP është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteve për kualifikimi.

**Ndryshime në DT (shtojca):**

- Më datë 29.08.2022, nga asistenca që APP i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Patos, rezulton se: për procedurën e me REF-39389-08-22-2022, me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”, Bashkia Patos me fond limit 15,932,480 lekë pa Tvsh, ka sugjeruar disa kriteret e DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Me shkresën nr. 1867/7 prot., datë 26.08.2022, dhe shkresën nr. 1867/8 prot., datë 29.08.2022, NjP e përbërë nga znj. D. K., z. A. K. dhe z. F. K. kanë kryer ndryshim në DT.

**34. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, janë konstatuar kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:**

**1. Në Pikën 2.3.2. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në baze të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**g. N.S-8:** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri. “Kategoria A”

**h.N.S-14:** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj., “Kategoria A”

Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit”.

**2. Në Pikën 2.3.7. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Mbështetur në: Ligj nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, ndryshuar me Ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH”, Kreu II, Neni 9 “Detyrime të krijuesit të mbetjeve”. Neni 12 “Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndertimit”; Neni 24/1; Neni 25 “Lejet mjedisore”.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B”.

**3. Në Pikën 2.34. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: Certifikat ISO:**

**a.** ISO 9001-2015-Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme), Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmikombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**b.ISO 14001-2015-Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ose ekuivalente (e vlefshme),** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmikombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriteretevetknike të vlerësimit në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specififikimet teknike; të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mire argumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e kriteri mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, e ngarkojnë me përgjegjësi Ing. A. M., në cilësinë e anëtarit të NJHDT, që ka hartuar kriteret teknike të vlerësimit.



**Konkluzion:** Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga anëtarët e Njësisë së Prokurimi: **Znj. D. K., Z. M. N. e z. A. M.** me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/16.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 14, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

### **Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:**

Me shkresën nr. 1867/3 prot., datë 09.08.2022, të titullarit të AK znj. R. B. është ngritur KVO i përbërë nga z. Sh. B. kryetar me detyrë Sekretar i Përgjithshëm (Jurist) dhe anëtarët znj. B. M., e znj. N. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik (Juriste).

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE për të cilin referuar procesverbalit të datës 15.09.2022, KVO-ja i përbërë nga z. Sh. B., Kryetar dhe anëtarët znj. B. M., znj. N. H. kanë kryer vlerësimin dhe klasifikimin.

**1.OE “I.” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 13,773,769 lekë pa Tvsh.**

**35. Titulli i gjetjes:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “I.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të OE “I.” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**1.Për pikën 2.2.3.** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitetet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DT dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Nga OE “I.” Shpk nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Vlorë referuar likudimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Vlorë ndërkohë që ka ushtruar aktivitetet në këtë qytete referuar kontratës si më poshtë:

-Kontrata me nr. 7619 prot., datë 04.07.2022, me objekt: “Ndërtimi i skarpatës për godinën e bashkisë” institucioni Bashkia Vlorë. Fatura me nr. 18, datë 17.11.2022, në vlerën 3,825,200 lekë regjistruar më datë 06.12.2022, dhe likuiduar më datë 07.12.2022, nga Dega e Thesarit Vlorë.

Për sa trajtuar më sipër OE “I.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet të kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE “I.” Shpk por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënljore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. K. A., znj. I. Sh., znj. M. M..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **13,773,769 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues OE "I." Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **13,773,769 lekë pa Tvsh**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** z. Sh. B., znj. N. H. dhe znj. B. M. në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE "I." Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **13,773,769 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Znj. R. B. cilësinë e Titullare e Autoritetit Kontraktor, Ing. A. M. në cilësinë e anëtari i Njësisë së Prokurimit. dhe z. Sh. B., znj. N. H. dhe znj. B. M..

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: z. Sh. B., znj. N. H. dhe znj. B. M., me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionin nr. 312/16.1 prot., datë 31.03.2023, për Akt Konstatimet nr. 14, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

## 10. Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Shehu" dhe ndërtim i palestrës"

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Shehu" dhe ndërtim i palestrës", Bashkia Patos, viti 2022.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr.17, datë 09.08.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 1784/1 datë 09.08.2022	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> nr. 1067/1 prot., datë 07.05.2019
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> "E Hapur"	1. D. K. (Jurist) 2. A. M. (Ing. Ndërtimi) 3. F. K. (Ekonomist)	1. Sh. B. (Kryetar) 2. A. L. (Ing. Ndërtimi) 2/1. B. M. 3. I. Sh.(Juriste) 3/1. E. B.
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 81,153,183.84 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE "Sh." Shpk, vlere e ofertës 71,986,105 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 9,167,078.84 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 28.07.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Ministria e Financave dhe Bashkia Patos	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE "Sh." Shpk 2. BOE "A. C." Shpk & "2.. K." Shpk 3. OE "2..." Shpk 4. OE "E. K." Shpk 6. OE "G." Shpk 7. OE "V. K." Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> - Kthimpërgjigje BOE "A. C." Shpk & "2.. K." Shpk nr. 2685/5 prot., datë 02.11.2022 - Kthim përgjigje OE "2..." Shpk nr. 2686/3 prot., datë 02.11.2022	<b>13. Përgjigje ankesës nga APP apo KPP.</b> Vendim KPP i përbashkët për dy ankesat Nr.1129/2022 date 22.11.2022
b. Kontrata nr. 1784/18 prot., datë 05.11.2022		
<b>14. Lidhja e kontratës 05.12.2022</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>85,628,886</b>

### **Hartimi i kritereve të DT:**

Me shkresën nr. 1784/4 prot., datë 17.08.2022, nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali, me objekt “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”.

Me shkresën nr. 1784/5 prot., datë 18.08.2022, Njoftimi i kontratës së shkurtuar, botur në Buletin me nr. 114, datë 22 Gusht Maj 2022, në faqet 35-36/448.

### **Ankesa Për DT**

Më datë 23.08.2022 OE “E. K.” Shpk” ka paraqitur në SPE ankesë/kërkesë për sqarime më lidhje me DT të procedurës.

Nga Nësia e Prokurimit i është kthyer përgjigje më datë 26.8.2022.

### **Ndryshimet në DT:**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 24.08.2022, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i palestrës”, Bashkia Patos me fond limit **81,153,183.83 lekë pa Tvsh**, autoritetit kontraktor **Bashkia Patos në lidhje me** procedurën me REF-39170-08-18-2022, në lidhje me disa konstatime në DT.

Me nr. 1784/6 prot., datë 26.08.2022, është formuluar nga Njësia e Prokurimit ka vendosur paraqitjen në SPE e Shtojcës në DT.

**36. Titulli i gjetjes:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT nuk ka formuluar Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **Situata:**

**1. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- |                          |         |
|--------------------------|---------|
| a. Inxhinier ndërtimi    | 1 (një) |
| b. Inxhinier mekanik     | 1 (një) |
| c. Inxhinier elektrike   | 1 (një) |
| d. Inxhinier hidroteknik | 1 (një) |
| e. Inxhinier gjeodet     | 1 (një) |
| f. Arkitekt              | 1 (një) |

**2. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

**a.** 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq, ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**b.** 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

**c.** 1 (një) punonjës, të disponojmë çertifikatë si “Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

**d.** 3 (tre) Punonjës të certifikuar për punime që kryhen në lartësi.

-Për këtë duhet të paraqes Diplomë/Certifikatë, CV, kontratë pune të vlefshme, dhe të figurojnë listpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2022 e në vazhdim. Në fazën e ofertimit OE plotëson formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DT dhe dokumentacioni i kërkuar do të

paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**3. Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Mbështetur në: Ligj nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, ndryshuar me Ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

*Kreu II Neni 9 Detyrime të krijuesit të mbetjeve*

*Neni 12 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit*

*Neni 25 Lejet mjedisore*

*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B”.*

**4. Në pikën 2.4.1. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Certifikat ISO:

**b. ISO 14001-2015-Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ose ekuivalente (e vlefshme),** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmikombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e BOE, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave tepunimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi Ing. A. M., në cilësinë e **anëtarit të NJHDT, që ka hartuar kriteret teknike të vlerësimit.**

**Ndikimi:** Kufizimii pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikimet teknike; të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mire argumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

#### **- Zhvillimi i procedurës.**

Me shkresën nr. 1784/8 prot., datë 13.09.2022, ing. A. L. , ka kërkuar përjashtimin nga KVO-ja, për arsye se gjatë të shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar se në një kontratë pune të ngarkuar në SPE nga OE konkurues figuronte si mbikqyrës.

Me urdhërin nr. 1784/9 prot., datë 13.09.2022, për zvendësimin e anëtarit të KVO ing. A. L. me znj. B. M.

Me vendimin nr. 2264/2 prot., datë 20.09.2022, “Për lirimimin nga shërbimi civil” znj. I. Sh..

Me urdhërin nr. 1784/10 prot., datë 21.09.2022, për zvendësimin e anëtarit të KVO znj. I. Sh. me znj. E. B.

Procesverbali i KVO, datë 21.09.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 6 (gjashtë) OE/BOE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

Procesverbali i KVO, “I hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike”

Procesverbali i KVO, datë 04.10.2022, “Mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave” për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar të 2 OE, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “Sh.” Shpk dhe OE “E. K.” Shpk.

Është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “Sh.” Shpk.

Procesverbali i KVO, datë 04.10.2022, “I mbylljes së procesit të vlerësimit të procedurës” dhe shpallja në SPE”, dhe i është drejtuar OE “Sh.” Shpk, për paraqitjen e dokumentacionit provues të vetdeklaruar dhe të dokumentave të tjerë shoqëruues të ofertës.

Më datë 10.10.2022, është mbajtur procesverbali i KVO-së është marrë në dorëzim dokumentacioni i sipërcituar.

Me nr. 1784/12 prot., datë 18.10.2022, “Procesverbali mbi kontrollin e dokumentave”, ku KVO ka shqyrtuar, kontrolluar dhe vlerësuar si të rregullta dhe në përputhje me formën ligjore i ka kaluar NJP, për të vazhduar procedurat e mëtejshme.

Me nr. 1784/13 prot., datë 19.10.2022, “Formulari i njoftimit të fituesit (paraprak)”, botuar në Buletinin nr. 173, datë 19 Dhjetor 2022, faqet 569-570/750.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. BOE “A. C.” Shpk & “2.. K.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **68,210,930.91** (gjashtëdhjetë e tetë milion e dyqind e dhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë e një) **lekë pa Tvsh.**

**2. OE “2...” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **69,974,257** (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) **lekë pa Tvsh.**

**3. OE “Sh.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **71,986,105** (shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesë) **lekë pa Tvsh.**

**4. OE “E. K.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **78,717,408.73** (shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëpikështatëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

**5. OE “G.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **79,803,656.25** (shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë e pesë) **lekë pa Tvsh.**

**6. OE “V. K.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **80,337,128.70** (tetëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e tetë pike shtatëdhjetë) **lekë pa Tvsh.**

- **Ankesa me nr. 2685 prot.**, datë 27.10.2022, e BOE “A. C.” Shpk & “2.. K.” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 2685/5 prot., datë 02.11.2022.

- **Ankesa me nr. 1918 prot.**, datë 12.07.2019, e OE “2...” Shpk, ka marrë përgjigje me shkresën nr. 2686/3 prot., date 02.11.2022.

Me nr. 2685/1 prot., datë 27.10.2022, Urdhëri për pezullim e procedurës, dhe shqyrtimin e ankesave, nga Komisioni i shqyrtimit të ankesave (nr. 2685/2 prot., datë 27.10.2022) i përbërë nga: z. A. M., Ing. S. M. e znj. N. H..

Vendim KPP i përbashkët për dy ankesat nr.1129/2022, datë 22.11.2022, për mospranimin e dy ankesave. Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr. 1784 prot., datë 24.11.2022, botuar në Buletinin nr. 164, datë 30 Nëntor 2022, faqet 321-322/590.

Kontrata me **OE “Sh.” Shpk**, fitues nr. 1784/18 prot., datë 05.12.2022. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **85,628,886** (tetëdhjetë e pesë milion e gjashtëqindë e njëzetë e tetë mijë e tetëqindë e tetëdhjetë e gjashtë) **lekë me Tvsh.**

**Lidhur me OE “Sh.” Shpk, të shpallur fitues**, rezulton se OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**Për sa trajtuar më sipër**, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përputhje me lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e kriterit mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, sa më sipër **ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. D. K., z. A. M., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga subjekti i audituar Bashkia Patos, nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit: **Znj. D. K., z. M. N. e z. A. L.**, me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me nr. 312/26.1 prot., datë 31.03.2023, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. Përsa më sipër, pretendimet **nuk merret në konsideratë.**

## Auditim mbi prokurimet me blerje të vogla.

**37. Titulli i gjetjes:** Pargullsli në zhvillimin e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla.

**Situata:** Për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022, Bashkia Patos në total ka zhvilluar 469 prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së, me fond limit në vlerën 60,374,830 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate në vlerën 52,892,301 lekë pa Tvsh me një diferencë mosrealizimi të fondit limit në vlerën 7,482,529 lekë pa Tvsh. Nga të cilat me zgjedhje janë audituar në total 48 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 21,099,954 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate në vlerën 18,743,115 lekë pa Tvsh ose në masën 34.9% të totalit të vlerës së fondit limit. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Lekë

Procedurat e prokurimit me vlera të vogla për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022								
Nr.	Periudha	Të dhënat sipas regjistrit të prokurimeve			Të dhënat e audituara			
		Numri i procedurave të realizuara	Fondi limit	Realizimi në vlerë kontrate	Numri i procedurave	Fondi limit	Realizimi në vlerë kontrate	Në % i vlerës së fondit limit
1	01.07.2019-31.12.2019	74	6,593,313	5,893,685	8	3,088,794	2,649,620	47%
2	2020	131	15,569,339	13,725,078	12	4,491,234	4,009,234	29%
3	2021	124	20,572,274	17,531,816	12	6,045,298	5,626,600	30%
4	2022	140	17,639,904	15,741,722	16	7,474,628	6,457,661	42%
<b>Totali</b>		<b>469</b>	<b>60,374,830</b>	<b>52,892,301</b>	<b>48</b>	<b>21,099,954</b>	<b>18,743,115</b>	<b>34.9%</b>

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimeve i procedurave të prokurimit për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura mbi auditimin e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Për vitin 2021 dhe 2022 në dy raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuarfondin limit.

-Në 13 raste nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.

-Në 3 raste në dosjet e prokurimeve nuk disponohet të gjitha dokumentacionet e përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë (numër llogaire, vërtetimi për shkyerjen e taksave dhe tarifave vendore, deklarata e garancisë, të cilat përbëjnë skualifikim të operatorëve për mos plotësimin e tyre ndërkohë që nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla edhe këto kriteret nuk janë përmbushur operatorët janë shpallur fitues.

-Në 4 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të anëtarët e komisionit.

-Në 17 raste kanë rezultuar vonesa nga Bashkia Patos në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në 48 raste dosjet e procedurave të prokurimit me vlera të vogla nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara.

**Kriteri:** Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit arkivor në R.SH.”, neni 3 dhe neni 29 miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 1, neni 59, pika 2, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 19.

**Ndikimi:** Risk mbi mosfunksionimin dhe marrjen e duhur të shërbimit.

**Shkaku:** Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, Drejtoria e Financës dhe Sektori Juridik përgjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, të shmangët mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Përpara fillimit të procedurës së prokurimit me vlera të vogla të argumentojë dhe të dokumentojë nevojat e institucionit për mallra dhe shërbime.

-Për raste në të cilat nga operatorët ekonomikë nuk paraqesin dokumentacionin e kërkuar në kriteret e ftesës për ofertë të bëhet skualifikimi i tyre.

-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen sipas përcaktimeve ligjore.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Të gjitha aktet e hartuara në lidhje me procedurat e prokurimit, të kalojnë përmes arkivës së institucionit, me qëllim evidentimin e rrjedhshmërisë së veprimeve gjithashtu pas përfundimit të çdo procedure të kryhet arkivimi i tyre.

**Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:** z. R. B. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, znj. M. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës (për mos likuidimin brenda afateve të faturave për prokurimet me vlera të vogla), si dhe komisioni i prokurimeve me vlera të vogla sipas periudhave respektive i përbërë nga znj. D. K., z. F. K., z. M. N., znj. I. Sh., znj. E. B..

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga nga subjekti i audituar Bashkia Patos nga subjekti i audituar Bashkia Patos, nga znj. D. K., z. M. N., z. F. K. dhe znj. E. B. anëtarë të Komisionit të Prokurimeve me Vlera të Vogla, me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me observacionet elektronikisht në adresën zyrtare të KLSH, për Akt Konstatimet nr. 4, 5, 6 dhe 7, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit.*

**Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

## **2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.**

### **1. “Sistemimi i hapësirave, Lagjja 29 Marsi, Blloku Zjarrëfiksja”, Bashkia Patos.**

#### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 851/15 prot datë 03.08.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë znj. R. B. dhe BOE “M. I. G.” Shpk me përfaqësues znj. P. K., me licencë profesionale NZ..... dhe “L. K.” Shpk me përfaqësues z. F. Sh., me licencë profesionale NZ..... Vlera e kontratës është 48,994,499.1 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 180 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Me shkresën e mbikëqyrësit të punimeve, me nr 1764/15 prot., datë 24.01.2022 është kërkuar shtyrja e afatit për shkak të moslirimit të sheshit në zonën 5, motit me ngrica dhe shi, pengesave të banorëve si dhe shtimit të punimeve për KUZ. Pas kësaj kërkesë është nxjerrë Urdhri i titullarit të AK znj. R. B., nr 1764/17 prot., datë 24.01, për verifikimin e problematikave. Me Urdhrin nr 9802 prot., datë 31.08.2021 të titullarit të Bashkisë Patos, është urdhëruar rifillimi i punimeve. Pas këtij Urdhri, është hartuar amendamenti i kontratës me nr 851/18 prot, datë 27.04.2022, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 90 ditë nga data e nënshkrimit të amendamentit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 851/14 prot, datë 03.08.2021, është lidhur kontrata me BOE “S. P.” Shpk & “6... P.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht MK..... e MK ..... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 867,939 lekë me Tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 851/19 prot., datë 21.07.2022, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. T. N. PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 80,462 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, nga grupi i punës me përbërje ing. A. M., ing. A. L. dhe ing. S. M., është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., pa datë.

### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje Infrastrukturore me nr. 3, datë 19.07.2021. Ky veprim është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.”.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Patos, znj. R. B.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Kontrollit të Zhvillimit dhe Projekteve në vitin 2021 dhe është miratuar nga Bashkia Patos.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 03.08.2021 dhe kanë përfunduar me datë 26.07.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 22.09.2021, titullari i Bashkisë Patos, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin i bërë nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, janë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 9,724,925 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 7,814,520 lekë pa Tvsh, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 1,904,420 lekë pa Tvsh.

Nga auditimi i preventivit të ripunuar, konstatohet se janë shtuar 2 zëra të rinj pune. Në dosjen teknike administrohet dokument për negociimin e këtyre zërave të rinj pune, në përputhje me UKM nr. 2, datë 15.02.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 8.3. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekti i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemimi i hapësirave, Lagjja 29 Marsi, Blloku Zjarrëfiksja”, Bashkia Patos</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 851/15 prot datë 03.08.2021	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 48,994,499.1 lekë <b>BOE fitues “M. I. G.” Shpk &amp; “L. K.” Shpk</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 48,975,455 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 40,812,879 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 180 ditë , Zbatuar 357 ditë. Fillimi punimeve: 03.08.2021 Perfundimi punimeve : 26.07.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendamenti nr 851/18 prot, datë 27.04.2022, shtyrje 90 ditë	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve; BOE “S. P.” Shpk &amp; “6....-P.” Shpk</b>	Licenca Nr: MK..... MK.....	Kontrata me nr 851/14 prot, datë 03.08.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Ing. T. N. P...	Licenca Nr: MK.....	Kontrata nr. 851/19 prot., datë 21.07.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> pa nr. prot., pa datë	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> pa nr. prot., pa datë		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar



nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **96,532 lekë pa Tvsh**.

**38. Titulli i Gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Sistemimi i hapësirave, Lagjja “29 Marsi”, Blloku Zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, nga zbatuesi i punimeve BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “FV bordura betoni 15x 30” dhe “Vijëzim shirita gjatësorë”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 851/15 prot., datë 03.08.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 851/14 prot., datë 03.08.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 851/19 prot., datë 21.07.2022.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Patos.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 96,532 lekë pa Tvsh nga BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 851/15 prot datë 03.08.2021, me objekt “Sistemimi i hapësirave, Lagjja “29 Marsi”, Blloku Zjarrëfiksja”, *Bashkia Patos*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 96,532 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Znj. A. R. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. T. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën pa nr. prot, datë 24.05.2023, protokolluar në KLSH me nr prot 119/15, datë 25.05.2023, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve znj. A. R., si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

**1. Zëri FV bordura 20 x 30 cm, çmimi.**

Duke pasur parasysh që bordurat e përshkruara në projekt janë me përmasa që perdoren në autostrada dhe jo në zona të banuara e ambiente rekreative, kemi menduar të vendosim këtë bordurë për të harmonizuar të gjithë elementët arkitektonikë dhe me funksionin e vetë veprës. Ndryshimi i dimensionit të bordurave është aplikuar për të rritur gjerësinë e pjesës kaluese të rrugës. Për këto arsye mendojmë se duhet të rishikohet Akt Konstatimi në lidhje me këtë zë punimi.

*Në lidhje me arsyetimin bërë nga grupi i Auditimit, mendojmë se i kemi paraqitur arsyet tona për të cilat mendojmë se janë të qënësishme dhe të argumentuara teknikisht, kërkojmë dhe një herë të rishikohet ky opinion në lidhje me këtë pretendim.*

**Opinionimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, sqaron se nëse ky ndryshim do të ishte menduar për të rritur funksionalitetin e veprës, duhet të ishte bërë negociimi i çmimit, si çmim i ri, i cili nuk është në preventivin e ofertës. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

**2. Zëri FV bordura 8x20 cm për konturimin e fidaneve + bordura trotuari, çmimi.**

*Kërkojmë që të rishikohet opinioni i grupit të auditimit, pasi ju kemi shpjeguar dhe herën e parë gjatë observacionit të Akt Konstatimit është një arsyetim i pabazuar në Ligj dhe KTZ si mëposhtë:*

*Nga ana teknike ju e konsideroni bordurën e betonit një strukturë masive dhe i referoheni zërit të preventivit **3.243 Struktura monolite betoni C 16/20 (për shtresë trotuari) me vlerë 9000 lek m<sup>3</sup>** pra i referoheni një zëri pune që nuk ka armaturë në analizën e vetë sic është në fakt një strukturë e hollë dhe kërkon rreth 33.33 m<sup>2</sup> armaturë për 1m<sup>3</sup> beton.*

*Nje arsyetim teknik dhe ligjor i gabuar është pretendimi i këtyre bordurave të “parapërgatitur” nga ana juaj, pasi në asnjë dokument të projektit, preventivit dhe specifikimeve nuk përmendet një gjë e tillë.*

*Nje arsyetim ligjor është dhe se në preventivin fillestar është e specifikuar nr i analizës që i është referuar ky zëri punimi dhe është analiza **3.619/a Bordura betoni 6x20 cm** pra nuk është permasa e trete 80 cm dhe në kemi zbatuar zërin sipas zërit përkatës të manualit të ndërtimit .*

*Ne si zyrë jemi të licencuar dhe për hartim projektesh ku gjithmonë kur hartohet preventivi, po të kemi tre permatat të sakta atëherë ky ze punimi vendoset në njesinë copë dhe jo me ml.*

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit, merr në konsideratë argumentet dhe do ta reflektojë në tabelën e dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

**4. Zëri Ndërtim puseta betoni 1x1x1.5 m+kapak gize..**



(pusete e mbuluar me pllakat e trotuarit me kërkesën e banoreve)

*Në lidhje me këtë Opinion që ju përsëri kërkonti të mos rishikohet mendojmë që kemi zbatuar ligjin dhe KTZ, pasi si pjesë e dosjes së mbikqyresit dhe librit të kantierit janë:*

*libreza e masave (pjesë e dosjes)*

*foto gjate punimeve (foto më sipër)*

*proces verbal punime të maskuara (pjesë e dosjes)*

*Nga sa mësipër dhe observacionit të Akt Konstatimit mendojmë se i kemi zbatuar të gjitha kërkesat ligjore që duhen për evidentimin e një punimi, por fakti që është mbuluar me pllaka për mos hasur në konflikte sociale me banorët nuk do të thotë që ky punim nuk është realizuar. Kërkojmë rishikimin e këtij opinionit nga ana juaj, pasi kemi realizuar këtë zëri punimi. sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave.*

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit, merr në konsideratë argumentet dhe do ta reflektojë në tabelën e dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

**5. Zëri 1. Vijëzim shirita gjatësorë.**

*Në lidhje me këtë peretendim mendojmë se kemi qenë shumë të qartë në menaxhimin e një projekti të ndarë në zona pa koordinata ku ndahej zona nga zona, si dhe preventivi po ashtu i ndarë në 5 zona, por sic jemi shprehur duke pasur qëllim që volumet në total të preventivit mos të lëviznin duke ruajtur dhe strukturën e tij, kemi ruajtur vlerën totale të zërit të punës i cili është i matshëm në cdo moment si total dhe nuk ka diferencë. Kërkojmë të rishikohet ky opinion pasi nuk ka diferencë në sasi sic shpreheni ju në Draft Raport.*

Opiniononi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, sqaron se pretendimi i observuesit nuk ka asnjë bazë teknike, pasi libri i masave hartohet sipas faktit. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**2. “Rikonstrukcion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë”, Bashkia Patos.**

Kontratata

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë znj. R. B. dhe OE “A. K.” Shpk, me përfaqësues z. A. K., me licencë profesionale NZ..... Vlera e kontratës është 17,564,628 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1673/20 prot., datë 05.10.2022, është lidhur kontrata me OE “G... C.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh respektivisht MK. 2928/9 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 308,699 lekë me Tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 1623/25 prot., datë 23.12.2022, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. T. N. P.. me nr. licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....., dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 30,316 lekë me Tvsh. Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, nga grupi i punës me përbërje ing. A. M., ing. A. L. dhe ing. S. M., është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 23.01.2023.

Projektpreventivi

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin nr. 3/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i AK, zjn. R. B..

-Projekti i zbatimit është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Kontrollit të Zhvillimit dhe Projekteve në muajin dhjetor 2020 dhe është miratuar nga Bashkia Patos.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur më datë 05.10.2022 dhe kanë përfunduar më datë 23.12.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

-Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 2432/4 prot., datë 05.12.2022, titullari i AK, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin i bërë nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, janë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 1,178,074 lekë pa Tvsh dhe punime që pakësohen në vlerë 481,732 lekë pa Tvsh, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 696,343 lekë pa Tvsh.

Nga auditimi i preventivit të ripunuar, konstatohet se janë shtuar 2 zëra të rinj pune. Në dosjen teknike administrohet dokument për negocimin e këtyre zërave të rinj pune, në përputhje me UKM nr. 2, datë 15.02.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 8.3. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve.

Nga verifikimi në terren, konstatohet se janë vendosur bordura me dimensione 15 x 30 cm, nga 20 x 35 cm që është në projekt preventivin e pandryshuar të objektit. Vlera prej 135,720 lekë e 174 ml bordure, është përdorim pa efektivitet i fondeve buxhetore.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstrukcion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë”, Bashkia Patos</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 1673/19 prot datë 05.10.2022	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 17,564,628 lekë <b>BOE fitues “M. I. G.” Shpk&amp; “L. K.” Shpk</b>	<b>16.Likuiduar deri dt</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 14,636,523.3 lekë -Vlera pa tvsh 17,564,628 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 150 ditë , Zbatuar 79 ditë. Fillimi punimeve: 05.10.2022 Perfundimi punimeve : 23.12.2022	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka

<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “G.. C.” ShPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr 1673/20 prot, datë 05.10.2022	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Ing. T. N. P..	Licenca Nr: MK.....	Kontrata nr. 1623/25 prot., datë 23.12.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 19.01.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> nr. 1651/4 prot., datë 23.01.2023		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **754,952 lekë pa Tvsh**.

**39. Titulli i gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin “*Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë*”, Bashkia Patos, nga zbatuesi i punimeve BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, për zërat e punimeve A.1.1, A.2 (1+3+5) dhe A.3 (2+3+12).

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: “FV bordura betoni 150x 30” dhe “Transport materiale ndërtimi dhe dheu me auto deri në 7 km”, “Shtresë çakulli mbeturinë”, “Shresë binderi me granil gur kave t=5cm”, “Shtresë stabilizanti për bankinë”, etj, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

-Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1623/25 prot., datë 23.12.2022.

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1157/1 prot., datë 28.04.2021.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Patos.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 754,952 lekë pa Tvsh nga BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022, me objekt: “*Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë*”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 754,952 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. L. H. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. T. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

**3. “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, Bashkia Patos.**

Kontratata

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë znj. R. B. dhe OE “C. R.” Shpk, me përfaqësues z. A. K., me licencë profesionale NZ..... Vlera e kontratës është

30,588,573.6 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 98 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Me shkresën e mbikëqyrësit të punimeve, me nr. 2313/13 prot., datë 24.11.2022, është kërkuar shtyrja e afatit për shkak të moslirimit të sheshit dhe motit me shi. Pas kësaj kërkesë është nxjerrë Urdhri i titullarit të AK znj. R. B., nr. 2313/15 prot., datë 25.11.2022, për verifikimin e problematikave. Pas këtij Urdhri, është hartuar amendamenti i kontratës me nr 2313/19 prot., datë 27.12.2022, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 40 ditë nga data e nënshkrimit të amendamentit. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2324/56 prot., datë 19.09.2022, është lidhur kontrata me OE “D.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK..... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 532,981.75 lekë me Tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 2324/61 prot., datë 03.02.2023, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. T. N. P., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....., dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 61,240 lekë me Tvsh.

Në dosjen teknike, nuk administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit.

#### Projektpreventivi

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin nr. 3/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

-Projekti i zbatimit është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Kontrollit të Zhvillimit dhe Projekteve në vitin 2021 dhe është miratuar nga Bashkia Patos.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur më datë 30.09.2022, dhe kanë përfunduar më datë 04.02.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

-Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 2313/3 prot., datë 11.11.2022, titullari i AK, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin i bërë nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, janë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 4,929,392 lekë pa Tvsh dhe punime që pakësohen në vlerë 3,715,560 lekë pa Tvsh, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 1,213,832 lekë pa Tvsh. Nga auditimi i preventivit të ripunuar, konstatohet se janë shtuar 2 zëra të rinj pune. Në dosjen teknike administrohet dokument për negociimin e këtyre zërave të rinj pune, në përputhje me UKM nr. 2, datë 15.02.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 8.3. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, Bashkia Patos				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 2324/57 prot datë 19.09.2022	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 30,588,573.6 lekë <b>OE fitues “C. R.” ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 25,490,478 lekë -Vlera pa tvsh 30,588,574 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 98 ditë , Zbatuar 126 ditë. Fillimi punimeve: 30.09.2022 Përfundimi punimeve : 04.02.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendamenti nr 2313/19 prot, datë 27.12.2022, shtyrje 40 ditë	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> BOE “D.” ShPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr 2324/56 prot, datë 19.09.2022	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Ing. T. N. P...	Licenca Nr: MK.....	Kontrata nr. 2324/61 prot., datë 03.02.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Nuk administrohet në dosje	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> nuk ka		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të

kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **481,563 lekë pa Tvsh**.

**40. Titulli i gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, Bashkia Patos, nga zbatuesi i punimeve OE “C. R.” Shpk, për zërat e punimeve A-2 (4+5+6), A-3.8 dhe E.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: “Shtresë stabilizanti + Shtresë binderi + shtresë asfaltobetonit”, “Struktura të holla monolite për kunetë” dhe “Punime për sinjalistikën rrugore”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

-Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2324/56 prot., datë 19.09.2022.

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2324/61 prot., datë 03.02.2023.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Patos.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 481,563 lekë pa tvsh nga OE “C. R.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, me objekt: “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 481,563 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. V. T. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

#### **4. “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, Bashkia Patos.**

##### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019, të lidhur mes AK Bashkia Patos, të përfaqësuar nga Kryetare e Bashkisë znj. R. B. dhe BOE “G.” Shpk, me përfaqësues z. A. B., me licencë profesionale NZ..... & “A.” Shpk me përfaqësues z. N. C., me licencë profesionale NZ..... & “Sh.” Shpk me përfaqësues z. Y. B., me licencë profesionale NZ..... Vlera e kontratës është 85,964,816 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 180 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Është hartuar një amendament për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me nr. 2759/17 prot., datë 30.03.2020, me 30 ditë, për shkak të Covid 19.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1436/15 prot., datë 02.09.2019, është lidhur kontrata me OE “D.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK..... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,208,000 lekë me Tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 1067/23 prot., datë 20.05.2020, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. T. N. P. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....., dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 47,609 lekë me Tvsh.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 26.06.2020.

Projektpreventivi

-Projekti i zbatimit është hartuar nga Drejtoria e Hartimit dhe Aplikimit të Projekteve në Tetor 2014 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Patos.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 01.11.2019, dhe kanë përfunduar më datë 04.06.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.

-Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 2759/3 prot., datë 25.11.2019, titullari i Bashkisë Patos, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin i bërë nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, janë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 21,833,459 lekë pa Tvsh dhe punime që pakësohen në vlerë 17,701,898 lekë pa Tvsh, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 3,912,897 lekë me Tvsh.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti””, Bashkia Patos</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 1067/19 prot datë 24.09.2019	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 85,964,816 lekë <b>BOE fitues “G.” ShPK &amp; “A.” ShPK &amp; “Sh.” ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 85,961,801 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 68,708,168 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 180 ditë , Zbatuar 214 ditë. Fillimi punimeve: 01.11.2019 Përfundimi punimeve : 04.06.2020		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendamenti nr. 2759/17, datë 30.03.2020, shtyrje me 30 ditë	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> BOE “D.” ShPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr 1436/15 prot, datë 02.09.2019	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Ing. T. N. P..	Licenca Nr: MK.....	Kontrata nr. 1067/23 prot., datë 20.05.2020	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 26.06.2020	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> Datë 26.06.2020		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **748,586 lekë pa Tvsh**.

**41. Titulli i gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti””, Bashkia Patos, nga zbatuesi i punimeve OE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, për zërat e punimeve në shkollën ekzistuese A/4.6, A/6.3 dhe A/8 (9+28+29) dhe në palestër B/2.1 dhe B/3.2.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: “FV plintusesh gres porcelanat me t=10 cm, çmimi”, “FV dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rë, çmimi”, “Kangjella metalike për rrethimin e oborrit”, “Paralele h=175 cm”, “Rrethim i fushës me rrjet tel”, “Mur tulle t=20 cm” dhe “Beton C 25/30 për plinta (përfshirë trarët lidhës)”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

-Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1436/15 prot, datë 02.09.2019.

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1067/23 prot., datë 20.05.2020.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Patos.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 748,586 lekë pa Tvsh nga BOE "G." Shpk & "A." Shpk & "Sh." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019, me objekt: "Rikonstruksion i shkollës "Mustafa Matohiti", Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 748,586 lekë pa Tvsh sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. V. T. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. T. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

## 2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Bashkia Patos ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e KKT nr. 2, datë 28.12.2020, për lejet e ndërtimit të cilat aplikohet përpara miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, zbatohet Vendimi nr. 5, datë 07.03.2016, i KKT, për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore".

### Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022.

Referuar sistemit "e-Leje" për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Patos, gjatë periudhës 01.07.2019-31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.07.2019 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje			
Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i lejeve të miratuara
1	Certifikatë përdorimi	22	9
2	Deklaratëparaprake për kryerjepunimesh	140	117
3	Leje infrastrukture	15	11
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	17	9
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	4	4
6	Leje për ndryshim funksioni	0	1
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	4	1
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	1	1
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	0	0
11	Leje zhvillimi	72	35
12	Njoftim për fillim punimesh	26	19
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	0	0
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	9	6
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	12	5
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	3	2
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	3	2

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Referuar të dhënave vënë në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Patos, janë miratuar **30 leje ndërtimi**, ndër të cilat leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **5 leje ndërtimi**, leje



ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **2 leje** ndërtimi, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **9 leje** ndërtimi, ndërsa leje për shtesë në ndërtimin ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **6 leje** ndërtimi, **4 leje** ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni, **1 leje** ndërtimi për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, **1 leje** për ndryshim funksioni dhe **2 leje** ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni.

*Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet përmbledhja e listës së lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Patos, për periudhën 01.07.2019, deri më 31.12.2022:*

Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Nr. Prot. i aplikimit	Data e aplikimit	Aplikanti	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit
1	Rikonstruksioni i shkollës "Mustafa Matohiti" dhe shtesë palestire	1995	22/07/2019	Bashkia Patos	Bashkia Patos	Nr. 14 Datë 22/08/2019	1210	84,633,744
2	Shtesë objekti shërbimi 2 kate (zyra)	2108	3/8/2019	E. M.	F. Ch. A.	Nr. 16 Datë 17/09/2019	177.82	9,737,764
3	Rikonstruksioni i Bashkisë Patos	2497	15/10/2019	Bashkia Patos	Bashkia Patos	Nr. 17 Datë 15/10/2019	1190	28,319,240
4	Stallë për rritjederrash 1 kat b/a + metalike	3187	20/11/2019	A. K.	K. S.	Nr. 2 Datë 27/02/2020	960	36,770,380
5	Ndërtim kantineve 1 kat + bodrum beton arme	2607/8	15/12/2019	A. K.	B. G.	Nr. 21 Datë 13/01/2020	310	41,137,000
6	Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale	2688/3	20/12/2019	A. K.	D.	Nr. 1 Datë 03/02/2020	3160	28,707,090
7	Shtesë 1 kat mbi objekt ekzistues 1 kat banim	2630/5	27/02/2020	M. G.	A. D.	Nr. 3 Datë 06/05/2020	153.5	3,906,187
8	Stallë për rritjevecash	871	7/4/2020	A. K.	F.	Nr. 4 Datë 08/05/2020	840	-
9	Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore	846/8	28/06/2020	E. M.	M. S.	Nr. 6 Datë 13/08/2020	1750	10,506,933
10	Rikonstruksion dhe shtesë anësore i objekteve të shoqërisë F. Ch. A.	1574	6/7/2020	U. I.	F. Ch. A.	Nr. 5 Datë 03/08/2020	3633	10,244,550
11	Zgjerim magazine në ndihmë të aktivitetit të rritjes së derrave	913/9	7/8/2020	A. K.	M. P.	Nr. 8 Datë 09/10/2020	177.9	3,018,451
12	Shtesë anësore në objekt ekzistues	1953/6	23/10/2020	M. P.	F. S.	Nr. 9 Datë 23/10/2020	960	15,346,533
13	Shtesë një kat mbi një kat banimekzistues	3031	3/12/2020	M. G.	D. E.	Nr. 1 Datë 12/01/2021	190.46	3,914,918
14	Shtesë një kat banim mbi banesëekzistues 1 kat	1490	30/05/2021	Th. Xh.	Th. Xh.	Nr. 5 Datë 16/08/2021	213.2	4,864,207
15	Ndryshimin e destinacionit të pasurisë Nr.5/1+1-1 ZK.2890.	1809	15/07/2021	R. N.	R. N.	Nr. 4 Datë 19/07/2021	74.31	138,503
16	Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike.	1168/3	18/07/2021	A. K.	S. G.	Nr. 6 Datë 23/08/2021	275	6,200,866
17	Kapanon me konstruksion metalik me veprimtari shërbim	2695	15/10/2021	O. Gj.	A. H.	Nr. 2 Datë 10/02/2022	172.14	7,073,830
18	Shtesë 1 kat banimi mbi banesëekzistuese 1 kat	2696	17/10/2021	A. K.	F. Xh.	Nr. 3 Datë 11/02/2022	176.9	2,977,170
19	Ndërtim banese 1 kat + podrum	2708	21/10/2021	G.	V. M.	Nr. 7 Datë 10/11/2021	116	6,702,179
20	Ndërtim Fushe Sporti (Kalceto)	3171	6/12/2021	R. Gj.	E. B.	Nr. 8 Datë 17/12/2021	989	6,415,527
21	Ndërtim kapanoni me konstruksion metalik në pasurinë 12/1.	187	17/01/2022	E. Z.	A.	Nr. 4 Datë 21/02/2022	88.2	2,714,359
22	Ndërtimi i bazamentit të peshores dhe sistemimi i sheshitpërreth tij në stacionin e naftësVisokë.	386	1/2/2022	A. SHA	A. SHA	Nr. 1 Datë 10/02/2022	129.82	1,439,229
23	Godinëbanimi 1 kat	783	18/03/2022	M. G.	Th. G.	Nr. 8, datë 31/05/2022	181	5,523,428

24	Rikonstruksion me ndryshim funksioni nga apartament në njësi shërbimi	784	20/03/2022	M. G.	A. G.	Nr. 7, datë 26/04/2022	53.46	26,375
25	Zgjerim magazine në ndihmë të aktivitetit të rritjes së derrave	831	28/03/2022	T. N.	M. P.	Nr. 10, datë 29/04/2022	177.9	-
26	Rikonstruksion i kabinës elektrike Gr. 6	883	2/4/2022	K. P.	B. P. A.	Nr. 15, datë 21/07/2022	56	1,664,163
27	Rikonstruksion i kabinës elektrike Gr.24	882	2/4/2022	K. P.	B. P. A.	Nr. 14, datë 21/07/2022	56	1,181,219
28	Ndërtim kapanoni me konstruksion metalik në pasurinë 12/1	1231	9/5/2022	E. Z.	A.	Nr. 9 Datë 20/06/2022	88.2	2,714,359
29	Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore	1567	20/06/2022	A. M.	E. C.	Nr. 10, datë 12/07/2022	111.4	1,793,753
30	Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Shehu" dhe ndërtim palestere	3041	7/12/2022	Bashkia Patos	Bashkia Patos	Nr. 17, datë 07/12/2022	1474.55	95,394,560

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Në bazë të informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Patos për periudhën 01.07.2019, deri më 31.12.2022, janë dhënë **9 certifikata përdorimi**, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti	Nr. Prot.iapli kimit	Data e aplikimit	Aplikanti	Zhvilluesi	Vendimi për certifikatë
1	Stallë për rritjevijash	1883	9/8/2020	A. K.	F.	Nr. 1, Datë 28/08/ 2020
2	Ndërtim kantinevere 1 kat + bodrum beton arme	1824	16/07/2021	A. K.	B. G.	Nr. 29 Datë 22/07/2021
3	Stallë për rritjederrash 1 kat b/a + metalike	1844	18/07/2021	A. K.	K. S.	Nr. 36 Datë 27/07/2021
4	Shtesë 1 kat mbi një kat banimekzistues	2185	12/8/2021	B. A.	D. E.	Nr. 74 Datë 30/12/2021
5	2 kapanone 1 kat për rritjezogjsh	502	15/02/2022	A. K.	E.	Nr. 3 Datë 21/02/2022
6	Banesë 1 dhe 2 kate beton arme	844	29/03/2022	R.G.N.	S. Ç.	Nr. 15, Datë 26/05/2022
7	Banesë 1 kat beton arme	1346	25/05/2022	A. K.	N. K.	Nr. 17, Datë 17/06/2022
8	Rikonstruksion me ndryshim funksioni nga apartament në njësi shërbimi	2178	4/9/2022	A. M.	A. G.	Nr. 30, Datë 15/09/2022
9	Zgjerim magazine në ndihmë të aktivitetit të rritjes së derrave	831/5	10/10/2022	T. N.	M. P.	Nr. 66, Datë 18/10/2022

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit dhe dhënia e certifikatave të përdorimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m<sup>2</sup>:

Lekë

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit	Cerifikatë përdorimi
1	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	"Ndërtim kantinevere 1 kat + bodrum beton arme"	B. G.	Nr. 21 Datë 13/01/2020	41,137,000	Nr. 29 Datë 22/07/2021
2	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	"Stallë për rritjederrash 1 kat b/a + metalike"	K. S.	Nr. 2 Datë 27/02/2020	36,770,380	Nr. 36 Datë 27/07/2021
3	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale	D.	Nr. 1 Datë 03/02/2020	28,707,090	Nuk ka marrënde certifikatë përdorimi
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	"Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike"	"S. G."shpk	Nr. 6 Datë 23/08/2021	6,200,866	Objekti ka përfunduar punimet. Nuk ka bërë njoftim fillim punesh dhe nuk ka marrë certifikatë përdorimi
5	Leje ndërtimi për	"Shtesë anësore në objekt"	F. S.	Nr. 9 Datë	15,346,533	Objekti ka përfunduar

	shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	ekzistues”		23/10/2020		punimet. Nuk ka bërë njoftim fillim punesh dhe nuk ka marrë certifikatë përdorimi
6	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	“Banesë 1 kat beton arme”	N. .K e I. K.	Nr. 15 Datë 22/08/2019	5,752,009	Nr. 17, Datë 17/06/2022
7	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	“Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”	M. S.	Nr. 6 Datë 13/08/2020	10,506,933	Nuk ka bërë njoftim fillim punesh
8	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	“Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”	E. .Ç.	Nr. 10, datë 12/07/2022	1,793,753	Objekti ka përfunduar punimet. Nuk ka bërë njoftim fillim punesh dhe nuk ka marrë certifikatë përdorimi

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

*Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 5 praktika, në lidhje me moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimi të lejes të ndërtimit dhe zbatimit të punimeve.*

**42. Titulli i gjetjes:** Mos konvertimi i resursit të tokës “arë” në “truall” përpara miratimi të lejes të ndërtimit dhe zbatimit të punimeve.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në dokumentat e pronësisë të ngarkuar në sistemin “e-Leje”, statusi i tokës është “arë” dhe nuk është konvertuar në “truall” përpara miratimit të lejes së ndërtimit dhe fillimit të punimeve të ndërtimit, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. “Ndërtim kantineve 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë vendimi nr. 21, datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., Dukas, Patos. Bashkia Patos ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor në datën 28.12.2020. Për lejet e ndërtimit të cilat aplikohet përpara miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, zbatohet Vendimi nr. 5, datë 07.03.2016, i KKT, për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshmevendore”. Në bazë të pikës 3 përcaktohet si më poshtë: “Autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi për rastet përjashtimore të pikës 2, vetëm brenda zonave të urbanizuara, të identifikuar sipas Vendimit nr. 5, datë 29.12.2014, të KKT, me përjashtim të strukturave sipas gjermës “e”, për të cilat zbatohet VKM nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, e ndryshuar, me përjashtim të strukturave sipas gjermave “d”, dhe me përjashtim të banesave individuale/një familjare sipas pikës e), **me kushtin që toka ku do të ndërtohet të jetë me statusin aktual “truall”**. Në pikën 3/1 të këtij vendimi përcaktohet se: “Konvertimi nga resursi i tokës “arë” në “truall” për strukturat sipas gjermës “d” do të kryhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Duke u bazuar në VNM-në paraprake, në pikën 3.2, përcaktohet se vendimi është i vlefshëm pasi subjekti të bëjë ndryshimin e statusit të tokës, nga tokë arë, në tokë truall. Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin “e-leje”, prona ka statusin “arë” dhe nuk pasqyrohet dokumentacion tjetër për ndryshimin e statusit të pronësisë.

2. “Dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtoriale”, për të cilën është marrë vendimi nr. 1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, NJA Zharrëz, Patos. Në lejen e ndërtimit të miratuar, në pikën 2 përcaktohet që leja do të jetë e vlefshme vetëm pasi të bëhet konvertimi i resursit të tokës në truall, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në bazë të Vendimit nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, pika 3, në kushtet e mungesës së planit të përgjithshëm vendor: d) në rast se, si pasojë e verifikimeve në terren, rezulton që propozimi është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas këtij vendimi dhe dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi, kryetari i bashkisë merr vendim për miratimin e lejes së ndërtimit dhe i propozon Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

të vijojë procedurat për kalimin në sipërfaqe ndërtimore të tokës bujqësore, objekt i lejes së ndërtimit. Kjo ministri, më pas, harton projektvendimin, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave; dh) pas miratimit të kalimit të tokës bujqësore në sipërfaqe ndërtimore, bashkia i dorëzon kërkuesit dokumentin e lejes dhe e boton atë në regjistrin e integruar të planifikimit të territorit.

Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin “e-Leje”, prona ka statusin “arë” dhe nuk pasqyrohet dokumentacion tjetër për ndryshimin e statusit të pronësisë.

3.“Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., NJA Zharrëz, Patos. Leja e ndërtimit është miratuar përpara miratimit të Planeve të Përgjithshme Vendore. Në bazë të Vendimit nr. 1, datë 30.07.2015, dhe Vendimit nr. 5, datë 07.03.2016, i KKT, për disa shtesa dhe ndryshime “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshmevendore”, në pikën 3 përcakohet se: “Autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi për rastet përjashtimore të pikës 2, vetëm brenda zonave të urbanizuara, të identifikuara sipas vendimit nr.5, datë 29.12.2014, të KKT, me përjashtim të strukturave sipas gjermës e), për të cilat zbatohet VKM nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, e ndryshuar, me përjashtim të strukturave sipas gjermave d), dhe me përjashtim të banesave individuale/një familjare sipas pikës e), me kushtin që toka ku do të ndërtohet të jetë me statusin aktual “truall”. Në dokumentacionin e pronësisë, pjesa në të do të zhvillohet shtesa është me status “arë” dhe jo “truall”, jo në përputhje me vendimin nr.5, pika 3.

4.“Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë vendimi nr.17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Në zbatim të Vendimit nr. 5, datë 07.03.2016, i KKT, për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.1, datë 30.07.2015, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshmevendore”, autoritetet vendore mund të miratojnë leje ndërtimivetëm pasi të merret njoftimi për konformiteti nëpërmjet rrugëveelektronike nga dhe nga AZHT dhe nga Ministria e Zhvillimit Urban. Në bazë të Vendimit nr. 1, në pikën 2 dhe 3 përcaktohet si më poshtë: “Autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi për rastet përjashtimore të pikës 2 (në të cilat bëjnë pjesë edhe banesatindividuale/ njëfamiljare me sipërfaqë deri në 250 m<sup>2</sup>), vetëm brenda zonave të urbanizuara, të identifikuara sipas Vendimit nr. 5, datë 29.12.2014, të KKT, me përjashtim të strukturave sipas gjermës “e”, për të cilat zbatohet VKM nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dheblegtoriale, në tokë bujqësore”, e ndryshuar, me përjashtim të strukturave sipas gjermave “d”, dhe me përjashtim të banesave individuale/një familjare sipas pikës e), me kushtin që toka ku do të ndërtohet të jetë me statusin aktual “truall”. Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në aplikimin për leje ndërtimi, statusi i pronës është “arë” dhe nuk është konvertuar në “truall”.

5.“Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M. S., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Në mendimet e institucionit të paraqitur në lejen e ndërtimit AZHT, e cila jep konformitetin për miratimin e lejes së ndërtimit, zona nuk bën pjesë në rastet përjashtimore sipas Vendimit nr.1, dhe nuk bën pjesë brenda zonave të urbanizuara të miratuara me Vendimin nr. 5, por përcaktohet që duhet të vijoj konvertimi i tokës nga arë në truall, sipas legjislacionit në fuqi. Edhe në VNM-në paraprake përcaktohet në pikën 3.2, që vendimi është i vlefshëm vetëm pas ndryshimit të statusit të truallit. Gjithashtu edhe në lejen e ndërtimit të miratuar përcaktohet si më poshtë: “Kjo leje është e vlefshme vetëm pasi të bëhet konvertimi i resursit të tokës në truall pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”. Në bazë të Vendimit nr. 283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, pika 3, në kushtet e mungesës së planit të përgjithshëm vendor, në pikën dh përcaktohet se: “Pas miratimit të kalimit të tokës bujqësore në sipërfaqe ndërtimore, bashkia i dorëzon kërkuesit dokumentin e lejes dhe e boton atë në regjistrin e integruar të planifikimit të territorit”. Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin

“e-Leje”, prona ka statusin “arë” dhe nuk pasqyrohet dokumentacion tjetër për ndryshimin e statusit të pronësisë.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të Vendiminr. 5, datë 07.03.2016, i KKT, për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshëmeverdore”, pika 3 përcaktohet si më poshtë: “Autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi për rastet përjashtimore të pikës 2, vetëm brenda zonave të urbanizuara, të identifikuara sipas Vendimit nr. 5, datë 29.12.2014, të KKT, me përjashtim të strukturave sipas gjermës e), për të cilat zbatohet VKM nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, e ndryshuar, me përjashtim të strukturave sipas gjermave “d”, dhe me përjashtim të banesave individuale/një familjare sipas pikes “e”, me kushtin që toka ku do të ndërtohet të jetë me statusin aktual “truall”. Në pikën 3/1 të këtij vendimi përcaktohet se: “Konvertimi nga resursi i tokës “arë” në “truall” për strukturat sipas gjermës “d” do të kryhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

-Në bazë të Vendimit nr. 5, datë 29.12.2014, pika 9, përcakton se konvertimi nga tokë “arë” në tokë “truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Në bazë të Vendimit nr. 283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, pika 3, në kushtet e mungesës së planit të përgjithshëm vendor, në pikën dh përcaktohet se: pas miratimit të kalimit të tokës bujqësore në sipërfaqe ndërtimore, bashkia i dorëzon kërkesit dokumentin e lejes dhe e boton atë në regjistrin e integruar të planifikimit të territorit.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, ndikon në ndërtimin e objekteve në resursin e tokës “arë” dhe jo në resursin e tokës “truall”, duke cënua ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë dhe statusin e pronës që të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

*Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë, që nuk respekton e lartësinë e lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktura.*

**43. Titulli i gjetjes:** Mosrespektimi i lartësisë maksimale të lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktura sipas Vendimit nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar nuk respektohet lartësia maksimale e lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratua për leje ndërtimi, me objekt: “Stallë për rritje derrash 1 kat b/a+metalike”, për të cilën është marrë vendimi nr. 2, datë 27.02.2020, me zhvillues K. S., në Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Lartësia maksimale e lejuar e objektit në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktura është 4,5 metra. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin “e-Leje”, në prerjen tërthore evidentohet që lartësia e objektit është 5.3 metra, duke tejkaluar lartësinë e lejuar.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të Vendimit nr. 283, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale, në tokë bujqësore”, Kreu II.b, pika 4, përcaktohet se: “Për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 10 metër, ndërsa karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3”.

Ndërsa në Kreun II.b, Pika 3 përcakton:

a) Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:

- 20 metër nga kufijtë e pronës;
- 500 metër nga qendrat e banuara;
- 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

b) Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 4,50 m;

c) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 0.5 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>.

**Ndikimi:** Tejkalimi i lartësisë në ndërtimit ndikon në mosrespektimin e lartësisë së lejuar të tipologjisë së ndërtimit, duke rritur vëllimin e objektit dhe rritjen e intensitetit të ndërtimit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar lartësisë të lejuara të strukturës së ndërtimit, në përputhje me rregulloren dhe kriteret e përcaktuara.

*Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë, me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e tregueve të zhvillimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.*

**44. Titulli i gjetjes:** Mos përcaktimi i saktë i numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e tregueve të zhvillimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në planvendosje dhe në të dhënat e treguesve të parametrave të zhvillimit, nuk pasqyrohej saktë numri i kateve dhe lartësia e objektit sipas projektit të ndërtimit.

Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., me adresë NJA Zharrëz, Patos. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 1 kati. Duke u bazuar në projektin e ndërtimit, objekti zhvillohet në lartësinë 7.6 metra, duke tejkeluar lartësinë e 1 kati. Ndonëse në rastet kur kati përdhe shfrytëzohet për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysheme, dysheme është 5.00 m, objekti e tejkalon lartësinë me 2.6 metra. Duke ju referuar edhe objektit ekzistues 2 kate që zhvillohet në të njëjtën lartësi me shtesën e propozuar, objekti i propozuar është 2 kate.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 408:

Pika 1 e nenit 37, që përcakton se; “ për llogaritjen apo vlerësimin sipas përcaktimve të kësaj rregulloreje, lartësia e ndërtimeve shprehet gjithmonë njëkohësisht në numër katesh dhe metra”.

Pika 3/a e Nenit 37, përcakton se: “ lartësia dysheme-dysheme është 3.00 m, për objektet industriale është, minimalisht, 3,5 (tre presjepesë) m”.

Pika 3/c e Nenit 37, përcakton se: “ kati përdhe, në rastet kur shfrytëzohet për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysheme - dysheme është 5.00 m”.

**Ndikimi:** Mosparaqitja e saktë e numrit të kateve në planvendosje, tek të dhënat e treguesve të parametrave të zhvillimit, ndikon në parametrat e zhvillimit dhe në respektimin e distancave nga kufiri i pronës dhe ruajtjen e distancave ndërmjet objekteve. Ndryshimi i të dhënave për numrat e kateve ndikon në elementët e mëposhtëm:

- lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re;
- normat e lejuara të distancave;
- vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë;
- diellëzimin dhe orientimin;
- respektimin e normave mjedisore

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit.

*Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë, me mosparaqitjen e saktë të rilevimit topografik duke pasqyruar gjendjen ekzistuese të parcelës dhe objekteve të tjera që zhvillohen në të.*

**45. Titulli i gjetjes:** Mosparaqitja e saktë e rilevimit topografik duke pasqyruar gjendjen ekzistuese të parcelës dhe objekteve të tjera që zhvillohen në të.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin “e-Leje”, në rilevimin topografik nuk pasqyrohej gjendja e reale e parcelës dhe nuk evidentohet ndërtimi ekzistues i gjendur në parcelë.

Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos.

Duke u bazuar në planvendosjen e miratuar dhe në rilevimin topografik, në parcelë nuk ka ndërtime. Por nga verifikimi i fotove ajrore dhe nga portali “A.”, evidentohet që parcela është e ndërtuar dhe ka edhe një objekt të ndërtuar në të. Dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me gjendjen reale të parcelës në terren.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me pikën “c” të nenin 15 të VKM nr. 408, “*plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese*”;

**Ndikimi:** Mospasqyrimi i saktë dhe me të gjithë elementët e ndërtimit të gjendjes ekzistuese, ndikon në zhvillimin e parcelës e në treguesit e zhvillimit dhe cënimin e tokës bujqësore.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar me vëmendje përputhshmërinë ndërmjet gjendjes ekzistuese dhe dokumentacionit të ngarkuar në sistem.

*Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë, në lidhje me mosparaqitja në sistemin “e-Leje” të marrëveshjes me pronarin e tokës dhe ndërmjet palëve të treta, në bazë të legjislacionit në fuqi.*

**46. Titulli i gjetjes:** Mosparaqitja në sistemin “e-Leje” të marrëveshjes me pronarin e tokës dhe ndërmjet palëve të treta, në bazë të legjislacionit në fuqi.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin “e-Leje”, nuk paraqitet marrëveshja me pronarin e tokës dhe ndërmjet palëve të treta. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos.

Objekti zhvillohet në një tokë “arë”, në ZK 2890 dhe nr. pasurie 102/4 në pronësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe me një kontratë qeraje për një periudhë 90 vjeçare. Në dokumentacionin e pronësisë të ngarkuar në sistemin “e-Leje” nuk është paraqitur kontrata e qiramarrjes ndërmjet “S. G.” Shpk, dhe Ministrisë së Bujqësisë, e cila përcakton kushtet e zhvillimit të kontratës dhe kryesisht zbatimi i ligjit për mbrojtjen e tokës bujqësore. Ky dokumentacion është paraqitur nga ana e DPZHT-së Patos, pasi disponohej prej tyre, por nevojitej të ngarkohej edhe në sistemin “e-Leje”.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me pikën “b” të nenin 15 të VKM nr. 408, ku përcaktohet se: “*Në dokumentacionin që nevojitet për miratimin e lejes së ndërtimit duhet të paraqitet edhe marrëveshja me pronarin e tokës dhe e palëve të treta, si më poshtë: Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*”.

**Ndikimi:** Mospasqyrimi i saktë dhe me të gjithë elementët e ndërtimit të gjendjes ekzistuese, ndikon në zhvillimin e parcelës e në treguesit e zhvillimit dhe cënimin e tokës bujqësore.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar në sistemin “e-Leje” paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për paramiratimit të lejes së ndërtimit.

*Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.*

**47. Titulli i gjetjes:** Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos. Në dokumentat e ngarkuar në sistemin “e-Leje”, mungojnë mendimet e institucioneve. Gjithashtu edhe në lejen e zhvillimit të miratuar, nuk janë marrë mendimet e institucioneve.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me:

Pikën 1 të Nenit 10/1 të VKM nr. 408, ku përcaktohet se: “Autoriteti vendor përgjegjës dhe sekretariati i KKT-së, sipas fushës përkatëse të kompetencës: a) shqyrtojnë kërkesën për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nëse pasuria për të cilën kërkohet leja e zhvillimit ndodhet në zona apo është objekt me kufizime apo kushtëzime të veçanta sektoriale, për shkak të vlerave monumentale, arkeologjike, natyrore apo mjedisore;

b) marrin vetë, kryesisht, dhe administrojnë, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, të gjithë dokumentacionin apo informacionin e nevojshëm nga ASHK, sipas rastit;

c) sigurojnë përditësimet e infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, atyre elektrike, telefonike, të pikave të depozitimit të mbetjeve, intensitetin e studimit sizmologjik, si shërbim me një ndalesë.

Pikën “3” të nenin 14 të VKM-së nr. 408, përcaktohet se: “Lejet e ndërtimit jepen vetëm pasi janë marrë lejet dhe autorizimet përkatëse për ndërtimin në fjalë, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi”.

**Ndikimi:** Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi ndikon në miratimin e lejes së ndërtimit pa qenë në konformitet me legjislacionin në fuqi.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe konformitetin përpara miratimit të lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit.

**48. Titulli i gjetjes:** Mospërputhja ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar tipologjia e ndërtimit nuk përkon me tipologjinë e objekteve të lejuara në njësinë në të cilën zhvillohet, për ndërtimi e objektit: “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Patos.

Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 28.12.2020, objekti bën pjesë në njësinë strukturore PT\_B\_B2\_22/1. Kategoria e zhvillimit të njësisë është B. Tokë bujqësore 78 % dhe EB Ekonomi Bujqësore 22%. Objekti ka marrë lejen e ndërtimit në datë 12.07.2022. Nga verifikimi i zbatimit të lejes së ndërtimit në terren evidentohet që tipologjia e objektit nuk përkon me tipologjinë e objekteve të lejuara në zonë dhe nuk është në funksion të bujqësisë por të ofrimit të shërbimit (bar-kafe).

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Në zbatim të kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar përcaktohet në pikën 6 dhe në pikën 7:

6. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit dhe inspektoriatit përkatës në fushën e ndërtimit.

7. Në shkelle të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në prishje të saj.

**Ndikimi:** Mungesa e verifikimit të zbatimit të punimeve dhe aktkontrolleve në fazat gjatë zbatimit të objektit, ndikon në ndërtimin e tipologjisë së objektit në mospërputhje me njësinë në të cilën zhvillohet.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.



**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të ndjekuar zhvillimin e lejeve të miratuara edhe gjatë fazave të zbatimit, në mënyrë që tipologjia e ndërtimit dhe objekti të jetë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

*Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatuan 4 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë lidhur me mungesën e pajisjes me “Certifikatë përdorimi” të objektit pasi ishte në përdorim.*

**49. Titulli i gjetjes:** Mungesa e pajisjes me “Certifikatë përdorimi” të objektit me leje ndërtimi në përdorim.

**Situata:** Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatua që mungonte “Certifikatë përdorimi” e objekteve që ishin në përdorim, evidentuar në rastet e mëposhtme:

1. “Dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë Vendimin nr. 1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, NJA Zharrëz, Patos. Nga verifikimi i objekteve në terren, objektet janë në përdorim, pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

2. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos. Nga verifikimi i objektit në terren dhe nga foto ajrore konstatohet që realizimi në terren nuk përputhet me planvendosjen e miratuar, duke u pozicionuar në kufi me pronën pa ruajtur distancën e nevojshme, në përputhje me planvendosjen e miratuar. Gjithashtu konstruksioni i objektit nuk përputhet me projektin e ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, objektit është realizuar me kolona dhe trarë betoni dhe ndarja me mure tulle, në lartësinë e dy kateve. Në projektin e ndërtimit të miratuar objekti paraqitet me konstruksion metalik. Ndonëse objekti ka përfunduar punimet dhe është në përdorimin, mungon njoftimi i fillimit të punimeve në sistem dhe pajisja me certifikatë përdorimi.

3. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., NJA Zharrëz, Patos. Nga verifikimi i objektit në terren evidentohet që objekti ka përfunduar punimet dhe është në përdorim, pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

4. “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Patos. Nga verifikimi i objektit në terren evidentohet që objekti ka përfunduar punimet dhe është në përdorim.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi: si më poshtë vijon:

Neni 50 të Ligjit nr. 107/2014, ku përcaktohet që: *“Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësisë, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit”.*

Pika “g” e neni 50 të Ligjit nr. 107/2014, ku përcaktohet që: *“përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit”.*

Neni 27/2 e VKM-në nr. 408, *“mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi”.*

**Ndikimi:** Përdorimi i objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, ndikon në verifikimin e përputhshmërisë së objektit me lejen e ndërtimit të miratuar, mungesën e akteve të kontrollit të objektit gjatë punimeve të ndërtimit, duke ndikuar konformitetin e realizimit të punimeve, në sigurinë dhe në qëndrueshmërinë e objektit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Patos të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejojë përdorimin e objekti pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

*Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatuan 2 praktika në të cilat, zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara.*

**50. Titulli i gjetjes:** Miratimi i certifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar dhe zbatimin e punimeve në terren.

**Situata:** Nga auditimi i procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar nuk përputhej me zbatimin në terren të objektit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura me objekt:

**1.** “Ndërtim kantine vere 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr.21, datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., Dukas, Patos. Objekti është pajisur me certifikatë përdorimi me Vendimin nr. 29, datë 22.07.2021. Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistemin “e-Leje” objekti është certifikuar pa përfunduar punimet e ndërtimit, në bazë të fotove të bashkëngjitur dosjes. Bashkëngjitur evidentohen foto të objektit të marrë në dorëzim, me punime të papërfunduara. Nga verifikimi në terren i objektit të përfunduar evidentohet që është realizuar në lartësinë e dy kateve mbi tokë dhe një kati nëntokë, pasi lartësia e ndërtimit është dy herë më e lartë se lartësia e projektit të ndërtimit dhe e përshkruar në certifikatën e përdorimit, duke tejkaluar lartësinë dhe vëllimin e lejuar të godinës.

**2.** “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K. Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Objekti ka marrë certifikatë përdorimi me Vendimin nr. 17, datë 17.06.2022, në kundërshtim me lejen e ndërtimit dhe me legjislacionin në fuqi. Nga verifikimi i fotove në terren dhe fotove të ngarkuara në sistemin “e-Leje” përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, evidentohet që në fasadën lindore është realizuar një dalje konsol dhe është shtuar një çarje në ndryshim nga projekti i ndërtimit, të pasqyruar më poshtë. Ndërsa në fasadën jugore nuk janë realizuar thyerjet e volumeve të objektit, duke e trajtuar në një linjë faqen dhe duke shtuar volum dhe sipërfaqe ndërtimi. Realizimi i objektit nuk përkon me projektin e ndërtimit të miratuar. Konfigurimi i gjurmës së ndërtimit është i ndryshëm nga projekti i ndërtimit.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pikat 3 e 4 e Nenit 42 të Ligjit nr. 107/2014, ku përcaktohet si më poshtë:

Pika 3. “*Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor*”.

Pika 4. “*Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afatikohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi*”.

Pika “c” e nenit 29 të Ligjit nr. 107/2014, “*dhënien e certifikatës së përdorimit, sipas nenit 42 të këtij ligji*”

Pika 3 e Nenit 27/1 e 27/2 të VKM-në nr. 408,

Pika 3 e Nenit 27/1, përcakton që: “*Autoriteti vendor mund të verifikojë konformitetin e akteve të kontrollit sipas shkronjave “a”, “c”, “ç” dhe “dh”, të pikës 1, sipas gjendjes faktike të objektit, brenda 15 ditëve pune nga depozitimi i tyre. Në mungesë verifikimi nga autoriteti vendor, brenda afatit të mësipërm, subjekti ndërtues mund të kalojë në fazën vijuese. Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollin e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle*”.

Neni 27/2, “*përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi*”.

**Ndikimi:** Zbatimi i realizimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në bazë të rregullores dhe sipas legjislacionit në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrevë të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Patos të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

**Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:** znj. R. B., me detyrë Kryetari i Bashkisë Patos; z. L. Ç., me detyrë Drejtor i Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, nga periudha 26.09.2019 e në vijim; znj.E. R., me detyrë specialist urbanist, nga periudha 05.12.2014 deri në 02.12.2022; znj.I. Sh., me detyrë specialist urbanist, nga periudha 04.11.2017 deri në 21.09.2022; znj. A. P., me detyrë Nënkryetare e Bashkisë, nga periudha 26.09.2019 e në vijim; z. V. N., me detyrë Drejtor i Monitorimit të Politikave dhe Shërbimeve, deri në 31.12.2021, me detyrë Drejtor i Monitorimit të Politikave dhe Shërbimeve, deri në 31.12.2021; z. A. L., me detyrë përgjegjës i shërbimeve, nga periudha 11.01.2016 e në vijim, me detyrë përgjegjës i shërbimeve, nga periudha 11.01.2016 e në vijim; z. Sh. B., me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore për periudhën 05.11.2014-31.12.2019 dhe me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, nga periudha 01.01.2020 e në vijim; znj. S. T., me detyrë përgjegjëse e projekteve, për periudhën 04.04.2018, me detyrë përgjegjëse e projekteve, për periudhën 04.04.2018; z. A. M., me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes Urbane dhe Rurale, për periudhën 11.11.2013-31.12.2021, dalë në pension;

*Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 8 praktika, në lidhje me mosparaqitja e mënyrës së llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë në njoftimin për pagesën e taksës.*

**51. Titulli i gjetjes:** Mosparaqitja e mënyrës së llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë në njoftimin për pagesën e taksës.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në njoftimin për pagesën e taksës nuk paraqitej mënyra e llogaritjes së taksës. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. “Ndërtim kantineve 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 21, datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.
2. “Stallë për rritje derrash 1 kat b/a+metalike”, për të cilën është marrë Vendimi nr.2, datë 27.02.2020, me zhvillues K. S., në Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.
3. “Dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, NJA Zharrëz, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.
4. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.
5. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., NJA Zharrëz, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.
6. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.
7. “Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M. S., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.
8. “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr.10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Verbas, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Neni 27 i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, "Taksa e ndikimit në infrastrukturë".

Neni 46 e Ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", "Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja":

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritjet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

**Ndikimi:** Mosparaqitja e mënyrës së llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë ndikon në mungësi të transparencës dhe në verifikimin e saktësisë në llogaritjet e taksës.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Patos.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren masa që në njoftimin për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë të pasqyrohet mënyra e llogaritjes së saj dhe jo vetëm tarifa që nevojite të likujdohet.

**Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:** znj. R. B., me detyrë Kryetar i Bashkisë Patos; z. L. Ç., me detyrë Drejtor i Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, nga periudha 26.09.2019 e në vijim, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, nga periudha 26.09.2019 e në vijim; znj. A. K., me detyrë Nënkyetare e Bashkisë, nga periudha 26.09.2019 e në vijim; znj. I. Sh., me detyrë specialiste juriste, nga periudha 04.11.2017 deri në datën 21.09.2022; z. Rr. B., me detyrë specialist i menaxhimit të aseteve, nga periudha 05.01.2010-05.01.2021.

*Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/16 prot., datë 25.05.2023, është observuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë Patos, i ngritur me urdhër të Kryetares së Bashkisë, znj. R. B., nga znj. A. P., nga z. Sh. B., nga znj. S. T., nga z. A. L., nga znj. I. Sh., me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me shkresën nr. 312/17.1 prot., datë 31.03.2023, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. Përsa më sipër, pretendimet nuk merret në konsideratë.*

## 2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

1. Në lidhje me plotësimin e kriterëve arsimore të punonjësve të IMT-së, sipas përcaktimeve të nenin 11 të Ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme" janë konstatuar:

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, të paraqitur në tabelën e mëposhtme, tre inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Data e fillimit
1	A. G.	Kryeinspektor i IVMT	Universiteti Jo Publik "K." dega Drejtësi dhe Shkenca Sociale	01.07.2021- e në vijim
2	B.B.	Kryeinspektor i IVMT	Shkolla e Lartë e Punëve të Brendshme (Profili i sigurimit)	23.12.2013-01.07.2021 Dalë në pension
3	D. L.	Inspektor	Shkolla e Mesme Ushtarake të Oficerëve (Me titull oficerë rezervist)	10.12.2013
4	Xh. C.	Inspektor	Universiteti Jo Publik "K." Me diplomë Bachelor në Menaxhim Biznesi	15.09.2016

*Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.*

**52. Titulli i gjetjes:** Mosplotësimi i kriterëve arsimore i punonjësve të IVMT-së.

**Situata:** Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, tre inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë, të evidentuar më poshtë: 1. z. D. L. me pozicion inspektor ka përfunduar shkollën e Mesme Ushtarake të Oficerëve me titull oficerë rezervist; 2. z. Xh. C. me pozicion inspektor ka diplomë bachelori në Menaxhim Biznesi; 3. z. B. B. me pozicion ish-kryeinspektor ka përfunduar studimet në Shkollën e Lartë të Punëve të Brendshme.

**Kriteri:** Ligji nr.183/2014, datë 24.12.2014, neni 11, ku përcaktohet që: “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit”.

**Ndikimi:** Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e Bashkisë Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga Bashkisë Patos të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Në raport me vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje dhe ekzekutimin e vendimeve të IVMT, janë pasqyruar më poshtë të dhënat e vendosura në dispozicion nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

-**Për vitin 2019**, janë mbajtur 46 akte-kontrolle, 0 proces-verbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre është nxjerrë 1 vendim me gjobë në vlerën 50,000 lekë gjobë për punime në të cilat kërkohet leje ndërtimi, vendimepezellimi 3, për të njëjtënperiudhë IVMT ka nxjerrë 21 vendime për prishje objketesh për lirime hapësira publike të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike, si dhe 3 PV ekzekutimi të prishjeve.

-**Për vitin 2020**, janë mbajtur 38 akte-kontrolle, 2 proces-verbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre është nxjerrë 1 vendim me gjobë në vlerën 50.000 lekë gjobë për punime në të cilat kërkohet leje me deklarata paraprake, vendime pezullimi 2, për të njëjtën periudhë IVMT ka nxjerrë 1 vendime për prishje objketesh për lirime hapësira publike të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike si dhe 1 PV ekzekutimi të prishjeve.

-**Për vitin 2021**, janë mbajtur 69 akte-kontrolle, 7 proces-verbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre është nxjerrë 5 vendim me gjobë në vlerën 350,000 lekë gjobë për punime në të cilat kërkohet leje ndërtimi, vendime pezullimi 3, për të njëjtën periudhë IVMT ka nxjerrë 38 vendime prishje objketesh për lirime hapësira publike të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike si dhe 4 PV ekzekutimi të prishjeve.

-**Për vitin 2022**, janë mbajtur 18 proces-verbale konstatimi, vendime gjobe 0, vendim pezullimi 0, për të njëjtën periudhë IVMT ka nxjerrë 13 vendime prishje objketesh për lirime hapësirave publike të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike, PV ekzekutimi të prishjeve 0.

Më poshtë pasqyrohet tabela e vendimeve “Për prishje objekti”, për periudhën 01.07.2021-31.12.2021 dhe vendimet e ekzekutuara.

Nr.	Subjekti	Nr. data e vendimit	Ekzekutuar	Në total
1	K. M.	Urdhër nr. 2561/2 prot., datë 25.10.2019	Po	12
2	Mure rrethueslagja e Reikj0jhjhh	Urdhër nr. 2675 prot., datë 09.10.2019	Po	1
3	Lirim hapësire publike Unaza qytetit	Urdhër nr. 2675 prot., datë 09.10.2019	Po	1
4	Prishje mure rrethues (Novosel Zharrëz)	Urdhër nr. 2085prot., datë 31.07.2019	Po	7
5	Për lirimin e hapësirave publike “GrizëLënginas”.	Urdhër nr. 1223 prot., datë 02.06.2020	Po	1
6	Për prishjen e hapësirave publike lagja “Naftëtari”	Urdhër nr.1543/1 prot., datë 16.06.2021	Po	1
7	Për lirimin e hapësirave publike “29 marsi”	Urdhër nr. 2239 prot., datë 01.09.2021	Po	30
8	Prishje objekti shtesë	Urdhër nr. 2322 prot.,datë 09.09.2021	Po	1
9	Për lirimin e hapësirave publike “shtesë” “29 marsi”	Urdhër nr. 2239/1 prot., datë 01.09.2021	Po	6
10	Për prishjen e hapësirave publike lagja “Naftëtari”	Urdhër nr. 1543/1 prot., datë 16.06.2021	Po	1
11	Për prishjen e objekti lagjia e Re	Urdhër nr. 2518 prot., datë 11.10.2022	Po	1
12	Për lirimin e hapësirave publike “29 marsi”	Urdhër nr. 140/1 prot., datë 25.01.2022	Po	1
13	Për lirimin e hapësirave publike “29 marsi” shtesë	Urdhër nr. 141 prot., datë 14.01.2022	Po	1
14	Për lirimin e hapësirave publike “Dukas Breg”	Urdhër nr.2399 prot., datë 29.09.2022	Po	8

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

3. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT. Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT. Më poshtë pasqyrohet tabela e vendimeve “Dënim me gjobë”, për periudhën 01.07.2019-31.12.2022, të palikujduara.

Lekë

Nr.	Subjekt	Nr. data e vendimit	Arsyeja/Shkaku i gjobës	Vlera e gjobës	Situata aktuale e gjobës			Totali i gjobave të pa likuiduara
					Likuiduar	Proces gjyqësor	Pa likuiduar	
1	M. M.	Nr. 18, datë 30.08.2019	Dalje nga leja	50,000	Jo	Jo	Po	50,000
2	T. G.	Nr. 20, datë 08.09.2020	Dalje nga vetëdeklarimi	50,000	Jo	Jo	Po	50,000
3	A. D.	Nr. 01, datë 16.03.2021	Punime të pa deklaruar	150,000	Po	Jo	Jo	-
4	F. G.	Nr. 21, datë 19.05.2021	Ndërtim pa leje	50,000	Jo	Jo	Po	50,000
5	L. M.	Nr. 22, datë 24.05.2021	Ndërtim kati i dytë	50,000	Po	Jo	Jo	-
6	Sh. M.	Nr. 23, datë 15.11.2021	Ndërtim soletekatidytë	50,000	Jo	Jo	Po	50,000
7	S. T.	Nr. 24, datë 12.11.2021	Prishje strukture toke	50,000	Po	Jo	Jo	-
<b>TOTALI</b>				<b>450,000</b>	<b>250,000</b>			<b>200,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Patos gjatë periudhës 01.07.2019-31.12.2022, ka marrë 7 vendime për “Dënim me gjobë”, të cilat janë të pa mbledhura e të pa ekzekutuara, me një vlerë të debisë për 4 vjet në vlerën 200,000 lekë.

**53. Titulli i gjetjes:** Moslikujdimi i gjobave të vendosura nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Patos.

**Situata:** Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Patos, gjatë periudhës 01.07.2019-31.12.2022, ka marrë 7 vendime për “Dënim me gjobë”, të cilat janë të pa mbledhura e të pa ekzekutuara, me një vlerë të debisë për 4 vjet në vlerën 200,000 lekë.

**Kriteri:** Neni 5 i Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe Nenet 9 e 22 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Patos nga mos pagesa e gjobave të vendosura nga IMTV.

**Shkaku:** Mos zbatim i legjislacionit nga IVMT për ndjekjen e hapave ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundërkundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 200,000 lekë. Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguanë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

**Për sa më lart, për vendimet e gjobave të pa arkëtuara mbajnë përgjegjësi:** znj. R. B., me detyrë Kryetaree Bashkisë Patos; z. A. G., me pozicion Kryeinspektori IVMT Patos, nga periudha 01.07.2021; z. B. B., me pozicion inspektor i IVMT-së Patos, 23.12.2013-01.07.2021, dalë në pension; z. A. M., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

**3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi.**

Në bazë të Rregullores “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendorenë administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Patos”, neni 44, Inspektoriati ndërtimor urbanistik, përgjegjësitë e INU-së janë: 1. Të mbajë nënkontroll territorin urban të bashkisë, në funksion të zbatimit të planit rregullues të qendrave të banuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi; 2. Të ndërhyjë në të gjitha rastet kur vëren shkelje të ligjit për urbanistikën dhe të ndalojë e më pas të vendosë për prishjen e çdo ndërtimi pa leje dhe në kundërshtim me planin e përgjithshëm rregullues të qytetit.

Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 5 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimit në terren sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

**54. Titulli i gjetjes:** Mospërputhja ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimit në terren.

**Situata:** Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara u konstatuan rritja e numrit të kateve të objekteve, shtim volumesh anësore dhe ndryshime destinacioni nga tipologjia e ndërtimit të miratuar. Me ndryshimet e evidentuara gjatë realizimit të punimeve në terren, ndërtimet nuk zbatojnë lejet e ndërtimit të miratuara dhe nuk respektojnë kondicionet urbane të lejuara në njësinë përkatëse sipas rregullores së planifikimit të territorit në fuqi.

1. “Ndërtim kantine vere 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr.21, datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., në adresën Dukas, Patos. Nga verifikimi në terren i objektit të përfunduar evidentohet që është realizuar në lartësinë e dy kateve mbi tokë dhe një kati nën tokë, pasi lartësia e ndërtimit është dy herë më e lartë se lartësia e projektit të ndërtimit dhe e përshkruar në certifikatën e përdorimit, duke tejkaluar vëllimin e lejuar të godinës. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Patos, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

2. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos. Nga verifikimi në terren i objektit të përfunduar evidentohet që është realizuar me kolona e trarë betoni dhe ndarja me mure tulle, në lartësinë e dy kateve. Në projektin e ndërtimit të miratuar objekti paraqitet me konstruksion metalik. Duke u bazuar në Vendimin nr. 283, datë 01.04.2015, distanca nga kufiri i pronës është 7 metra, por realizimi në terren nuk përputhet me planvendosjen e miratuar, duke u ndërtuar në kufi me pronën pa ruajtur distancën e nevojshme. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Patos, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit dhe përdorimin e tij pa marrë certifikatë përdorimi.

3. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Realizimi i objektit nuk përkon me projektin e ndërtimit të miratuar. Konfigurimi i gjurmës së ndërtimit është i ndryshëm nga projekti i ndërtimit. Nga verifikimi i fotove në terren dhe fotove të ngarkuara në sistemin e-leje, evidentohet që në fasadën lindore është realizuar një dalje konsol dhe është shtuar një çarje në ndryshim nga projekti i ndërtimit, të pasqyruar më poshtë. Ndërsa në fasadën jugore nuk janë realizuar thyerjet e volumeve të objektit, duke e trajtuar në një linjë faqen dhe duke shtuar volum dhe sipërfaqe ndërtimi. Objekti ka marrë certifikatë përdorimi me Vendimin nr. 17, datë 17.06.2022, në kundërshtim me lejen e ndërtimit dhe me legjislacionin në fuqi. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Patos, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit.

4. “Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M. S., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Nga verifikimi i punimeve të ndërtimit në terren, realizimi i objektit nuk përkon me projektin e ndërtimit të miratuar, pasi forma e konstruksionit dhe lartësia e ndërtimit është e ndryshme. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Patos, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit dhe përdorimin e tij pa marrë certifikatë përdorimi.

5. “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Verbas, Patos. Nga verifikimi i punimeve të ndërtimit në terren, realizimi i objektit nuk përkon me projektin e ndërtimit të miratuar. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Patos, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit dhe përdorimin e tij pa marrë certifikatë përdorimi.

**Kriteri:** Neni 51 i Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi” përcaktohet që:

1. Inspektimi ka për mission garantimin dhe mbrojtjen e interes kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimit të drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësi, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.

Nenet 5 e 12 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ku përcaktohet që:

Neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, “Gjatë ushtrimit të përgjegjësi të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme:

a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

b) vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

Neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”, ku përcaktohet që: “Për ushtrimin e përgjegjësi dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrorjnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e ndërtimit janë të detyruar të ndihmojnë në kryerjen e kontrollit, si dhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Kryeinspektori/ inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbajtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar, kur ky i fundit është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar”.

**Ndikimi:** Zbatimi i realizimit të punimeve të ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në PPV të miratuar dhe në legjislacionin në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e IVMT Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë në mënyrë konstante çdo problematikë që konstatohet nga kontrolli i kryer dhe duke ekzekutuar vendimet e marra.

Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan 3 praktika, në lidhje me përdorimin e objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi dhe ndryshimi i destinacionit të përdorimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit të miratuar.



**55. Titulli i gjetjes:** Përdorimi i objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi dhe ndryshimi i destinacionit të përdorimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit të miratuar.

**Situata:** Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara u konstatuan rritja e numrit të kateve të objekteve, shtim volumesh anësore dhe ndryshime destinacioni nga tipologjia e ndërtimit të miratuar. Me ndryshimet e evidentuara gjatë realizimit të punimeve në terren, ndërtimet nuk zbatojnë lejet e ndërtimit të miratuara dhe nuk respektojnë kondicionet urbane të lejuara në njësinë përkatëse sipas rregullores së planifikimit të territorit në fuqi.

1. “Dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë vendimi nr.1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, Verbas, NJA Zharrëz, Patos. Nga verifikimi në terren i objektit evidentohet që punimet kanë përfunduar dhe është në përdorim, pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

2. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos. Nga verifikimi në terren i objektit evidentohet që punimet kanë përfunduar dhe është në përdorim, pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

3. “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Verbas, Patos. Tipologjia e objektit nuk përkon me tipologjinë e objekteve të lejuara në zonë dhe nuk është në funksion të bujqësië por të ofrimit të shërbimit (bar-kafe). Në zbatim të kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar përcaktohet si më poshtë: pika 6. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit dhe inspektoriati përkatës në fushën e ndërtimit. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Patos, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë realizimin e ndërtimit jo në përputhje me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë dhe përdorimin e tij pa marrë certifikatë përdorimi.

**Kriteri: Nenet 50, 51 e gërma “f” e nenit 52 të Ligjit 107/2014,** ku përcaktohet që:

Neni 50, “Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësive, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit”.

Neni 51, 1. *Inspektimi ka për mission garantimin dhe mbrojtjen e interes kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.*

2. *Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktetnëligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.*

3. *Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësive, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.*

4. *Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimitbotohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.*

5. *Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.*

Pika “f” e Nenet 52, “Përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit”.

Neni 5 i Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës”, ku përcaktohet që:

*Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme:*

a) *vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;*

b) *vendos gjoha sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;*

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vërenshkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

Neni 12 i Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, ku përcaktohet që: “Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e ndërtimit janë të detyruar të ndihmojnë në kryerjen e kontrollit, si dhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Kryeinspektorët/inspektorët duhet të identifikohet me dokument zyrtar. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbajtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga kryeinspektorët/inspektorët që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar, kur ky i fundit është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar”.

**Ndikimi:** Përdorimi i objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi ndikon në mungesën e konformitetit të ndërtimit me lejen e ndërtimit të miratuar, në mungesën e certifikimit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë, si edhe në ndryshimin e tipologjisë së ndërtimit/ose ndryshimit të funksionit të përdorimit, me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë, në kundërshtim me planifikimin e territorit për njësinë përkatëse.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e IVMT Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

*Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan 1 praktikë, ku ndërtimi është realizuar pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.*

**56. Titulli i gjetjes:** Zhvillimi i ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh.

**Situata:** Nga verifikimi i zbatimit të lejeve të ndërtimit u evidentua që në të njëjtën parcelë që është miratuar leja e ndërtimit me nr. 7, datë 06.05.2019, për objektin: “Stallë për rritje viçash”, Sheqishtë, Zharrëz, Patos, paraqitur nga zhvilluesi “F..” Shpk, janë ndërtuar disa objekte të tjera me konstrukcion metalik, për të cilat nuk është marrë leje ndërtimi/deklaratë paraprake punimesh. Nga verifikimi i fotove ajrore të shqyrtuara në bazë të kronologjisë, objekti: “Stallë për rritje viçash” është ndërtuar në vitin 2020, pas miratimit të lejes së ndërtimit, ndërsa objektet e tjera të ndërtuara në të njëjtën parcelë deri në vitin 2022, përgjatë 2 viteve, janë ndërtuar pa leje u pajisur me leje ndërtimi ose deklaratë paraprake punimesh. Mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Patos, pa mbajtur procedurat ligjore për kontrollin e ndërtimeve në zbatim të ligjit, ka sjellë si pasojë zhvillimin e ndërtimeve informale.

**Kriteri:** Nenet 50, 51 e gërma “F” e nenit 52 të e Ligjit 107/2014, ku përcaktohet që:

Neni 50, “Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësive, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit”.

Neni 51, 1. Inspektimi ka për mission garantimin dhe mbrojtjen e interes kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.

Pika “f” e Nenit 52, “Përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit”.

Neni 5 i Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës”, ku përcaktohet që:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme:

a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

b) vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vërenshkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

Neni 12 i Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, ku përcaktohet që: “Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e ndërtimit janë të detyruar të ndihmojnë në kryerjen e kontrollit, si dhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Mbajtja e procesverbalit është e detyrueshme në çdo rast kontrolli dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar, kur ky i fundit është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar”.

**Ndikimi:** Ndërtimi i objekteve pa u pajisur me leje ndërtimi, ndikon në mosrespektimin e kondicioneve urbane, në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e IVMT Patos.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

**Për sa më lart, për zbatimet e punimeve të ndërtimit të trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi:** Znj. R. B., me detyrë Kryetare e Bashkisë Patos; z.A. G., me pozicion Kryeinspektori IVMT-së Patos, nga periudha 01.07.2021 e në vijim; z. B. B., me pozicion inspektor i IVMT-së Patos, për periudhën 23.12.2013-01.07.2021, dalë në pension; z. D. L., me pozicion inspektor i IVMT-së Patos, nga data 10.12.2013; z. Xh. C., me pozicion inspektor i IVMT-së Patos, nga data 15.09.2016.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 119/6 prot., datë 06.04.2023, është observuar nga Kryeinspektori i IVMT-së, z. A. G., Inspektori i IVMT-së z. D. L. dhe inspektori i IVMT-së, z. Xh. C., me shkresën nr. 312/31 prot., datë 22.05.2023. Observacioni është identik me shkresën nr. nr. 312/18.1 prot., datë 31.03.2023 të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegimi/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. Përsa më sipër,

## 2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

**57. Titulli i gjetjes:** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së.

**Situata:** Bashkia Patos, së fundmi është audituar nga KLSH në vitin 2022 dhe Raporti përfundimtar me objekt: “Auditim financiar në Bashkinë Patos për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021”, si dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 51/8 prot., datë 16.05.2022, protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 120/2 prot., datë 18.05.2022, ku janë lënë për zbatim 9 masa organizative, 8 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) në vlerën 99,398,839 lekë dhe 5 masa disiplinore.

a. Masa organizative janë rekomanduar 9 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 4 masa janë zbatuar, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi.

b. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) janë rekomanduar 8 masa në vlerën 99,398,839 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 8 masa nuk janë zbatuar.

c. Masa disiplinore janë rekomanduar 5 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 5 masa janë zbatuar pjesërisht.

2. Raporti Përfundimtar për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 23.09.2019, deri më 31.12.2019, në Bashkinë Patos e cila përfshin “Auditim financiar dhe përputhshmëri për periudhën nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019”, janë dërguar me shkresën nr. 610/64 prot., datë 04.12.2020, protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 1468/5 prot., datë 07.12.2020, ku janë rikërkuar për zbatim 6 masa organizative, 5 masa për shpërblim në vlerën 2,668,052 lekë dhe 1 masë për uljen e borxhit tatimor duke ritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (të ardhura të munguara) në vlerën 42,732,889 lekë.

a. Masa organizative janë rikërkuar për zbatim 6 masa nga të cilat 2 masa janë në proces zbatimi dhe 4 masa nuk janë zbatuar.

b. Masa për shpërblim në vlerën 2,668,052 lekë të cilat janë në proces zbatimi.

c. Masa për uljen e borxhit tatimor duke ritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (Të ardhura të munguara) është rikërkuar 1 masë në vlerën 42,732,889 lekë e cila nuk është zbatuar.

**Kriteri:** Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2.

**Ndikimi:** Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme ka sjell që strukturat e Bashkisë Patos në fusha dhe aspekte të caktuara vijojnë veprimtarinë në kundërshtim me kuadrin rregullator ligjor.

**Shkaku:** Mos angazhim sa duhet t strukturave të Bashkisë Patos për zbatimin e rekomandimeve.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos të analizojnë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin “Financiar për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021”. Të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe të pa zbatuara si vijon:

-Për 3 masa organizative të cilat janë zbatuar pjesërisht, dhe 2 masa në proces zbatimi.

2.1. Kryetari i Bashkisë Patos, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB me personel konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke përcaktuar kriteret specifike profesionale për çdo pozicioni të

strukturës së NJAB si dhe ndjekë në kohë procedurën për çertifikimin e audituesve.

**3.1.** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Patos, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse. Të kryhet në mënyrë të saktë kontabilizimi i të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurohet rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

**4.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerjemallrash të bëhet mbi bazën e të ardhurave reale, të disponueshme dhe jo të planifikimit, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Patos.

**5.1.** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore për vitet 2020 - 2021 në vlerën 136,906,723 lekë sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

**7.1.** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës të njoftoj subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.

-Për 8 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) në vlerën 99,398,839 lekë të cilat nuk janë zbatuara.

**1.1.** Bashkia Patos, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Patos, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.), për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

**2.1.** Bashkia Patos të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë.

**2.2.** Bashkia Patos, të marrë masa për të propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Patos" Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

**2.3.** Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifatat vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitorë prej 44,507,884 lekë.

**3.1.** Bashkia Patos të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 1,612,831 lekë, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

**4.1.** Bashkia Patos nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfundues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Patos. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa

shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës 33,398,133 lekë nga të gjithë individët e listuar si debitorë, sipas listës në aneksin pasqyrë nr. 15 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**5.1.** Bashkia Patos, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej 11,346,600 lekë (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba, sipas, sipas listës në aneksin nr. A-16, A-17 dhe A-18 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Patos, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

**6.1.** Nga Bashkia Patos të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifën e plotë për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej 5,550,000 lekë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

-Për 5 masa disiplinore të cilat janë zbatuara pjesërisht.

1. Znj. M. Sh., me detyrë Drejtore e Financës.

2. Znj. Xh. Gj., me detyrë Përgjegjëse e Kontabilitetit.

3. Z. A. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;

4. Znj. S. M., me detyrë specialiste në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;

5. Z. E. A., me detyrë inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos të analizojnë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve për "Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë periudhën nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019". Të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe të pa zbatuara si vijon:

-Për 2 masa organizative të cilat janë në proces zbatimi dhe 4 masa të cilat nuk janë zbatuar.

**5.1.** Bashkia Patos, të marrë masat që me specialist të fushës, të saktësojë pronat të cilat padrejtësisht zotërohen nga persona të ndryshëm dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për lirim dhe administrimin e tyre në interes publik. Drejtoria e Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, Drejtorinë e Planifikimit Territorit, të marrin masat për krijimin e regjistrit të asetëve dhe vazhdimin e procedurave për regjistrimin e tyre në pronësi të Bashkisë Patos në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar dhe Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

**7.1.** Bashkia Patos, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

**8.1.** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimt të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

**11.1.** Drejtoria i Shërbimit të marri masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të kësaj tarife, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve për konsumatorët fundorë në këtë bashki.

**12.1.** Bashkia Patos të marrë masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 13,309,757 lekë, për të gjitha subjektet dhe familjarët që janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it.

**13.1.** Nga Bashkia Patos të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 29,803,435 lekë për taksat e tarifave vendore për familjarët, për lidhjen e kontratave të qirasë përpara noterit e taksave vendore nga bizneset. Bashkia Patos të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 93 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Për 5 masa për shpërblim në vlerën 2,668,052 lekë të cilat nuk janë zbatuar.

**1.1.** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 161,000 lekë pa Tvsh nga BOE “E. K.” Shpk & “F.” Shpk & “A.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 683/14 prot., datë 03.11.2016, me objekt: “Rikualifikimi urban i shëtitorës Republika”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**3.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,321,591 lekë pa Tvsh nga OE “G... C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1718/10 prot., datë 20.04.2018, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Unaza”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit dy herë për trajtimin e dubluar “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m<sup>2</sup>”.

**4.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 664,600 lekë pa Tvsh nga BOE “S.” Shpk & “J.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 829/16 prot., datë 31.08.2017, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Unazë-Grizë Velaj”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**6.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 176,862 lekë pa Tvsh nga OE “Sh.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1636/12 prot., datë 12.09.2018, me objekt: “Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale Fier-Berat (në fshatin Zharrës) si dhe ndërtimi i dy urave për këmbësorë në krah të urës së automjeteve”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**7.1.** Bashkia Patos, drejtoria e financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore arkëtimin e shumës 343,999 lekë si sigurim kontrate OE “S.” Shpk të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje mjet makine vetëshkarkuese”, bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914, datë 29.12.2014, neni 24.

-Për 1 masë për uljen e borxhit tatimor duke riturper formancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (të ardhura të munguara) në vlerën 42,732,889 lekë e cila nuk është zbatuar.

**1.1.** Bazuar në nenin 91-93 pika 1 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Tatim Taksave Bashkia Patos të merren masa për të zbatuar të gjitha etapat për arkëtimin e detyrimeve për vlerën 42.732,889 lekë, si më poshtë:

-Të arkëtohet vlera prej 13,309,757 lekë sipas VKM. nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen.

Të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a-Të ndiqen të gjitha etapat sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 91-93 (Sektori i Taksave dhe Drejtoria Juridike).

b- Bashkia Patos, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën prej 13,309,757 lekë.

**A. mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin “Financiar për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021, në Bashkinë Patos”.**

**I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:**

Në zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Bashkia Patos ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 120/14 prot., datë 06.06.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:**

Në zbatim të nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Bashkia Patos ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 120/23 prot., datë 06.12.2022, duke respektuar kështu afatin brenda 6 muajve të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

**III. Rekomandimet e KLSH-së:**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Patos” administruar në KLSH me nr. 51/8 prot., datë 16.05.2022, dhe protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 120/2 prot., datë 18.05.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- 9** masa organizative.
- 8** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike (Të ardhura të munguara) në vlerën **99,398,839 lekë**.
- 5** masa disiplinore.

**IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:**

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	9	9	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	8	8	0
Masa disiplinore	5	5	0
<b>Totali</b>	<b>22</b>	<b>22</b>	<b>0</b>

**V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Patos:**

Masat	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	9	4	3	2	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	8	0	0	0	8
Masa disiplinore	5	0	5	0	0
<b>Totali</b>	<b>22</b>	<b>4</b>	<b>8</b>	<b>2</b>	<b>8</b>
<b>Totali në %</b>	<b>100%</b>	<b>18%</b>	<b>36.3%</b>	<b>9%</b>	<b>36.3%</b>

**Më hollësishtrezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:**

**A. Masa Organizative**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Autorizues, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

<p><b>Statusi i rekomandimit:</b> I pranuar.  <b>Koment i grupit të auditimit:</b> Nga Bashkia Patos është hartuar strategjia e riskut si dhe regjistri i riskut.  <b>Rekomandimi është zbatuar.</b></p>
--

**1.2. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa që në rregulloren e brendshme



të përcaktohen qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Për vitin 2022 është miratuar kalendari për trajnimin e punonjësve i miratuar nga Kryetari i Bashkisë znj. R. B. me shkresën nr. 640 prot., datë 28.02.2022. Më datën 18.11.2022, është zhvilluar trajnimi i punonjësve të institucionit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin ku janë mbajtur dhe procesverbalet përkatëse për pjesëmarrjen në trajnim.

**Rekomandimi është zbatuar.**

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Patos, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB me personel konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke përcaktuar kriteret specifike profesionale për çdo pozicioni të strukturës së NJAB si dhe ndjekë në kohë procedurën për çertifikimin e audituesve.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i zbatimit të strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Patos konstatohet se kjo strukturë nuk është plotësuar me numrin maksimal të punonjësve. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**2.2. Rekomandimi:** NJAB në hartimin e planeve vjetore të planifikohen, të kryhet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve i cili kërkon që Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara menaxhimit sipas Manualit të AB.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga NJAB janë marrë masat e duhura për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve. Në pikën 2.1, të Projektraportit të Auditimit, është trajtuar zbatueshmëria e rekomandimeve të lëna nga auditit i brendshëm.

**Rekomandim është zbatuar.**

**3.1. Rekomandimi:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Patos, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse. Të kryhet në mënyrë të saktë kontabilizimi i të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurohet rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit konstatohet nivele të ulta të realizimit të tij, konkretisht në masën 62.1%.

Në nivelin e realizimit ka ndikuar realizimi në zërat e buxhetit si vijon:

-Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601, është realizuar në masën 90.8%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës.

-Shpenzimet operative Art. 602, është realizuar në masën 53.5%;

-Shpenzimet për investime Art. 230-231, është në masën prej 26%. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Patos, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e të ardhurave reale, të disponueshme dhe jo të planifikimit, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Patos.

#### Në vijimësi

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit konstatohet nivele të ulta të realizimit të tij, konkretisht në masën 62.1%.

Në nivelin e realizimit ka ndikuar realizimi në zërat e buxhetit si vijon:

-Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601, është realizuar në masën 90.8%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës.  
-Shpenzimet operative Art. 602, është realizuar në masën 53.5%;  
-Shpenzimet për investime Art. 230-231, është në masën prej 26%. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.2, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore për vitet 2020 - 2021 në vlerën **136,906,723 lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Me Urdhrin nr. 148, datë 29.09.2022, "Për popullimin e sistemit "P." dhe evidentimin e familjeve me tokë bujqësore dhe familjet debitore" janë duke u identifikuar debitorët që përfshihen në këtë vlerë.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**6.1 Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek "Ujësjellës Kanalizime Patos" Sha, me vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llogarisë. 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Në pasqyrat financiare të vitit 2022 është kryer sistemimi i vlerës. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi është zbatuar.**

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës të njoftoj subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Për vitin 2022 konstatohet e njëjtasituatë ku gjendja më datë 31.12.2022, është në vlerën 35,722,934 lekë. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike. (të ardhurave të munguara)**

**1.1. Rekomandim:** Bashkia Patos, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifata apo taksat e të cilavemblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Patos, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisëmenjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.), për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

**Në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë auditimit të ushtruar për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, konkretisht për taksën e ndikimit në infrastrukturë por nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk janë masat e duhura për krijimin e një baze të dhënash për taksat dhe tarifata të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë.

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Patos të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi shlyerjes së detyrimeve për sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohen detyrime deri më datën 31.12.2022, në vlerën 33,340,042 lekë. Për vitin 2022 nuk ka rakordime me ASHK dhe të dhëna për gjendjen debitore të kësaj takse. (Trajtuar më hollësisht në nënpikën 2.6, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**2.2. Rekomandim:** Bashkia Patos, të marrë masa për të propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Patos” Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Me VKB nr. 41, datë 20.06.2022, “Për caktimin e Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sha, Patos si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave familjare”. Ky vendim nuk është aplikuar për arsye se “Ujësjetllës Kanalizime” Sha, Patos është në fazën e riorganizimit sipas legjislacionit në fuqi. (Trajtuar më hollësisht në nënpikën 2.6, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi në proces zbatimi.**

**2.3. Rekomandim:** Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitore prej **44,507,884 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i shlyerjes së detyrimeve mbi situatën debitore konstatohet se për vitin 2022 ka një vlerë të lartë debitorësh në shumën 115,762,859 lekë. Nga Bashkia Patos në lidhje me këtë situatë janë marrë masa konkretisht nga Kryetari i Bashkisë duke nxjerrë urdhrin nr. 148, datë 29.09.2022, “Për popullimin e sistemit “P.” dhe evidentimin e familjeve me tokë bujqësore dhe familjet debitore”. (Trajtuar më hollësisht në nënpikën 2.6, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**3.1. Rekomandim:** Bashkia Patos të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,612,831 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi mbi situatën debitore për taksën e dhënies së tokës bujqësore me qira konstatohen deri më datën 31.12.2022, detyrime në vlerën 1,963,641 lekë. (Trajtuar më hollësisht në nënpikën 2.6, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**4.1. Rekomandim:** Bashkia Patos nëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individpërfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Patos. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **33,398,133 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë, sipas listës në aneksin pasqyrë nr. 15 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi shlyerjes së detyrimeve për sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohen detyrime deri më datën 31.12.2022, në vlerën 33,340,042 lekë. Për vitin 2022 nuk ka rakordime me ASHK dhe të dhëna për gjendjen debitorë të kësaj takse. (Trajtuar më hollësisht në nënplikën 2.6, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**5.1. Rekomandim:** Bashkia Patos, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitorë në vlerën prej **11,346,600 lekë** (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba, sipas, sipas listës në aneksin nr. A-16, A-17 dhe A-18 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.**

**b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit,** kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

**c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar,** Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

**d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset,** nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Patos, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

**Menjëherë**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi shlyerjes së detyrimeve për sa i përket detyrimeve nga biznesi i madh dhe biznesi i vogël konstatohet detyrime deri më datën 31.12.2022, në vlerën 8,933,270 lekë konkretisht për biznesin e madh në vlerën 1,549,669 lekë dhe biznesin e vogël në vlerën 7,383,601 lekë.

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**6.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifën e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **5,550,000 lekë**, sipas listës/pasqyrës aneks nr. A22 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi shlyerjes së detyrimeve për sa i përket detyrimeve nga subjektet që ushtrojnë tregtim të hidrokarbure dhe derivatet e tyre deri më datë 31.12.2022, janë konstatuar detyrime 5,350,000 lekë. (Trajtuar më hollësisht në nënplikën 2.6, të Projektraportit të Auditimit).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

## **Masa Disiplinore.**

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "Llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën "g", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për një punonjës, si më poshtë**

**Për problematikat e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe realizimin e buxhetit, si më poshtë vijon;**

**I. Znj. M. Sh.,** me detyrë Drejtore e Financës, për mos zbatimin të akteve ligjore e nënligjoretë

mëposhtme:

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për pushtetin vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

### **Për problematikat e konstatuara në lidhje me Pasqyrat financiare, si më poshtë vijon;**

#### **2. Znj. Xh. Gj., me detyrë Përgjegjëse e Kontabilitetit.**

- Mos regjistrimi në kontabilitet për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat Financiare për vitin 2020 dhe 2021 të “Ujësjellës Kanalizime Patos” Sha, në vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

- Mos zbatim të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli I, pika 1. dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, referuar raportit të auditimit.

### **Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon;**

**3. Z. A. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;**

**4. Znj. S. M., me detyrë specialiste në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;**

**5. Z. E. A., me detyrë inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.**

Për mos zbatim të akteve ligjore e nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar; ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 9 dhe 27; VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, ku përcaktohet edhe kontrata tip për t’u lidhur me qeramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftësbruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2., UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për taksat kombëtare”, UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, etj.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Me shkresën nr. 2834/6 prot., datë 05.12.2022, shkresën nr. 2834/7 prot., datë 05.12.2022, shkresën nr. 2835/9 prot., datë 05.12.2022, shkresën nr. 2835/10 prot., datë 05.12.2022, dhe shkresën nr. 2835/11 prot., datë

05.11.2022, janë marrëvendimet nga komisioni disiplinor i përbërë nga z. Sh. B. Kryetar, dhe anëtarët znj. J. Sh., znj. L. Q., z. L. Ç. dhe znj. N. H., ku është vendosur mos dhënie e masës disiplinore të rekomanduara nga KLSH për punonjësit si më poshtë:

- z. E. A.
- znj. S. M.
- z. A. M.
- znj. Xh. Gj.
- znj. M. Sh..

Këto vendime nuk përmbajnë asnjë analizë të shkeljeve të konstatuara nga auditimi i KLSH-së si dhe nuk është argumentuar vendimmarrja për mos dhënie mase disiplinore ndaj punonjësve.

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

## **B. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin “për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 23.09.2019, deri më 31.12.2019, në bashkinë patos e cila përfshin auditimin financiar dhe përputhshmërie nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019”.**

Raporti Përfundimtar për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 23.09.2019, deri më 31.12.2019, në Bashkinë Patos e cila përfshin “Auditim financiar dhe përputhshmërie për periudhën nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019”, është dërguar me shhkresën nr. 610/64 prot., datë 04.12.2020, në Bashkinë Patos me nr. 1468/5 prot., datë 07.12.2020.

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Bashkia Patos për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 367/8 prot., datë 29.09.2019, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	6	0	0	2	4
Masa për shpërblimëmi	5	0	0	5	0
Masa për uljen e borxhit tatimor	1	0	0	0	1
<b>Totali</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7</b>	<b>5</b>
<b>Totali në %</b>	<b>100%</b>	<b>0%</b>	<b>0%</b>	<b>58.3%</b>	<b>41.7%</b>

## **Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:**

### **A. Masa Organizative:**

**5.1. Rekomandim:** Bashkia Patos, të marrë masat që me specialist të fushës, **të saktësojë pronat të cilat padrejtësisht zotërohen nga persona të ndryshëm** dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për lirim dhe administrimin e tyre në interes publik.

Drejtoria e Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, Drejtorinë e Planifikimit Territorit, të marrin masat **për krijimin e regjistrimit të aseteve** dhe procedurave **për regjistrimin e tyre në pronësi** të Bashkisë Patos në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga Bashkia Patos janë marrë masat duke hartuar një regjistër asetesh por jo sipas formatit të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në E.. Por referuar procedurave të regjistrimit të pronave ka ende prona të pa regjistruara trajtuar më hollësit në aktkonstatimin nr. 9, datë 24.03.2022.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**7.1. Rekomandim:** Bashkia Patos, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre **duke bërë kërkesë padi** në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Me Urdhrin nr. 148, datë 29.09.2022, “Për popullimin e sistemit “P.” dhe evidentimin e familjeve me tokë bujqësore dhe familjet debitorë” janë duke u identifikuar debitorët që përfshihen në këtë vlerë.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**8.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Për vitin 2022 konstatohet e njëjta situatë ku gjendja më datë 31.12.2022, është në vlerën 35,722,934 lekë. (Trajtuar më hollësisht në akt konstatimin nr. 9, datë 24.03.2023)

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**11.1. Rekomandim:** Drejtori i Shërbimit të marri masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të kësaj tarife, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetet në tregtimin e karburanteve për konsumatorët fundorë në këtë bashki.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi shlyerjes së detyrimeve për sa i përket detyrimeve nga subjektet që ushtrojnë tregtim të hidrokarbure dhe derivatet e tyre deri më datë 31.12.2022, janë konstatuar detyime 5,350,000 lekë. (Trajtuar më hollësisht në akt konstatimin nr. 8, datë 24.03.2023).

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**12.1. Rekomandim:** Bashkia Patos të marrë masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **13,309,757 lekë**, për të gjitha subjektet dhe familjarët që janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë auditimit të ushtruar për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, konkretisht për taksën e ndikimit në infrastrukturë por nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk janë masat e duhura për krijimin e një baze të dhënash për taksat dhe tarifatat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë.

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**13.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 29,803,435 lekë për taksat e tarifatat vendore për familjarët, për lidhjen e kontratave të qirasë përpara noterit e taksave vendore nga bizneset. Bashkia Patos të ndërmarë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 93 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë auditimit të ushtruar për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në vlerën 117,726,500 lekë si më poshtë:

-Mospagimi i taksës së tokës bujqësore në vlerën 53,023,566 lekë.

-Mospagimi i taksës së ndërtesës në vlerën 22,921,574 lekë.

-Mospagimi i taksës së pastrimit në vlerën 34,064,516 lekë.

-Mospagimi i taksës së shërbimit komunitar në vlerën 3,195,792 lekë.

-Mospagimi i taksës së vaditjes dhe kullimit në vlerën 2,557,411 lekë.

-Mospagimi i qirasë së tokës vlerën 1,963,641 lekë.

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

## B. Masa Për Shpërblim Dëmi:

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **161,000 lekë pa Tvsh** nga BOE “E. K.” Shpk & “F.” Shpk & “A.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 683/14 prot., datë 03.11.2016, me objekt: “Rikualifikimi urban i shëtitores Republika”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Bashkia Patos me shkresën nr. 1499/38prot., datë 24.10.2019, ka njoftuar BOE “E. K.” Shpk & “F.” Shpk & “A.” Shpk, për detyrimin e konstatuar nga KLSH-ja duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit duke i

nisur edhe faturën për arkëtim me nr. 1292 prot., datë 24.10.2019. Deri në datën e verifikimit 10.07.2020, nga Bashkia Patos na u relatua se sipas komunikimit, BOE “E. K.” Shpk & “F.” Shpk & “A.” Shpk, do të bëjnë likuidimin e detyrimit. Deri më datë 24.03.2023, nga Bashkia Patos nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit por ka mbetur në fazër e trajtuar në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,321,591 lekë pa Tvsh** nga OE “G... C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1718/10 prot., datë 20.04.2018, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Unaza”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit dy herë për trajtimin e dubluar “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m<sup>2</sup>”.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Bashkia Patos me shkresën nr. 1499/36 prot., datë 24.10.2019, ka njoftuar OE “G... C.” Shpk, për detyrimin e konstatuar nga KLSH-ja duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit duke i nisur edhe faturën për arkëtim me nr. 1294, datë 24.10.2019. Nga ana e OE “G... C.” Shpk, është bërë kundërshtimi i detyrimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, sipas Aktit nr. 1787/359, datë 05.12.2019 dhe me shkresën nr. 3395/4 prot., datë 19.06.2020 është bërë dhe njoftimi i vendimit nr. 174, datë 09.03.2020. Deri më datë 24.03.2023, nga Bashkia Patos nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit por ka mbetur në fazër e trajtuar në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **664,600 lekë pa Tvsh** nga BOE “S.” Shpk & “J.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 829/16 prot., datë 31.08.2017, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Unazë-Grizë Velaj”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Bashkia Patos me shkresën nr. 1499/33 prot., datë 24.10.2019, ka njoftuar BOE “S.” Shpk & “J.” Shpk, për detyrimin e konstatuar nga KLSH-ja duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit duke i nisur edhe faturën për arkëtim me nr. 1295, datë 24.10.2019. Nga ana e BOE “S.” Shpk & “J.” Shpk, është bërë kundërshtimi i detyrimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë sipas Aktit nr. 1770, datë 11.12.2019 dhe nga Bashkia Patos me shkresën nr.3396/2 prot., datë 20.01.2020 janë dërguar prapësimet dhe provat shkrese mbi kërkesë padinë. Çështja vazhdon në gjykatë, pasi akoma nuk është marr vendim. Deri më datë 24.03.2023, nga Bashkia Patos nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit por ka mbetur në fazër e trajtuar në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**6.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **176,862 lekë pa Tvsh** nga OE “Sh.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1636/12 prot., datë 12.09.2018, me objekt: “Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale Fier-Berat (në fshatin Zharrës) si dhe ndërtimi i dy urave për këmbësorë në krah të urës së automjeteve”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Bashkia Patos me shkresën nr. 1499/32 date 24.10.2019, ka njoftuar OE “Sh.” Shpk, për detyrimin e konstatuar nga KLSH-ja duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit duke i nisur edhe faturën për arkëtim me nr. 1297 datë 24.10.2019. Deri më datë 24.03.2023, nga Bashkia Patos nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit por ka mbetur në fazër e trajtuar në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**7.1. Rekomandim:** Bashkia Patos, drejtorja e financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore arkëtimin e shumës **343,999 lekë** si sigurim kontrate OE “S.” Shpk të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje mjet makine vetëshkarkuese”, bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914, datë 29.12.2014, neni 24.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Bashkia Patos me shkresën nr. 1499/37 date 24.10.2019, ka njoftuar OE “S.” Shpk, për detyrimin e konstatuar nga KLSH-ja duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit duke i nisur edhe faturën për arkëtim me nr. 1298, datë 24.10.2019. Nga ana e OE “S.” Shpk është bërë kundërshtimi i detyrimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë sipas akti nr. 1770, dhe çështjes nr. 31157-01259-84-2019. Deri më datë 24.03.2023, nga Bashkia Patos nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit por ka mbetur në fazër e trajtuar në auditimin e mëparshëm



të zhvilluar nga KLSH.

**Rekomandimi është në proces zbatimi.**

**C. Masa për uljen e borxhit tatimor duke ritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (të ardhura të munguara).**

**1.1.1. Për këtë rekomandim:** Bazuar në nenin 91-93 pika 1 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Tatim Taksave Bashkia Patos të merren masa për të zbatuar të gjitha etapat për arkëtimin e detyrimeve për vlerën **42.732,889 lekë**, si më poshtë:

-Të arkëtohet vlera prej **13,309,757** lekë sipas VKM. nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen.

Të ndiqen **rrugët e mëposhtme:**

a-**Të ndiqen të gjitha etapat sipas kërkesave** të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 91-93 (Sektori i Taksave dhe Drejtoria Juridike).

b- Bashkia Patos, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën prej **13,309,757 lekë**.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave deri më datën 31.12.2023, konstatohet vlerë e lartë e detyrimeve 167,677,530 lekë konkretisht si më poshtë:

-Mospagimi i taksës së tokës bujqësore në vlerën 53,023,566 lekë.

-Mospagimi i taksës së ndërtesës në vlerën 22,921,574 lekë.

-Mospagimi i taksës së pastrimit në vlerën 34,064,516 lekë.

-Mospagimi i taksës së shërbimit komunitar në vlerën 3,195,792 lekë.

-Mospagimi i taksës së vaditjes dhe kullimit në vlerën 2,557,411 lekë.

-Mospagimi i qirasë së tokës vlerën 1,963,641 lekë.

-Mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit të vogël dhe biznesi i madh 8,933,270 lekë e ndarë kjo:

-Mospagimi i taksave dhe tarifave nga biznesi i madh në vlerën 1,549,669 lekë.

-Mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i vogël në vlerën 7,383,601 lekë.

-Mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 33,340,042 lekë.

-Mospagimimospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 5,350,000 lekë.

-Mospagimi i detyrime të kontratave për dhënie me qira nga përdorimi dhe shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme që përdoren nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet mineral në sipërfaqet ku funksionojnë lejet minerare aktive në vlerën 2,327,718 lekë.

**Rekomandimi nuk është zbatuar.**

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** a. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërkujtë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pikat 2-3.

**b.** Nga auditimit i organizimit dhe funksionimit të Njësisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Patos u konstatuan paregullsitë si më poshtë:

-Struktura e NJAB nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të kësaj njësie.

-NJAB nuk ka kryer auditimin e Drejtorisë së Financës e cila ka qenë pjesë e planit vjetor dhe është fushë me risk të lartë.

-Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Patos të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizimin e tyre.

**1.2. Rekomandimi:** Bashkia Patos të marrë masa për plotësimin me kapacitet të plotë me burimet njerëzore të nevojshme të strukturës së NJAB me qëllim mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e saj.

**1.3. Rekomandimi:** Nga NJAB të merren masa që, pjesë e planit vjetor të vitit 2023 të përfshihen edhe auditimi të Drejtorisë së Financës. Nga Përgjegjësi i NJAB të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e veta të Bashkisë Patos së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, për vitin 2022 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 808,235 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 502,679 mijë lekë, ose në masën 62.1%. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën 314,595 mijë lekë, realizuar 81,879 mijë lekë, ose në masën 26%. Gjithashtu edhe shpenzimet operative të cilat janë planifikuar në vlerën 104,140 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 55,539 mijë lekë ose në masën 53.5%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Patos në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27

dhe 32, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore me qëllim hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshëm bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

**3.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në

lidhje me rentën minerare, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Patos nuk ka krijuar bazë të plotë të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Patos, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimorë”, neni 117. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15, dhe UMF nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat Kombëtare”. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordimin periodik mujor me agjentët tatimorë, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Patos nga taksat që mblidhen nga këta agjentë. Për agjentët tatimorë që nuk realizojnë mbledhjen e saktë të ardhurave, Bashkia të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ligjshmërisë së 9 kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën e konkurimit si më poshtë:

- Në 9 raste nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Në 9 raste nuk disponohet planbiznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- Në 9 raste nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Në 9 raste nuk disponohet certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;
- Në 9 raste nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Në 9 raste nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.
- Gjithashtu pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Patos nuk janë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e 9 kontratave të sipërpërmendur për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3 dhe pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Sektori Juridik të marrin masa që para lidhjes së kontratës për dhënien e ndërtesave me qira, për subjektet që nuk paraqesin dokumentacionin sipas kërkesave të dispozitave ligjore përkatëse të bëjë skualifikimin e tyre.

**5.2. Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk disponohet regjistër në formë shkresore për taksapaguesit familjarë dhe privatë për taksën mbi token bujqësore, por të dhënat mbahen në programin “E.” nga kjo drejtori. Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk harton raporte periodike gjatë vitit dhe as raporte vjetore me shkrim për titullarin e institucionit dhe Këshillit Bashkiak, për ta informuar për situatën e arkëtimit dhe debitorëve. Gjithashtu nga kjo drejtori nuk dorëzohet lista shkresore e debitorëve të vitit buxhetor në arkiv dhe as në Drejtorinë e Financës për efekt kontabilizimi. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19 dhe Regulloren e Brendshme e institucionit miratuar me Vendimin nr. 21, datë 30.01.2022, neni 36, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore të hartojë raporte periodike mujore dhe në fund të vitit raportin vjetor drejtuar titullarit të institucionit dhe Këshillit Bashkiak, mbi realizimin e të ardhurave dhe gjendjen debitorë. Lista e debitorëve në fund të vitit buxhetor të protokollohet dhe një kopje e saj të dorëzohet në Drejtorinë e Financës për efekt kontabilizimi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datë 31.12.2021, në vlerën 14,298,391 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 14,234,425 lekë, me një ulje në vlerë 63,966 lekë. Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në datën 31.12.2022, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 14,234,425 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 151,141,148 lekë, me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 136,906,723 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të sistemojë në kontabilitet llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të kategorisë privat dhe familjar.

#### **Deri më datë 31.12.2023**

**8. Gjetje nga auditimi: 1.** Në total aktivet të cilat i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, për koston historike në vlerën 4,220,846 lekë Bashkia Patos prej 1039 prona, të cilat janë transferuar sipas VKM respektive vetëm për 29 prona posedon titull pronësie si dhe vetëm 91 prej tyre janë të regjistruara në kontabilitet. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në

dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c”.

**2. Llogaria 211 “Pyje, plantacione”** paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2022, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Patos me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferim në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave, sipas inventarit, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”” i ndryshuar, sipas listës në faqen 555 të VKM, janë transferuar 682.75 ha pyje. Të regjistruara në ASHK janë 4 pasuri me nr. 2/8, 2/1, 2/5, 2/3 me sipërfaqe 4 ha në ekonominë pyjore “Ana e Lumit Seman 2”, ndërsa pjesa tjetër është në proces certifikimi, mbasi ka përfunduar faza e parë dhe e dytë e regjistrimit e inicuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe kompanisë së kontraktuar “C.-P. & D.”.

**3. Nga auditimi i llogarisë 210 “Troje, toka, terrene”** konstatohet se është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 1,074,287 lekë. Duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit (SKK) nr. 5, “Afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, i përmirësuar, pika 30, nuk mund të aplikohet normë amortizimi për këtë llogari. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish-komunave, sot NJA të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,074,287 lekë, e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

#### **Deri më datë 31.12.2023**

**9. Gjetje nga auditimi:** Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 8,525,957 lekë. Në këtë vlerë është përfshirë edhe automjeti tip B. me targë AA... me vlerë kosto historike 1,450,000 lekë i cili nuk është në gjendje pune dhe është nxjerrë jashtë përdorimit sipas Vendimit nr. 27, datë 13.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 1,450,000 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti”, duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,450,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 1 automjeti të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

**Deri më datë 31.12.2023**

**10. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është në vlerën 35,722,934 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 13,225,145 lekë dhe pakësim në vlerën 7,894,511 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 35,722,934 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,208,274 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Patos nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç’bllokimin e këtyre fondeve. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Patos, Drejtorja e Financës dhe Drejtorja e Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

**Deri më datë 31.12.2023**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë kontatohet se, në 10 raste janë zhvilluar projekte artistike, të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 7-9 dhe nenet 65-70 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas VKB nr. 71, datë 14.12.2021, me objekt “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të Projekt Buxhetit AFM 2022-2024 dhe buxhetin e Bashkisë Patos për vitin 2022”. Duke u bazuar në VKB e mësipërme fondet e miratuara për projektet artistike është në vlerën 3,690,000 lekë nga të cilat është shpenzuar shuma 2,550,000 lekë. Nga Bashkia Patos për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 10 subjekte është likuiduar shuma 2,550,000 lekë. Për këto projekte nuk ka as kontrata të lidhura ndërmjet palëve por pagesa e këtij shërbimi është kryer mbi bazën e faturave tatimore të lëshuara nga subjektet përkatëse. **Vlera 2,550,000 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i 10 dosjeve të punonjësve të aparatit të Bashkisë Patos konstatohet se, në një rast punonjësi nuk është emëruar në përputhje me kriteret e

pozicionit të punës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa që rekrutimet e punonjësve të kryhen në përputhje me kriteret e pozicioneve të punës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi: 1.** Bashkia Patos ka të hartuar regjistrin e aktiveve në formë elektronike në programin E. në vartësi të llojit të aktiveve afatgjata apo afatshkurtra si dhe grupit përkatës brenda llojit. Regjistri nuk është i plotësuar me të gjithë elementët përbërës konkretisht: datën e skadencës, vendodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30.

**2.** Për vitin 2022, Kryetari i Bashkisë Patos ka nxjerrë Urdhrin nr. 168, datë 02.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të vetë institucionit dhe NJA Zharrëz dhe Ruzhdie i përbërë nga 15 punonjës si dhe Urdhrin nr. 169, datë 02.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve i përbërë nga 7 punonjës. Procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit është kryer dy herë radhazi nga i njëjti komision i cili ka ushtruar këtë funksion në vitin 2021 në zbatim të Urdhrit nr. 131, datë 21.10.2021, të Kryetarit të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 84. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e rrishtit nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Patos të marrë masa për të eliminuar praktikën e kryerjes së procesit të inventarizimit periodik të aktiveve, dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision.

**Në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 10 procedurave me vlerë totale të fondit limit **1,323,416 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 10 procedura **me vlerë kontrate 1,275,339 mijë lekë**. Në 10 raste janë vendosur kriteret të cilët nuk janë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Në 7 raste janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale **162,874 mijë lekë, respektivisht:**

**1.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti” Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit **74,258 mijë lekë**, me fitues BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk, me vlerë të ofertës **72,259 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të



përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d,” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “G.” Shpk & “Sh.” Shpk & “A.” Shpk, me ofertë 72,259 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **72,259 mijë lekë pa Tvsh** (86,710,948 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës) Bashkia Patos, viti 2019, me fond limit **450,024 mijë lekë**, me fitues OE “2...” Shpk, me vlerë të ofertës **444,056 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara. Kriteret në DT nuk janë në përputhje me përcaktimet e germën “c”, “ç”, d”, të pikë 2, neni 1; germën “a”, “b”, “c” të nenit 2; neni 20; neni 23, nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”. Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit **8,042 mijë lekë**, me fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.-A.” Shpk, me vlerë të ofertës **7,397 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruar dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “H.” Shpk & “Sh.-A.” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk është vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruar dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “H.” Shpk & “Sh.-A.” Shpk, me ofertë 7,397 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe

shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,937 mijë lekë pa Tvsh** (8,877,048 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjiellësit Qytetit Patos Loti II” Bashkia Patos, Viti 2020, me fond limit **608,941 mijë lekë**, me fitues OE “2...” Shpk, me vlerë të ofertës **596,422 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me përcaktimet e germën “c”, “ç”, d”, të pikë 2, neni 1; germën “a”, “b”, “c” të nenit 2; neni 20; neni 23, nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës rrugës së Varrezave, Dukas”. Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit **12,160 mijë lekë**, me fitues BOE “H.” Shpk & “Sh.-A.” Shpk, me vlerë të ofertës **8,956 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “H.” Shpk & “Sh.-A.” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d,” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “H.” Shpk & “Sh.-A.” Shpk, me ofertë 8,956 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **8,956 mijë lekë pa Tvsh** (10,747,930.80 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Sistemim i hapësirave, lagjja “29 Marsi”, Blloku të zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit **49,795 mijë lekë**, me fitues BOE “M. I. G. Shpk & “L. K.” Shpk, me vlerë të ofertës **40,828 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “M. I. G.” Shpk & “H.” Shpk & “Sh.-A.” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d,” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, gërma “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, gërma “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, me ofertë 39,473 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **40,828 mijë lekë pa Tvsh** (48,994,499 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë Patos”, Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit **10,537 mijë lekë**, me fitues BOE “I... G.” Shpk dhe “2.. K.” Shpk, me vlerë të ofertës **7,685 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “I... G.” Shpk & “2.. K.” Shpk.

Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “I... G.” Shpk & “2.. K.” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,685 mijë lekë pa Tvsh** (9,222,252 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës Dukas, Çoban”, Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit **12,568 mijë lekë**, me fitues BOE “A. C.” Shpk & “6..P.” Shpk, me vlerë të ofertës **11,973 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “A. C.” Shpk & “6.-P.” Shpk.

Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “A. C.” Shpk & “6.-P.” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **11,973 mijë lekë pa Tvsh** (14,368,211.30 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”, Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit **15,932 mijë lekë**, me fitues OE “I.” Shpk, me vlerë të ofertës **13,773 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “I.” Shpk.

Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “I.” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **13,773 mijë lekë pa Tvsh** (16,528,523 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i palestrës”, Bashkia Patos, Viti 2022, me fond limit **81,153 mijë lekë**, me fitues OE “Sh.” Shpk, me vlerë të ofertës **71,986 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kritereve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Patos dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022, Bashkia Patos në total ka zhvilluar 469 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së, me fond limit në vlerën 60,374,830 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate kontrate në vlerën 52,892,301 lekë pa Tvsh me një diferencë mosrealizimi të fondit limit në vlerën 7,482,529 lekë pa Tvsh. Nga të cilat me zgjedhje janë audituar në total 48 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 21,099,954 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate në vlerën 18,743,115 lekë pa Tvsh ose në masën 34.9% të totalit të vlerës së fondit limit, ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Për vitin 2021 dhe 2022 në 2 raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit.

-Në 13 raste nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.

-Në 3 raste në dosjet e prokurimeve nuk disponohet të gjitha dokumentacionet e përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë (numër llogarie, vërtetimi për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, deklarata e garancisë, të cilat përbëjnë skualifikim të operatorëve për mos plotësimin e tyre ndërkohë që nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla edhe këto kritere nuk janë përmbushur operatorët janë shpallur fitues.

-Në 4 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të anëtarët e komisionit.

-Në 17 raste kanë rezultuar vonesa nga Bashkia Patos në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në 48 raste dosjet e procedurave të prokurimit me vlera të vogla nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7, "Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 3 dhe neni 29 miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40, pika 1, neni 59, pika 2, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 19. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e Financës dhe Sektori Juridik përgjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, të shmangjet mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Përpara fillimit të procedurës së prokurimit me vlera të vogla të argumentojë dhe të dokumentojë nevojat e institucionit për mallra dhe shërbime.

-Për raste në të cilat nga operatorët ekonomikë nuk paraqesin dokumentacionin e kërkuar në kriteret e ftesës për ofertë të bëhet skualifikimi i tyre.

-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen sipas përcaktimeve ligjore.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Të gjitha aktet e hartuara në lidhje me procedurat e prokurimit, të kalojnë përmes arkivës së institucionit, me qëllim evidentimin e rrjedhshmërisë së veprimeve gjithashtu pas përfundimit të çdo procedure të kryhet arkivimi i tyre.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan pesë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimi të lejes të ndërtimit dhe zbatimit të punimeve, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. “Ndërtim kantineve 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë vendimi nr. 21 datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., Dukas, Patos; 2. “Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë vendimi nr.1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, NJA Zharrëz, Patos; 3. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi nr.9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., NJA Zharrëz, Patos; 4. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos; 5. “Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M. S., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos. Veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 5, datë 07.03.2016; Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015; Vendimin nr. 5, datë 29.12.2014; Vendimin nr. 283, datë 01.04.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë dhe statusin e pronës që të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me mosrespektimin e lartësisë së lejuar në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve ligjore, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: “Stallë për rritje derrash 1 kat b/a+metalike”, për të cilën është marrë Vendimi nr.2, datë 27.02.2020, me zhvillues K. S., në Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 283, datë 01.04.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar lartësitë e lejuara të strukturës së ndërtimit, në përputhje me rregulloren dhe kriteret e përcaktuara.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mos përcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., me adresë NJA Zharrëz, Patos. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, neni 37. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mosparaqitjen e saktë të rilevimit topografik duke pasqyruar gjendjen ekzistuese të parcelës dhe objekteve të tjera që zhvillohen në të, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos, Rrethi Patos. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, neni 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar me vëmendjen përputhshmërinë ndërmjet gjendjes ekzistuese dhe dokumentacionit të ngarkuar në sistem.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mosparaqitja në sistemin “e-Leje” të marrëveshjes me pronarin e tokës dhe ndërmjet palëve të treta, në bazë të legjislacionit në fuqi, përkatësisht leja e ndërtimit me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimin nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos, Rrethi Patos. Anomalitë e trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me në bazë të VKM-së nr. 408, neni 15, pika b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi, përkatësisht leja e ndërtimit me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos, Rrethi Patos. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, neni 10/1, dhe neni 14, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe konformitetin përpara miratimit të lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**22. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: “Magazinë

për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Patos. Veprime këto në kundërshtim me zbatimin e kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar sipas pikës 6 dhe pikës 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1. Rekomandim:** Nga DPZHT Patos të merren masa për të ndjekur zhvillimin e lejeve të miratuara edhe gjatë fazave të zbatimit, në mënyrë që tipologjia e ndërtimit dhe objekti të jetë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi:** Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatuan katër praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë lidhur me mungesën e pajisjes me “Certifikatë përdorimi” të objektit pasi ishte në përdorim, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. “Dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, me adresë Verbas, NJA Zharrëz, Patos; 2. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, Patos, Rrethi Patos; 3. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., NJA Zharrëz, Patos; 4. “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Verbas, Patos. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin 107, neni 50, me Ligjin 107, neni 52, pika “g”, me VKM-në nr. 408, neni 27. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1. Rekomandimi:** Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Patos të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejojë përdorimin e objekti pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatuan dy praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara, përkatësisht për lejet e ndërtimit me objekt: 1. “Ndërtim kantine vere 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 21, datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., Dukas, Patos; 2. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr.17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin 107/2014, neni 42, “Certifikata e përdorimit”, me Ligjin 107/2014, neni 29, pika c, me VKM-në nr. 408, neni 27. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**24.1. Rekomandimi:** Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Patos të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan tetë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja e mënyrës së llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë në njoftimin për pagesën e taksës, përkatësisht në lejet e ndërtimit me



objekt: 1.“Ndërtim kantinevere 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 21, datë 13.01.2020, me zhvillues B. G., Patos; 2.“Stallë për rritje derrash 1 kat b/a+metalike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 2, datë 27.02.2020, me zhvillues K. S., në Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos; 3. “Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë Vendimi nr.1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D.” Shpk, Verbas, NJA Zharrëz, Patos; 4. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S. G.” Shpk, me adresë Patos, Rrethi Patos; 5. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F. S., NJA Zharrëz, Patos; 6.“Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N. K. e I. K., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos; 7.“Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M. S., Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos; 8.“Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E. Ç., Verbas, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë, me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**25.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Patos të merren masa që në njoftimin për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë të pasqyrohet mënyra e llogaritjes së saj dhe jo vetëm tarifa që nevojitet të likuidohet.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan pesë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimit në terren sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Zbatimi i realizimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe në legjislacionin në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**26.1. Rekomandimi:** Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë në mënyrë konstante çdo problematikë që konstatohet nga kontrolli i kryer dhe duke ekzekutuar vendimet e marra.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklarata paraprake punimesh. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin

dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**27.1. Rekomandimi:** Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**28.1. Rekomandimi:** Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**29. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, tre inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/inspektorë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014, nenin 11, të arsimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**29.1. Rekomandimi:** Nga Bashkisë Patos të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**30. Gjetje nga auditimi:** Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Patos, gjatë periudhës 01.07.2019-31.12.2022, ka marrë shtatë vendime për “Dënim me gjobë”, të cilat janë të pa mbledhura e të pa ekzekutuara, me një vlerë të debisë për 4 vjet, në vlerën 200,000 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, dhe Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9 dhe neni 22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**30.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 200,000 lekë. Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**32. Gjetje nga auditimi: 1.** Bashkia Patos, së fundmi është audituar nga KLSH në vitin 2022 dhe Raporti Përfundimtar me objekt: “Auditim financiar në Bashkinë Patos për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021”, si dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 51/8

prot., datë 16.05.2022, protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 120/2 prot., datë 18.05.2022, ku janë lënë për zbatim 9 masa organizative, 8 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) në vlerën 99,398,839 lekë dhe 5 masa disiplinore.

**a.** Masa organizative janë rekomanduar 9 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 4 masa janë zbatuar, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi.

**b.** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) janë rekomanduar 8 masa në vlerën 99,398,839 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 8 masa nuk janë zbatuar.

**c.** Masa disiplinore janë rekomanduar 5 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 5 masa janë zbatuar pjesërisht.

**2.** Raporti Përfundimtar për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 23.09.2019, deri më 31.12.2019, në Bashkinë Patos e cila përfshin: “Auditim financiar dhe përputhshmërie për periudhën nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019”, janë dërguar me shkresën nr. 610/64 prot., datë 04.12.2020, protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 1468/5 prot., datë 07.12.2020, ku janë rikërkuar për zbatim 6 masa organizative, 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 2,668,052 lekë dhe 1 masë për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (Të ardhura të munguara) në vlerën 42,732,889 lekë.

**a.** Masa organizative janë rikërkuar për zbatim 6 masa nga të cilat 2 masa janë në proces zbatimi dhe 4 masa nuk janë zbatuar.

**b.** Masa për shpërblim dëmi janë rikërkuar 5 masa në vlerën 2,668,052 lekë të cilat janë në proces zbatimi.

**c.** Masa për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (Të ardhura të munguara) është rikërkuar 1 masë në vlerën 42,732,889 lekë e cila nuk është zbatuar. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 151-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**32.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos të analizojnë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin “Financiar për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021”. Të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe të pa zbatuara si vijon:

-Për 3 masa organizative të cilat janë zbatuar pjesërisht, dhe 2 masa në proces zbatimi.

**2.1.** Kryetari i Bashkisë Patos, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB me personel konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke përcaktuar kriteret specifike profesionale për çdo pozicioni të strukturës së NJAB si dhe ndjekë në kohë procedurën për çertifikimin e audituesve.

**3.1.** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Patos, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta

për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse. Të kryhet në mënyrë të saktë kontabilizimi i të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurohet rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

**4.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e të ardhurave reale, të disponueshme dhe jo të planifikimit, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Patos.

**5.1.** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore për vitet 2020 - 2021 në vlerën 136,906,723 lekë sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

**7.1.** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës të njoftoj subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.

-Për 8 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) në vlerën 99,398,839 lekë të cilat nuk janë zbatuara.

**1.1.** Bashkia Patos, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Patos, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.), për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

**2.1.** Bashkia Patos të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë.

**2.2.** Bashkia Patos, të marrë masa për të propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Patos” Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

**2.3.** Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifatat vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitorë prej 44,507,884 lekë.

**3.1.** Bashkia Patos të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 1,612,831 lekë, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve.

**4.1.** Bashkia Patos nëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të

vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Patos. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës 33,398,133 lekë nga të gjithë individët e listuar si debitorë, sipas listës në aneksin pasqyrë nr. 15 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**5.1.** Bashkia Patos, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej 11,346,600 lekë (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba, sipas, sipas listës në aneksin nr. A-16, A-17 dhe A-18 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Patos, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

**6.1.** Nga Bashkia Patos të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifën e plotë për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej 5,550,000 lekë, sipas listës/pasqyrës aneks nr. A22 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

-Për 5 masa disiplinore të cilat janë zbatuara pjesërisht.

1. Znj. M. Sh., me detyrë Drejtore e Financës.

2. Znj. Xh. Gj., me detyrë Përgjegjëse e Kontabilitetit.

3. Z. A. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;

4. Znj. S. M., me detyrë specialiste në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;

5. Z. E. A., me detyrë inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**32.2. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos të analizojnë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve për "Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë periudhën nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019". Të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe të pa zbatuara si vijon:

-Për 2 masa organizative të cilat janë në proces zbatimi dhe 4 masa të cilat nuk janë zbatuar.

**5.1.** Bashkia Patos, të marrë masat që me specialist të fushës, të saktësojë pronat të cilat padrejtësisht zotërohen nga persona të ndryshëm dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për lirim dhe administrimin e tyre në interes publik. Drejtoria e Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, Drejtorinë e Planifikimit Territorit, të marrin masat për krijimin e regjistrimit të asetëve dhe vazhdimin e procedurave për regjistrimin e tyre në pronësi të Bashkisë

Patos në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**7.1.** Bashkia Patos, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

**8.1.** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

**11.1.** Drejtori i Shërbimit të marri masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të kësaj tarife, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve për konsumatorët fundorë në këtë bashki.

**12.1.** Bashkia Patos të marrë masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 13,309,757 lekë, për të gjitha subjektet dhe familjarët që janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it.

**13.1.** Nga Bashkia Patos të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 29,803,435 lekë për taksat e tarifave vendore për familjarët, për lidhjen e kontratave të qirasë përpara noterit e taksave vendore nga bizneset. Bashkia Patos të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 93 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Për 5 masa për shpërblim në vlerën 2,668,052 lekë të cilat nuk janë zbatuar.

**1.1.** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 161,000 lekë pa Tvsh nga BOE “E. K.” Shpk & “F.” Shpk & “A.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 683/14 prot., datë 03.11.2016, me objekt: “Rikualifikimi urban i shëtitorës Republika”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**3.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,321,591 lekë pa Tvsh nga OE “G... C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1718/10 prot., datë 20.04.2018, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Unaza”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit dy herë për trajtimin e dubluar “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m<sup>2</sup>”.

**4.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 664,600 lekë pa Tvsh nga BOE “S.” Shpk & “J.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 829/16 prot., datë 31.08.2017, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Unazë-Grizë Velaj”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**6.1.** Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 176,862 lekë pa Tvsh nga OE “Sh.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1636/12 prot., datë 12.09.2018, me objekt: “Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale Fier-Berat (në fshatin Zharrës) si dhe ndërtimi i dy urave për këmbësorë në krah të urës së automjeteve”, Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**7.1.** Bashkia Patos, drejtoria e financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore arkëtimin e shumës 343,999 lekë si sigurim kontrate OE “S.” Shpk të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje mjet makine vetëshkarkuese”, bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914, datë 29.12.2014, neni 24.

-Për 1 masë për uljen e borxhit tatimor duke ritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (Të ardhura të munguara) në vlerën 42,732,889 lekë e cila nuk është zbatuar.

**1.1.** Bazuar në nenin 91-93 pika 1 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Tatim Taksave Bashkia Patos të merren masa për të zbatuar të gjitha etapat për arkëtimin e detyrimeve për vlerën 42.732,889 lekë, si më poshtë:

-Të arkëtohet vlera prej 13,309,757 lekë sipas VKM. nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen.

Të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a-Të ndiqen të gjitha etapat sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 91-93 (Sektori i Taksave dhe Drejtoria Juridike).

b- Bashkia Patos, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën prej 13,309,757 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja “b” dhe “c” -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Patos), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërbllimin e dëmit në vlerën **2,081,633 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemimi i hapësirave, Lagjja “29 Marsi”, Blloku Zjarrëfiksjë”, Bashkia Patos, me vlerë të kontratës 48,994,499 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE “M.. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 96,532 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 851/15 prot., datë 03.08.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe BOE “M.. I. G. Shpk & “L. K.” Shpk. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **96,532 lekë pa Tvsh** nga BOE “M. I. G.” Shpk & “L. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 851/15 prot datë 03.08.2021, me objekt “Sistemimi i hapësirave, Lagjja “29 Marsi”, Blloku Zjarrëfiksjë”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë”, me vlerë të kontratës (me tvsh) 17,564,628 lekë, realizuar nga OE “A. K.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 754,952 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe OE “A. K.” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **754,952 lekë pa Tvsh** nga OE “A. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022, me objekt: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, me vlerë të kontratës 30,588,573.6 lekë me Tvsh, realizuar nga OE “C. R.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 481,563 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe OE “C. R.” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **481,563 lekë pa Tvsh** nga OE “C. R.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti””, Bashkia Patos, me vlerë të kontratës 85,964,816 lekë pa Tvsh, realizuar nga BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 748,586 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe BOE “G.” Shpk & “A.” Shpk & “Sh.” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **748,586 lekë pa tvsh** nga BOE “G.” ShPK & “A.” ShPK & “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në



kontratën me nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019, me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti””, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

### **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Patos konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën **91,459,528 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën **33,236,601 lekë**. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Patos janë në **vlerën 124,696,129 lekë**, e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët (e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar) për buxhetin e Bashkisë Patos e përbëra nga:

- Detyrimet për taksën e tokës bujqësore në vlerën **53,023,566 lekë** për **2,618 familje**;
- Detyrimet për taksën e ndërtesës në vlerën **22,921,574lekë** për **5,357 familje**;
- Detyrimet për taksën e pastrimit në vlerën **34,064,516 lekë** për **5,357 familje**;
- Detyrimet për tarifën e shërbimit komunitar në vlerën **3,195,792 lekë** për **5,357 familje**;
- Detyrimet për tarifën e vaditjes dhe kullimit në vlerën **2,557,411 lekë** për **657 familje**;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **7,383,601 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **1,549,669 lekë**;

Lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Patos konstatohet se, të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore nuk janë marrë masa të tjera ligjore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me force e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, neni 114, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35, dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 3, pikat 9-10. Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 124,696,129 lekë**, e cila përbëhet nga:

- 53,023,566** lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 2,618 familje;
- 22,921,574** lekë detyrime për taksën e ndërtesës për 5,357 familje;
- 34,064,516** lekë detyrime për taksën e pastrimit për 5,357 familje;
- 3,195,792** lekë detyrime për tarifën e shërbimit komunitar për 5,357 familje;
- 2,557,411** lekë detyrime për tarifën vaditje dhe kullimi për 657 familje;
- 7,383,601** lekë detyrime nga biznesi i vogël;
- 1,549,669** lekë detyrime nga biznesi i madh;

- a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
- b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
- d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
- e. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Patos, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
- f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Patos ka të mbartura nga ish-komuna Ruzhdie 65 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2012. Detyrimi për pagesën e qirasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në NJA Ruzhdie. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëri gjatë vitit, pagesat e tokës me qira nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ku konstatohet se detyrimet deri më datën 31.12.2022, janë në vlerën **1,963,641 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për buxhetin e Bashkisë Patos**. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën" i ndryshuar, Ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998, "Për tokat bujqësore të pandara", VKM nr. 531, datë 21.08.1998, "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", ku përcaktohet edhe Kontrata tip për t'u lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", UKM nr. 1, datë 18.07.2012, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.2. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhura Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në total në **vlerën 1,963,641 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Duke u bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas listave të sjella nga Drejtoria Rajonale e Aluiznit Fier (ASHK), me shkrësë të destinuar për regjistrim në ASHK Fier, deri më datën 31.12.2021, sipas listave për leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në

infrastrukturës konstatohet se nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **1,524 persona në vlerën 33,340,042 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për Buxhetin e Bashkisë Patos**. Për vitin 2022, nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban nuk ka asnjë korrespondencë në formë shkresore me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Fier në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Referuar aktrakordimeve me Degën e Thesarit Fier të ardhurat e realizuara për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme për periudhën janar-dhjetor 2022 janë në vlerën 0 lekë.

Gjithashtu nuk disponohet lista emërore sipas banesave të legalizuara në territorin e bashkisë për vitin 2022 për kalimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Grupi i auditimit më datë 28.02.2023, bërë kërkesë për informacion drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore dhe Drejtorisë së Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban për arkëtimet dhe detyrimet ndaj Bashkisë për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Në lidhje me këtë situatë Bashkia Patos me shkresën nr. 636 prot., datë 28.02.2023, është drejtuar ASHK Fier. Deri më datën 24.03.2023, nga ASHK Fier nuk ka asnjë përgjigje zyrtare.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në **vlerën 33,340,042 lekë ndaj 1,524 persona**.

**3.2. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të vazhdojë korrespondencën zyrtare me ASHK Fier në lidhje me situatën debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2022.

**Brenda datës 31.12.2023**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore si dhe nga verifikimi në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit u konstatua se në Bashkisë Patos figurojnë rreth 13 subjekte me aktivitet në territorin e Bashkisë Patos dhe në NJA Zharëz të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bisneseve në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre u konstatua se 13 subjekte janë pajisur me autorizim të cilat janë përpara objekt auditimi konkretisht: 12 subjekt për tregtim karburanti dhe 1 subjekt tregtim me shumicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

Në total nga 13 subjekte të cilat kanë ushtruar aktivitetin deri më datë 31.12.2022, pesë prej tyre kanë ende pa likuiduar detyrimin në **vlerën 5,350,000 lekë e cila konsiderohet e detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për buxhetin e Bashkisë Patos**. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, VKM

nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Patos, Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikanëte dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **5,350,000 lekë**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN konkretisht Regjistrin e Lejeve Minerare, Drejtorinë Rajonale të Fier, Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se për vitin 2022, në territorin e Bashkisë Patos ushtrojnë aktivitet subjektet si më poshtë:

1. Subjekti “A.” Shpk (me Nipt L.....) i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1736, datë 23.12.2014, për shfrytëzimin e vendburimit Zharrëz për llojin e mineralit kongomeratë me sipërfaqe 0.428 km<sup>2</sup>.

2. Subjekti “C.” Shpk (me Nipt K.....) i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1356, datë 04.06.2009, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Fier për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km<sup>2</sup>. Deri më datën 31.12.2022, Subjekti “C.” Shpk, ka detyrime të pa paguar të cilat lindin nga kontrata e qirasë me nr. 3113/1 prot., datë 28.12.2018, në vlerën **2,327,718 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.**

-Gjithashtu në Bashkinë Patos dy subjektet që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi konkretisht për rërë bituminoze dhe konglomeratë nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10 304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, pika 5, neni 24, pika 10, Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe

ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **2,327,718 lekë** të papaguara ndaj Subjektit “C.” Shpk sipas kontratës së qirasë me nr. 3133/1 prot., datë 28.12.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Fier për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km<sup>2</sup>.

**5.2. Rekomandimi:** Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor. Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa të menjëhershme ku t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisioni disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes.

Bazuar në nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos**, fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

#### **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Patos, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

#### **GRUPI I AUDITIMIT**

1. G. K.
2. A. Z.
3. M. H.
4. O. F.
5. A. V.
6. K. H.
7. E. Ç.

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

**B. D.**

